

GRUPI TEMATIK ANTIKORRUPSION/KOMITETI KOORDINATOR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Nr. 1689 prot.

Tiranë, më 23.03.2021

VENDIM

Nr. 13, datë 23.03.2021

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT, JANAR-DHJETOR 2020, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2023

Në mbështetje të vendimit nr.516, datë 1.07.2020, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020”, dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020 – 2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023, e të Pasaportës së Indikatorëve”, si dhe urdhit të drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, nr.38, datë 12.05.2020 “Për miratimin e Rregullores TIP, “Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” i ndryshuar, Grupi Tematik Antikorrupsion/Komiteti Koordinator

VENDOSI:


1. Miratimin e raportit të monitorimit, janar – dhjetor 2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023, në mbledhjen e zhvilluar *online*, nëpërmjet platformës Zoom, datë 23.3.2021, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të publikojë Raportin e Monitorimit, janar - dhjetor 2020, në faqen zyrtare të saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ministri i Drejtësisë

Etilda Gjonaj
Etilda Gjonaj (Saliu)





KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

RAPORTI I MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2020

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

I. Informacion përmbledhës mbi Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Planit të Veprimit 2020-2023

1.1 Metodologjia e monitorimit

II. Progresi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritetit evropian

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

III. Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

3.3 Konkluzione dhe rekomandime

IV. Risqet /risku dhe hapat për të adresuar

4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit

4.2 Hapat e radhës

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
GTA	Grupi Tematik për Antikorrupsionin
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2023 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2020-2023

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi.

Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë.

Qeveria ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.

Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritetit evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Me Vendimin nr. 516, datë 1.7.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të SNKK u zgjat deri në vitin 2023.

Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*.

Qëllimet madhore politikës së Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia dhe Plani i Veprimit parashikojnë objektiva dhe masa specifike që duhen të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave, sipas afateve të detajuara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit. Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit duke qenë një strategji ndërsektoriale, është bazuar në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI, duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar.

Gjatë tre vjeçarit të parë të SNKK, institucionet implementuan masa konkrete antikorrupsion të parashikuara në Planin e Veprimit 2015-2017. Në vijim, Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit rishikoi Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë, në mënyrë që të mundësonte përshtatjen e Strategjisë me realitetet e reja dhe prioritetet e sektorëve. Plani i Veprimit 2018 – 2020, ishte plani i dytë i veprimit në zbatim të Strategjisë, i cili pasi kaloi nëpër një proces konsultimi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë në luftën kundër korrupsionit, institucione të administratës shtetërore në nivel qendror dhe lokal dhe institucione të pavarura, organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, shoqërinë civile etj., çoi në një nivel më të lartë luftën kundër korrupsionit. Në hartimin e këtij dokumenti u morrën parasysh dhe u reflektuan edhe ndryshimet e ndodhura si pasojë e reformave të ndërmarra si Reforma në Drejtësi dhe Reforma Administrative Territoriale.

Pasaporta e Treguesve u miratua në vitin 2018, me vendimin nr.241, dt.20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, me anë të së cilës janë përcaktuar tregues të matshëm të realizimit të objektivave të kësaj strategjie. Në këtë vendim u miratua edhe krijimi i Komitetit Koordinator për zbatimin e SNKK-së dhe të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion.

Komiteti Koordinator kryesohet nga Ministri i Drejtësisë dhe ka në përbërje 10 anëtarë, në nivel Zëvendësministri nga secila Ministri Linje (pa përfshirë këtu 2 Ministritë pa portofol). Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion është përgjegjëse për inspektimet ndërinstitucionale, sipas Planit të Veprimit të SNKK. Ajo kryesohet nga Ministri i Drejtësisë, Koordinator Kombëtar Antikorrupsion dhe ka në përbërje përfaqësues nga Kryeministria, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Inspektoriati Qendror.


Në datë 1.7.2020, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr.516, i cili miratoi zgjatjen e afatit të zbatimit të SNKK deri në vitin 2023, Planin e ri të Veprimit në zbatim të saj për periudhën 2020–2023 shoqëruar nga një rishikim i vlerave të treguesve për vitet e zbatimit të planit të veprimit.

Plani i Veprimit 2020-2023 përmban 83 masa për zbatimin e të cilave janë të përfshira 22 institucione, të cilat do të punojnë së bashku për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efencë në ritmin e luftës kundër korrupsionit në vend. Masa prioritare të këtij plani veprimi janë forcimi i transparencës së institucioneve publike, shtimi i shërbimeve publike online në mënyrë progresive, fillimi nga zbatimi i deklarimit të pasurive online të zyrtarëve publikë, ngritja dhe zbatimi i instrumenteve të luftës së korrupsionit në administratën publike (planet e integritetit), forcimi i bashkëpunimit të autoriteteve dhe agjencive ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit, rritja e forcës ndëshkuese të korrupsionit nga institucionet e posaçme të fushës, ndërveprim i shtuar i autoriteve që marrin denoncimeve kundër korrupsionit dhe deri në ndërshkrimin e tij, forcimi i ndërgjegjësimit publik dhe sensibilizim i shtuar i publikut. Këto masa vijnë në përputhje me agjendën e mirëqeverisjes dhe synojnë t'i japë një hov më cilësor zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

Ky raport pasqyron monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të vitit të parë të Planit të Veprimit, për periudhën *janar-dhjetor 2020*. Raporti do të ofrojë një informacion mbi progresin e arritur kundrejt çdo qëllimi politike, objektivi specifik bazuar në statusin e arritjeve të treguesve si dhe në zbatimin e reformave kyçe në këtë sektor.

Për këtë periudhë *janar – dhjetor 2020*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 68 masa e 124 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në 34 masa e 63 aktivitete për qasjen parandaluese (A), 25 masa e 37 aktivitete për qasjen ndëshkuese (B) dhe 9 masa e 24 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuere (C).

Përmes zbatimit të Planit të Veprimit gjatë vitit 2020 janë realizuar plotësisht 35 masa, pjesërisht 19 masa dhe nuk janë realizuar 14 masa si dhe janë realizuar plotësisht 70 aktivitete, pjesërisht 17 aktivitete dhe të përcaktuara janë 37 aktivitete.




Për këtë periudhë *janar – dhjetor 2020*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 37 tregues performance, të shpërdarë përkatësisht në 21 tregues për objektivat specifike në qasjen parandaluese, 9 tregues për objektivat specifike në qasjen ndëshkuese dhe 7 tregues për objektivat specifike në qasjen ndërgjegjësuere. Gjatë vitit 2020, janë arritur vlerat e synuara për 14 tregues performance, pjesërisht për 4 tregues performance dhe nuk janë arritur për 19 tregues performance.

Qasja	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ¹	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ²	Vlera e synuar nuk është e realizuar ³
Parandaluese	21	11	2	8
Ndëshkuese	9	1	1	7
Ndërgjegjësuere	7	2	1	4
Total	37	14	4	19

¹ Që është realizuar në shkallën 100 për qind

² Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

³ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna



Në vijim, paraqitet realizueshmëria e objektivëve të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave dhe treguesve të performancës.

Objektivat		Shkalla e realizimit sipas masave	Shkalla e realizimit sipas treguesve të performancës ⁴
Parandalimi	A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	86 në 110 për qind e masave të realizuara	95%
	A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	51 në 85 për qind e masave të realizuara	100%
	A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	86 në 110 për qind e masave të realizuara	141%
	A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	31 në 50 për qind e masave të realizuara	0%

⁴ Përllogaritur sipas formulës " & " _____

	A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	86 në 110 për qind e masave të realizuara	53%
	A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	99.6%
	A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	31 në 50 për qind e masave të realizuara	- ⁵
	A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	86 në 110 për qind e masave të realizuara	50%
	A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	86 në 110 për qind e masave të realizuara	100%
	A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara	100%
	A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	8%
Ndëshkimi	B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	31 në 50 për qind e masave të realizuara	0%
	B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërkombëtarin penal të korrupsionit	0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	50%
	B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	0%
	B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit	31 në 50 për qind e masave të realizuara	30%
Ndërgjegjësimi	C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara	100%

⁵ Nuk mund të matet pasi indikatorit A.7. a nuk ka vlera që raportohen për këtë raport monitorimi. Ky tregues për vitin 2020 do të raportohet në maj 2021.

C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara	29%
C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	0%

Përsa më sipër, nga analiza e kryer rezultojnë se, progresi i arritur për secilin prej qëllimeve të politikave, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim paraqitet:

Qasja Parandaluese (A)	74.66%
Qasja Ndëshkuese (B)	20%
Qasja Ndërgjegjësuere (C)	43%

Për këtë periudhë *janar – dhjetor 2020*, janë shënuar arritje të mira në qasjen parandaluese (A), ndëshkuese (B) dhe ndërgjegjësuere (C) të zbatimit të strategjisë, përmendim:

- sigurimi i transparencës së autoriteteve publike në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke bërë të mundur instalimin e regjistrimit elektronik të kërkesë-ankesave në 58 institucione në tejkallim të vlerës së synuar për vitin;
- janë siguruar procedura transparente të prokurimit publik duke arritur vlerën e synuar lidhur me elementet e ndryshuar në planet vjetore të prokurimit, të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës si edhe të numrit të kontratave të ndryshuara gjatë vitit krahasuar me vitin e mëparshëm, duke ofruar stabilitet të këtyre treguesve;
- janë shtuar në mënyrë të ndjeshme numri i shërbimeve elektronike në funksion të plotë për përdorim nga qytetarët duke siguruar transparencë dhe lehtësi përdorimi. Deri në fund të vitit 2020 janë 1021 shërbime elektronike në funksion të plotë, 1.87 milion përdorues të platformës së shërbimeve e-Albania dhe 7.7 milion aplikime/përdorime të shërbimeve elektronike;
- janë përfunduar procedurat ligjore për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të deklarimit online të pasurive dhe asetëve, është shpallur kompania fituese dhe përgatitja (testimi) i sistemit për të filluar nga përdorimi sipas parashikimit të bërë në planin e veprimit 2020-2023;
- është miratuar udhëzimi për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike, i quajtur Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore dhe është dërguar për njohje dhe zbatim pranë të gjithë institucioneve (ministrive) dhe varësive të Ministrisë së Drejtësisë, dhe është shpallur publikisht në faqen e internetit www.drejtësia.gov.al ;
- është miratuar udhëzuesi për hartimin e planit të integritetit dhe është miratuar dokumenti “Plan Integriteti për Ministrinë e Drejtësisë 2020-2023”, të shpallur publikisht në faqen e internetit www.drejtësia.gov.al ;

- në vitin 2020, është shënuar bashkëpunim i mirë ndërmjet organeve ligjzbatuese në kuadër të ndjekjes dhe ndëshkimit penal të korrupsionit;
- në vitin 2020 ka pasur një ndërgjegjësim të shtuar të publikut në luftën kundër korrupsionit. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Është hartuar, miratuar dhe publikuar Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit për vitin 2020 (Strategjia e Vizibilitetit); janë zhvilluar 4 fushata ndërgjegjësimi kundër korrupsionit, janë ndërmarrë aktivitete, takime, forume, konferenca me grupe interesi të fushave të larmishme akademi, sport, biznese, shoqëri civile; bashkëpunim dhe konsultim i shtuar të akteve dhe dokumenteve të politikave dhe të monitorimit në fushën antikorrupsion.

Gjatë këtij viti zbatimi të planit të veprimit, janë identifikuar edhe problematika, duke ndikuar në realizueshmërinë e disa prej objektivëve të strategjisë dhe në arritjet e qëllimit total të politikave.

Sfida kryesore të zbatimit të planit të veprimit mund të përmenden:

- pamjaftueshmëria dhe paqëndrueshmëria e burimeve financiare në krijimin e mundësive për zbatimin e aktiviteteve dhe masave;
- ndikimi i mjedisit të jashtëm siç mund të jenë vendime politike apo problemet me kapacitetet audituese;
- çështje që lidhen me komunikimin dhe informimin, proceset operacionale dhe sistemet;
- çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ të brendshëm;
- çështje që lidhen me komunikimin, informimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional në përgjithësi;
- çështje të tjera që lidhen me kapacitetet administrative;
- çështje që lidhen me partnerët e jashtëm si dhe rreziqe që lidhen me planifikimin, proceset, sistemet IT dhe sistemet e tjera mbështetëse.

Viti 2020, është viti i pandemisë globale Covid-19, efektet e së cilës u shtrinë dhe ndikuan gjithashtu në zbatimin e këtij plani veprimi. Aktivitetet, masat e parashikuara për zbatim përgjatë vitit 2020, vlerat e treguesve, operacionaliteti dhe funksionimi i institucioneve të përfshira në zbatimin e Planit të Veprimit janë ndikuar duke sjellë vonesa, pamundësi dhe/apo bllokim të proceseve të punës. Buxhete të institucioneve janë prekur nga pandemia Covid-19, (përmendim objektivi C3); moskryerje e masave të caktuara janë prekur nga pandemia Covid-19, (përmendim objektivi A6, A7, objektivi B1); vonesa në kryerjen e masave janë shkaktuar nga pandemia Covid-19, (përmendim objektivin A5 e A11).

1.1 Metodologjia e monitorimit

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 114, datë. 04.09.2019 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë*”, është ngritur Sektori i Programeve në Fushën Antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 - 2023.

Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion (DPFFA) kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën *1 janar deri më 31 dhjetor 2020* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit bazë të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit 2020- 2023 të SNKK-së. Qëllimi është që të kemi informacion të detajuar mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përbushjes së objektivave të strategjisë.

Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në tre faza kryesore:

1. Raportimi i institucioneve nëpërmjet pikave të kontaktit antikorrupsion, mbi zbatimin e aktiviteteve, masave dhe matjen e treguesve të objektivëve strategjikë, për të cilat janë përgjegjëse;
2. Analiza e kryer (sasiore dhe cilësore) nga sekretariati teknik pranë GT për Antikorrupsionin;
3. Raportimi nga KKK mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij para Komitetit Koordinator të SNKK.

Secili institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo qëllimi politike, objektivi specifikë dhe masash të realizuar (mbi bazë aktiviteteve të kryera), buxhetin e parashikuar për vitin raportues, buxhetin e alokuar/përdorur për periudhën e raportimit, problemet e hasura, hapat e mëtejshme dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përvoja e përkjet realizimit të masave, procesi i monitorimit është kryer për çdo qëllim politikash/qasje të strategjisë.

Vlerësimi i progresit të zbatimit të SNKK për këtë periudhë raportimi është kryer nga DPPFA përmes analizës së të dhënave të përcjella nga institucionet raportuese duke iu përmbytur metodës së analizës së parashikuar në Vendimin nr.290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, *“Për krijimin e Bazës të të Dhënave Shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”* dhe Urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, *“Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”*.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018 *“Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”*, janë krijuar 8 Grupe Tematike, të cilat janë pjesë e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Grupi Tematik Antikorrupsion (GTA).⁶

GMIP do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;

⁶ Këtë rol e luan Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

Në kontekstin e integritit evropian, këto struktura do të luajnë rolin e Komitetit Sektorial Monitorues për projektet IPA, duke siguruar raportimin e monitorimit të fondeve IPA, sipas sektorëve.

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me aktet e sipërcituara dhe strukturës orientuese për monitorimin e strategjive dhe planeve të veprimit në Kryeministri.

Së pari, është analizuar zbatimi i masave (realizimi i produkteve) duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to.

Së dyti, është analizuar arritja e vlerës së synuar për vitin 2020 e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar.

Së treti, është analizuar realizimi i objektivëve specifike përmes përlllogaritjes së realizimit të treguesve të performancës dhe përqindjes së masave të lidhura me objektivin përkatës të realizuara.

Zbatueshmëria e masave dhe aktivitete të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

- *E zbatuar*: Institucionet kanë raportuar statusin “E zbatuar” për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbyshur.
- *Pjesërisht e zbatuar/Në proces*: Institucionet kanë raportuar statusin “Në proces” për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
- *E pazbatuar*: Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk është dhënë raportim nga institucionet përgjegjëse.

Për përlllogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të performancës është përdorur formula si më poshtë:

$$" \& \frac{\text{Realizimi i objektivëve}}{\text{Vlerë e referencës}} \times 100$$

Në këtë formulë NR është niveli i realizimit dhe TP – treguesi i performancës.

Përlllogaritja e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë⁷.

⁷ Vlerësim i bërë në përputhje me Guidën Metodologjike “Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes”.

Kategoria	Niveli i Tolerancës	Pikët (110)
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

Niveli tjetër i analizës është ai sipas qasjes (qëllimeve të politikës). Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa, tregues performance, objektivi specifik) është vlerësuar secili nga tre qëllimet e politikave: parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi.

Një vlerësim më i përgjithshëm përmbledhës është kryer gjithashtu për realizimin e strategjisë në tërësi deri në këtë vit zbatimi, që prej miratimit të pasaportës së treguesve, përkatësisht vitet 2018-2019-2020.

Gjatë fazës së analizës janë zhvilluar takime të posaçme diskutimi mbi metodologjinë e raportimit dhe të analizës së kryer me përfaqësues të institucioneve zbatuese (takime gjatë muajve janar e shkurt me Policinë e Shtetit, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme, SHÇBA, Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje).

Matrica e Riskut

Në këtë raport monitorimi është përfshirë edhe një vlerësim dhe identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për tu adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të SNKK.

Vlerësimi i riskut është bërë në përputhje si me tabelën më poshtë:

Mundësia	E lartë	3	6	9
	E mesme	2	5	8
	E ulët	1	4	7
		E ulët	E mesme	E lartë
		Ndikimi		

1.2 Konsultimi publik

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit Ministria e Drejtësisë e dërgoi dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtësia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit.

Drafti është dërguar për vlerësim paraprak edhe pranë Departamentit të Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në Kryeministri, në rolin e ‘vlerësuesit’ të raportit të monitorimit, i cili ka përcjellë komente për vlerësim dhe plotësim të raportit.

Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e dy takimeve të dedikuara të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit dhe të Kryeministrisë, (5 e 8 mars 2021).

Në përfundim, sekretariati teknik pranë GT për antikorrupsionin paraqiti draftin për diskutim e miratim në mbledhjen e Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023. Pas miratimit të draft raportit të monitorimit 2020, paketa e plotë e raportit u dërgua në Sekretariatit e Përgjithshëm të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrim Publik. Raporti i miratuar i monitorimit është publikuar në faqen e internetit të www.drejtësia.gov.al, së bashku me një relacion konsultimi për procesin e ndjekur nga inicimi deri në finalizimin/miratimin e tij.

Sekretariati teknik pranë GT për antikorrupsionin është asistuar në këtë proces monitorimi, analize dhe vlerësimi nga ekipi i asistencës teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian (Projekti i Asistencës Teknike për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit - Kontrata e reformës sektoriale kundër korrupsionit).

II. **PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT**

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2015-2023, është hartuar raporti periodik i rradhës, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2020– 2023, i cili mbulon periudhën *1 janar 2020 deri më 30 qershor 2020*.

2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

Zbatimi i SNKK kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) i cili është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin

e integritimit evropian. Zbatimi i SNKK lidhet me shtyllën “*Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës*” të SKZHI.⁸

SNKK ka identifikuar tre qëllime kryesore politikash (Qasje) përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 18 objektiva specifike, si më poshtë:

Qasja Parandaluese ka për qëllim forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në administratën publike dhe të gjithë segmenteve shtetërore. Fokus i vecantë i dedikohet institucioneve që ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Kjo qasje ka dhe numrin më të madh të objektivave dhe për pasojë dhe masave/aktiviteteve që institucionet përgjegjëse planifikojnë të zbatojnë për arritje e objektivave:

- A.1 *Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion*
- A.2 *Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike*
- A.3 *Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike*
- A.4 *Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit*
- A.5 *Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave*
- A.6 *Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike*
- A.7 *Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut*
- A.8 *Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion*
- A.9 *Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë*
- A.10 *Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit*
- A.11 *Adaptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore*

Qasja Ndëshkuese ka për qëllim të forcojë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, për të ndëshkuar aktet korruptive në të cilat zyrtarët publikë mund të përfshihen dhe garantuar integritetin e organeve shtetërore. Kjo qasje përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- B.1 *Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit*
- B.2 *Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit*
- B.3 *Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar*
- B.4 *Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit*

⁸ Shtyllat e SKZHI:

1. Antarësimi në BE;
2. Qeverisja e mirë demokracia dhe shteti i së drejtës;
3. Rritja përmes stabilitetit makroekonomik dhe fiskal;
4. Rritja ekonomike përmes rritjes së konkurrueshmërisë dhe novacionit;
5. Investimi në kapital njerëzor dhe kohezionin social;
6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit.

Qasja Ndërgjegjësuese ka për qëllim përfshirjen e publikut në luftën kundër korrupsionit, duke e informuar mbi veprimtarinë shtetërore kundër korrupsionit dhe nxitur atë për të përdorur në mënyra aktive kanalet për ta denoncuar atë. Kjo qasje përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit
- C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit
- C.3 Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile

Realizueshmëria e objektivave specifike të të tre qëllimeve të politikave (3 qasjeve) të SNKK, në nivel objektiv

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të qëllimeve të politikës dhe pjesuar me numrin e tyre – realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstucional kundër korrupsionit është 45.8%.

Qasja A	Realizueshmëria
A.1	95%
A.2.	100%
A.3	141%
A.4	0%
A.5	53%
A.6	99.6%
A.7	-
A.8	50%
A.9	100%
A.10	100%
A.11	8%

Qasja B	Realizueshmëria
B.1	0%
B.2	50%
B.3	0%
B.4	30%

Qasja C	Realizueshmëria
C.1	100%
C.2	29%
C.3	0%

Numri i institucioneve të përfshira në procesin e zbatimit të Planit të Veprimit 2020 – 2023 është 22 (10 Ministri, 12 institucione të nivelit qendror).

Zbatimi i SNKK realizohet përmes Planit të Veprimit 2020 – 2023 i cili përmban **83 masa** dhe **152 aktivitete**, të ndara përkatësisht: 45 masa dhe 81 aktivitete për qasjen parandaluese, 29 masa dhe 44 aktivitete për qasjen ndëshkuese, dhe 9 masa dhe 27 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuese.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Parashikimi për Realizimin e Masave			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2020	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023
Parandaluese	Masa	34	36	31	33
	Aktivitete	63	65	64	61
Ndëshkuese	Masa	25	22	21	20
	Aktivitete	37	32	31	31
Ndërgjegjësuere	Masa	9	9	9	9
	Aktivitete	24	18	18	18
Total	Masa	68	67	61	62
	Aktivitete	124	115	113	110

Rezulton se parashikimi i masave dhe aktiviteteve përgjatë viteve të zbatimit të planit të veprimit është pothuaj në raporte të njëjta për të tre qasjet. Ka një balancim të masave dhe aktiviteteve duke siguruar të njëjtën masë ndërveprimi dhe iniciativash institucionale dhe ndër-institucionale.

Gjatë periudhës raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2020, janë monitoruar në total 68 masa e 124 aktivitete, nga të cilat rezulton se janë zbatuar në total 35 nga masat dhe kryer 70 nga aktivitetet.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2020			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2020	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ⁹	Masa dhe aktivitete të parealizuara ¹⁰
Parandaluese	Masa	34	19	12	3
	Aktivitete	63	40	9	14
Ndëshkuese	Masa	25	10	6	9
	Aktivitete	37	16	7	14
Ndërgjegjësuere	Masa	9	6	1	2
	Aktivitete	24	14	1	9


⁹ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹⁰ Aktivitet "i porealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.

Total	Masa	68	35	19	14
	Aktivite	124	70	17	37

Rezulton se nga totali prej 68 masash e 124 aktivitete të parashikuara në planin e veprimit 2020-2023, statusi aktual i tyre për të tre qëllimet e politikave (qasjet e Strategjisë), për vitin 2020, është raportuar si më poshtë:


- 35 masa e 70 aktivitete të realizuara;
- 19 masa e 17 aktivitete ende në proces zbatimi;
- 14 masa e 37 aktivitete të pazbatuara.



Përsa më sipër, nga **35 masa e 70 aktivitete të realizuara** për vitin 2020, konkretisht 19 masa/40 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 10 masa/16 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 4 masa/14 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

Nga **19 masa e 17 aktivitete të cilat janë ende në proces zbatimi** për vitin 2020, konkretisht 12 masa/9 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 6 masa/7 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 1 masë/1 aktivitet i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

Nga **14 masa e 37 aktivitete të porealizuara** për vitin 2020, konkretisht 3 masa/14 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 9 masa/14 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 2 masë/9 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).



2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritit evropian

Aderimi në familjen e Bashkimit Evropian ka qenë një nga pikësynimet më të mëdha të shtetit shqiptar prej gati 3 dekadash tashmë dhe çdo reformë madhore e ndërmarrë ka pasur gjithnjë në fokus përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian.

Në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit janë të parashikuara masa duke mbajtur në konsideratë *acquis* e Bashkimit Evropian për kapitullin 23, e konkretisht me nënfushën e antikorrupsionit, si dhe në përputhje me rekomandimet e raportit të Progresit të Komisionit Evropian. Rrjedhimisht, implementimi i masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit ecën në mënyrë paralele me agjendën e integritit në Bashkimin Evropian dhe ndihmon në shtytjen përpara të proceseve të integritit dhe përmbushjen e kriterëve thelbësore dhe të nevojshme për funksionimin si një shtet me parime Evropiane.

Strategjia dhe Plani i ri i Veprimit 2020-2023, është në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për sa i përket përmbushjes së 5 prioriteteve lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider për prioritetin 3 “Lufta kundër korrupsionit”, ka ndjekur dhe koordinuar punën më të gjithë aktorët lidhur me adresimin e rekomandimeve të progres raportit të Komisionit Evropian për vitin për të cilin është hartuar ky raport monitorimi, 2020.

Korniza strategjike: monitorimi dhe vlerësimi për zbatimin e planit të veprimit antikorrupsion 2020, është përditësuar paralelisht me miratimin e tij në 2020, vlerësimi i bërë në këtë raport për indikatorët e performancës (si mjet për të ofruar më tepër progres) përmbushin këtë rekomandim të adresuar.

Korniza institucionale: Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka ngritur Drejtorinë e Programeve dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë (Drejtoria Antikorrupsion), me kapacitete të reja dhe po zhvillon aftësitë e stafit në mënyrë të vazhdueshme. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit për vitin 2020, është një analizë e thelluar, e zhvilluar për herë të parë në përputhje me rekomandimet e dhëna. Vijon forcimi i kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimi me strukturat e tjera antikorrupsion.

Mbeten në proces hapat për të forcuar luftën kundër korrupsionit dhe në krijimin e një praktike të qëndrueshme për çështjet e korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale që janë krijuar përmes veprave penale të lidhura me korrupsionin (objektivi B3 i SNKK). Më shumë zhvillime priten në periudhën e re për këtë fushë.

Institucionet e reja kundër korrupsionit, si Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit (SPAK) e BKH janë plotësisht funksionale dhe raporti përmban të dhënat e para të adresimit të tyre për korrupsionin në nivel të lartë.

Vijon përmirësimi i aksesit në regjistrat elektronikë kombëtarë për autoritetet ligjzbatuese.

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Rezulton se ndër objektivet me mungesë të plotë realizueshmërie për periudhën raportuese *1 janar – 31 dhjetor 2020*, janë përkatësisht disa prej objektivëve në të tre qasjet e SNKK, përmendim përkatësisht, objektivet A4, A7, A11, B1e B4, C2 e C3.

Për periudhat në vijim të zbatimit të Planit të Veprimit, rekomandohet të merren masa për përmirësim janë:

Objektivi A4: të përmirësohet sistemi i ndarjes së rasteve (denoncimeve) që vijnë nga platformat e përdorimit të qytëtarëve.

Objektivi A7: të përmirësohen raportimi, i munguar, specifikisht mbi matjen e treguesve.

Objektivi A11: të forcohet dhe rakordohet informacioni për objektivin. Ka një mungesë të theksuar të ndjekjes së procesit të zbatimit të masave dhe realizueshmërisë së objektivit.

Objektivi B1 e B3: duhet të forcohet dhe thellohet bashkëpunimi ndërmjet organeve ligjzbatuese, rakordimit të të dhënave dhe ndarjes së rasteve penale për krimin e korrupsionit, për nivelet e larta të funksionarëve. Të evidentohet në mënyrë të plotë bashkëpunimi ndërkombëtar i fushës.

Objektivi C2: të krijohen mundësitë dhe mekanizmat e ndarjes së rasteve të përdorimit të platformës shqiperiaqeduam.com, specifikisht për rastet e denoncimit të korrupsionit nga llojet e tjera të raportimeve që merr nga qytetarët.

Objektivi C3: të krijohen mundësitë financiare për ecurinë zbatimit të objektivit specifik.

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë (donatorë).

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të masave/aktiviteteve të Planit të Veprimit 2020 - 2023, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e planifikuar për vitin raportues dhe buxhetin e përdorur në bazë të aktivitetit të kryer për realizimin e objektivit specifik të strategjisë nga secili institucion përgjegjës.

Nga informacioni financiar i dërguar për vitin 2020, rezulton se është përdorur i gjithë buxheti i planifikuar për parashikimet e bëra nga institucionet përgjegjëse, me përjashtim të ILDKPKI, për objektivin A5, buxheti i përdorur për vetëm 4% e vlerës totale.

Buxheti i përdorur sipas objektivëve dhe burimi konkret i financimit është si vijon:

A1: 10.406.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A2: 26.438.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A3: 245.800.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A4: 86.280.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A5: 77.600.004 lekë (planifikuar), 3.233.333 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A7: 216.150.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A8: 241.055.000 lekë, mbuluar nga donatorë; 1.882.050.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A9: 330.500 lekë, mbuluar nga donatorë; 512.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A10: 712.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
A11: 2.529.000 lekë, mbuluar nga donatorë.
B1: 260.982.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.
C1: 1.035.550.000 lekë, mbuluar nga donatorë; 1.601.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

Objektivët A6, B2, B3, B4, C2 e C3 nuk kanë raportuar kosto të përdorur (0).

Edhe për këtë raport monitorimi, rezulton se për një pjesë të aktiviteteve të kryera gjatë këtij viti zbatimi, kostot vijnë të raportohen në “kosto administrative”, dhe mungon një vlerë konkrete e tyre. Në total, janë 39 aktivitete që raportohen të jenë kryer me “kosto administrative” dhe 16 aktivitete me 0 (zero) kosto.

Buxheti i përdorur sipas qëllimeve të politikës/Qasjeve A-B-C, është:

Qëllimi i politikës 1 (qasja parandaluese- A)

1.814.189.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit
574.084.000 lekë mbuluar nga donator.

Qëllimi i politikës 2 (qasja ndëshkuese - B)

260.982.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit.

Qëllimi i politikës 3 (qasja ndërgjegjësuere - C)

1.601.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit
1.035.550.000 lekë mbuluar nga donatorë.

Totali i buxhetit të përdorur për këtë vit është:

- ***Financimi për vitin 2020 nga buxheti i shtetit është në shumën 2.076.772.000 lekë.***
- ***Financimi për vitin 2020 nga donatorët është në shumën 1.609.634.000 lekë.***

III. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE MASAT

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së tre qasjeve të SNNKnë drejtimit të secilit qëllim politike,¹¹ objektivi dhe masave/aktivitete të Planit të Veprimit 2020-2023, për periudhën e monitorimit *1 janar – 31 dhjetor 2020*.

Qëllimet e politikave dhe objektivat specifikë bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe të aktiviteteve të parashikuara në funksion të zbatimit të masave, të parashikuara për zbatim nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtore të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Në përputhje me SNKK, janë kryer aktivitete dhe realizuar dhe masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023 për periudhën raportuese të lidhura me të 3 qëllimet e politikës, përkatësisht parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin.

Qasja Parandaluese - Përmbledhje për arritjet në parandalimin e korrupsionit

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) parandaluese SNKK** synon çrrënjosjen e korrupsionit nga radhët e administratës publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore, si dhe nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët. Kjo qasje përmban numrin më të madh të objektivave specifike dhe për rrjedhojë dhe të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar nga institucionet e përfshira.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.


Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2020	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ¹²	Masa dhe aktivitete të parealizuara ¹³
Parandaluese (A)	Masa	34	19	12	3
	Aktivitete	63	40	9	14

Rezulton se nga 34 masa e 63 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për vitin 2020, për Qasjen A (Parandaluese), janë zbatuar 19 masa/40 aktivitete prej tyre, 12 masa/9 aktivitete janë ende në proces zbatimi, 3 masa/14 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa A6.4; A.8.2; A.11.3 dhe aktivitete A4.2.1; A6.1.2/A6.2.1/A6.2.2/A6.3.2/A6.4.2/A6.5.2/ A7.1.2/A7.1.3/A7.1.4/ A7.3.2/ A7.3.4/ A8.7.1 dhe A11.3.1)

¹¹Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është përfshirë në aneksin e këtij raporti.

¹² Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹³ Aktivitet "i përealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind




Nga 21 treguesit performancës të caktuar për qasjen parandaluese, përmes realizimit të masave dhe kryerjes së aktiviteteve respektive është arritur vlera e synuar për 11 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 2 tregues performance si edhe nuk është arritur vlera e synuar për 8 tregues performance.

Qasja Parandaluese	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ¹⁴	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ¹⁵	Vlera e synuar nuk është e realizuar ¹⁶
	21	11	2	8

¹⁴ Që është realizuar në shkallën 100 për qind

¹⁵ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹⁶ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna



A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

A.1.a: Numri i institucioneve të cilat kanë implementuar saktë programe transparence

A.1 b: Bërja operacional regjistrin qendror për ankesat dhe përgjigjet që në vitin 2020

Plani i Veprimit për Objektivin A.1 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

A.1.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.1.a** për vitin 2020 është: **rritja me 12% e numrit të institucioneve të cilat kanë implementuar saktë programin e transparencës**,¹⁷ krahasuar me vitin 2019. Për vitin 2021 vlera e synuar është 9% rritje krahasuar me vitin parardhës, për vitin 2022 vlera e synuar 7% rritje krahasuar me vitin parardhës, dhe për vitin 2023 vlera e synuar 5% rritje krahasuar me vitin parardhës.

Gjatë vitit 2019, 246 autoritete publike i publikuan programet e transparencës në faqet zyrtare dhe nga këto, 189 i zbatuan ato në mënyrë korrekte duke publikuar dhe regjistrin e kërkesave për informim. Vlera e synuar për vitin 2020 është rritja e numrit të autoriteteve publike që do të publikojnë programet e transparencës në faqet e tyre zyrtare në 211 (189 + rritje 12%).

¹⁷ Në pasaportën e treguesve të miratuar me VKM Nr. 241, datë 20.4.2018, vlera e synuar vjetore për vitin 2020 ishte rritja me 12% e numrit të institucioneve të cilat kanë implementuar saktë programin e transparencës. Vlera u rishikua me VKM nr. 516, date 1.7.2020

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar gjithashtu aktivitetet (4) dhe masat (2) si më poshtë.

A.1.1	Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek autoritetet publike qendrore dhe të varësisë.
A.1.1.1	Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Autoriteteve Publik (<i>Hartimi dhe publikimi i 1 raporti vjetor</i>).
A.1.1.2	Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total të autoriteteve publike çdo 3 muaj.
A.1.2	Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek njësitë e vetqeverisjes vendore.
A.1.2.1	Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (<i>Hartimi dhe publikimi i 1 raporti vjetor</i>).
A.1.2.2	Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total të autoriteteve publike çdo 3 muaj


Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 muaj dhe me vlera të matshme përkundrejt prodhimit të raportit mbi indeksin e transparencës të autoriteteve publike qendrore dhe raportit mbi indeksin e transparencës së autoriteteve publike të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për vitin 2020 KDIMDHP ka monitoruar online transparencën në 417 autoritete publike, nga të cilat 356 autoritete qendrore dhe 61 autoritete publike vendore. Nga monitorimi rezulton se 239 autoritete publike qendrore e vendore kanë zbatuar në mënyrë të saktë parimet e transparencës (programin e transparencës). Kështu, 190 autoritete publike kanë publikuar programin e transparencës, 103 kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe 200 kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit. Gjithashtu, nga monitorimi në njësitë e qeverisjes vendore, rezulton se 49 autoritete publike kanë publikuar programin e transparencës, 34 kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe 36 kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

KDIMDHP në muajin dhjetor ka hartuar një raport monitorimi të transparencës proaktive, për autoritetet qendrore dhe vendore, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës së bashku me indeksin e transparencës, me burimet financiare të brendshme të institucionit, pa pasur mundësi të sigurojë burime financiare shtesë.

Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e realizimit të vlerës së synuar të këtij treguesi, rezulton se treguesi është arritur në masën 57%.

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë.



Siç shihet nga grafiku, shkalla e realizueshmërisë së vlerave të treguesit ka qënë më e ulët se sa vlera e synuar vjetore.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.1.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.1.b** për vitin 2020 është: *krijimi dhe vënia në funksion e regjistrin qendror për ankesat dhe përgjigjet nga më shumë se 70% e autoriteteve publike* krahasuar me vitin 2019. Për vitin 2021 vlera e synuar është 50% krahasuar me vitin parardhës, për vitin 2022 vlera e synuar 30% krahasuar me vitin parardhës, dhe për vitin 2023 vlera e synuar 25% krahasuar me vitin parardhës.

Gjatë vitit 2019, regjistri u bë i zbatueshëm nga 30 institucione dhe agjenci qendrore përfshirë ministri dhe institucione të pavarura. Vlera e synuar për vitin 2020 është rritja e numrit të autoriteteve publike që do të krijojnë dhe vënë në funksion regjistrin qendror për ankesat dhe përgjigjet në 51 (30 + rritje 70%).

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikur aktivitetet dhe masat si më poshtë.


A.1.3	Instalimi i regjistrin qendror të kërkesave dhe përgjigjeve dhe mbikëqyrja e përditësimit të regjistrin nga ana e koordinatorëve për të drejtën e informimit (2020-21 institucione; 2021-24 institucione; 2022-25 institucione; 2023-25 institucione).
A.1.3.1	Numri i institucioneve ku është instaluar regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve
A.1.3.2	Monitorime të KDIMDHP ndaj koordinatorëve të AP për regjistrin e kërkesë-ankesave

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 muajor.

Për vitin 2020 është tejkalluar instalimi i regjistrimit elektronik nga 21 autoritete publike, me një rritje prej 8 autoritete publike, dhe nga 30 operacional në 2019, për 2020 janë 59 autoritete publike në total, që përdorin regjistrim elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të vlerësuar realizimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, me këtë numër institucioneve ku është instaluar regjistri elektronik ka treguesi është arritur në masën 133%.

Instalimi i regjistrimit është kryer me buxhetin e institucioneve përkatëse, por kosto e mirëmbajtjes është mbuluar nga buxheti i Zyrës së Komisionerit, në total 2,174 lekë. Për vitet në vijim institucionet përkatëse duhet të sigurojnë buxhetin për mirëmbajtjen.



Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.1.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2020 është **95%**.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\frac{59}{62} \times 100 = 95\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.1 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (<https://ëëë.idp.al/raporte-vjetore/>), si dhe në https://ëëë.idp.al/ëp-content/uploads/2021/01/raport_monitorimi_i_institucioneve_qendrore_dhe_te_varesise.pdf https://ëëë.idp.al/ëp-content/uploads/2020/12/Indeksi_-i-transparences_-bashkite_monitorim_bashkite_nentor_2020_ok-1.pdf

Risqet për realizimin e Objektivit A.1

Në drejtim të realizimit të aktiviteteve dhe masave rreziku i mosrealizimit është i nivelit të mesëm për shkak të pamjaftueshmërisë dhe paqëndrueshmërisë së burimeve financiare të institucionit përgjegjës për këtë objektiv.

A.2 *Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

A.2.a: *Raporti i elementeve të ndryshuar në Planet Vjetore të Prokurimit*

A.2.b: *Pjesa e kontratave të dhëna përmes procedurave me negociim pa publikuar paraprakisht njoftimin e kontratës*

A.2.c: *Pjesa e kontratave të ndryshuara gjatë vitit*

Plani i veprimit për Objektivin A.2 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

A.2.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.a** për vitin 2020 është: **ulja në 20% e raportit ndërmjet numrit të elementeve të ndryshuara në planet vjetore të prokurimit dhe numrit total të elementëve të publikuar në planet vjetore të prokurimit** krahasuar me vitin e mëparshëm. Për vitet 2021, 2022, dhe 2023, vlera e synuar është ruajtja në masën 20% e këtij raporti me qëllim krijimin e stabilitetit në këtë tregues.

Për vitin 2019, raporti ndërmjet numrit të elementeve të ndryshuara në planet vjetore të prokurimit dhe numrit total të elementëve të publikuar në planet vjetore të prokurimit ishte 15%, ndërkohë që vlera e synuar për vitin 2019 ishte 35%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

A.2.1	Përmirësimi i procesit të planifikimit nëpërmjet publikimit paraprak të procedurave të prokurimit
A.2.1.1	Hartimi dhe miratimi i formularëve të njoftimit paraprak dhe njoftimit periodik të procedurave të prokurimit
A.2.1.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përdorimin e njoftimeve paraprake dhe periodike të procedurave të prokurimit (trajnime, vizita studimore, etj)

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes masës e cila do të realizohet nga aktivitete që fillojnë zbatimin nga tremujori i dytë i vitit 2020 (aktiviteti A.2.1.1) dhe duke filluar nga tremujori i tretë i vitit 2020 (aktiviteti A.2.1.2).


Gjatë vitit 2020, hartimi dhe miratimi i formularëve të njoftimit paraprak dhe njoftimit periodik të procedurave të prokurimit vazhdon të jetë në proces realizimi për shkak të procedurës së miratimit të ligjit të ri për prokurimin publik. Ligji i ri i prokurimit publik nr.162/2020 është miratuar në Kuvend më datë 23 Dhjetor 2020 dhe mbeten në vijim (në proces) hartimi dhe miratimi i formularëve me akte nënligjore.

Ecuria e procesit të hartimit dhe miratimit të formularëve të njoftimit paraprak dhe njoftimit periodik të procedurave të prokurimit ka ndikuar edhe në kryerjen e aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve të punonjësve të APP pasi trajnimet do të zhvillohen në kuadër të implementimit të ligjit të ri (miratuar në 23 dhjetor 2020).

APP ka raportuar shpenzimin e 51% të buxhetit të parashikuar dhe është në statusin në zbatim pjesërisht të masës.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këtë tregues, raporti ndërmjet numrit të elementeve të ndryshuara në planet vjetore të prokurimit dhe numrit total të elementëve të publikuar në planet vjetore të prokurimit është 19.3% ndërkohë që vlera e synuar për vitin 2020 është 20%. Ky tregues performance është arritur në masën 100%.

Sipas APP, duhet theksuar se, në krahasim me vitin 2019, ka pasur një rritje të ndryshimeve në elementët e regjistrit të parashikimeve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.



Siç shihet nga grafiku, vlerat vjetore të këtij treguesi janë realizuar dhe tejkaluar në tre vitet, sidomos për vitin 2018 dhe vitin 2019.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.2.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.b** për vitin 2020 është: **ulja në më pak se 10% e raportit të numrit total të procedurave me negociim të dhëna pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës krahasuar me numrin total të procedurave të dhëna krahasuar me vitin e mëparshëm.** Për vitet 2021, 2022, dhe 2023, vlera e synuar është ruajtja në masën më pak se 10% e këtij raporti me qëllim krijimin e stabilitetit në këtë tregues.

Për vitin 2019, raporti ndërmjet numrit të elementeve të ndryshuara në planet vjetore të prokurimit dhe numrit total të elementëve të publikuar në planet vjetore të prokurimit ishte 3.2%, ndërkohë që vlera e synuar për vitin 2019 ishte më pak se 15%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

A.2.2	Mekanizma për përmirësimin e zbatimit të kontratave
A.2.2.1	Hartimi dhe miratimi i instrumentave të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të kontratës (Plani i zbatimit të kontratës; formulari i zbatimit të kontratës)
A.2.2.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me monitorimin e zbatimit të kontratës (trajnime, vizita studimore, etj).

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes masës e cila do të realizohet nga aktivitete që fillojnë zbatimin nga tremujori i parë i vitit 2020.


Gjatë vitit 2020, hartimi dhe miratimi i instrumentave të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të kontratës (Plani i zbatimit të kontratës; formulari i zbatimit të kontratës vazhdon të jetë në proces realizimi për shkak të procedurës së miratimit të ligjit të ri për prokurimin publik. Ligji i ri i prokurimit publik nr.162/2020 është miratuar në Kuvend më datë vetëm në datë 23 Dhjetor 2020. Aktet e mësipërme do të përcaktohen në akte nënligjore pas miratimit në Kuvend të ligjit të ri.

Gjatë këtij viti, janë forcuar kapacitetet të punonjësve të APP është bërë i mundur nëpërmjet formatit online (ëebinar), 4 persona të trajnuar dhe sesione trajnime që janë kryer kryesisht nga institucione të tjera (vendase dhe nderkombëtare) duke mos paraqitur kosto të shtuar për APP.

APP ka raportuar shpenzimin e 100% të buxhetit të parashikuar dhe në statusin në zbatim pjesërisht të masës.

Për vitin 2020, raporti ndërmjet numrit total të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe numrit total të procedurave të dhëna është është 8.3% nga të cilat në negociimet pa shpallje 416 kontrata, rezulton një rritje e numrit të kontratave për shkak të procedurave të kryera në përballimin e pasojave të pandemisë Covid-19, ku janë realizuar 191 kontrata, si dhe kontratat per eliminimin e pasojave të tërmetit të datës 26.11.2019 ku janë realizuar 74 kontrata, dhe të tjerat 151 kontrata të cilat zënë 8.3% të numrit total të procedurave të shpallura fituese.

Ndërkohë, procedurat e tjera 151 (Jo Covid dhe Jo termet), të publikuar me negociim pa shpallje zënë 3.03% të numrit total të procedurave të shpallura. Ky tregues performance është arritur në masën 100%.



Edhe për këtë tregues, vlerat vjetore të këtoj janë realizuar dhe tejkaluar në tre vitet e matura.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.2.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.c** për vitin 2020 është: **ulja në 10% ulja e numrit të kontratave të ndryshuara gjatë vitit** krahasuar me vitin e mëparshëm. Për vitet 2021, 2022, dhe 2023, vlera e synuar është ruajtja në masën 10% e këtij raporti me qëllim krijimin e stabilitetit në këtë tregues.

Për vitin 2019, numri i kontratave të ndryshuara gjatë vitit ishte 1.6%, ndërkohë që vlera e synuar për vitin 2019 ishte 10%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.


A.2.3	Mekanizma për përmirësimin e dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike
A.2.3.1	Hartimi dhe publikimi i rekomandimeve të vazhdueshme nga APP në lidhje me përmbajtjen e dokumentave të tenderit të përgatitura nga autoritetet/entet kontraktore me qëllim përmirësimin e tyre (Nr. i rekomandimeve të nxjerra)
A.2.3.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përgatitjen e dokumentave të tenderit, në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe të ndershme (trajnime, vizita studimore, etj)

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes masës e cila do të realizohet nga aktivitete që fillojnë zbatimin nga tremujori i parë i vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, APP ka nxjerrë 6 rekomandime në lidhje me përmirësimin e mekanizmave të dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike.

Gjatë këtij viti, janë forcuar kapacitetet të punonjësve të APP në lidhje me përgatitjen e dokumentave të tenderit, në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe të ndershme. Kështu, janë organizuar trajnime formatit online (ëëbinar), 3 persona të trajnuar dhe sesione trajnimi që janë kryer kryesisht nga institucione të tjera (vendase dhe nderkombëtare) duke mos paraqitur kosto të shtuar për APP. Kjo masë është realizuar. Megjithatë APP ka raportuar shpenzimin e 100% të buxhetit të parashikuar.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, numri i kontratave të ndryshuara gjatë vitit është 1.9% ndërkohë që vlera e synuar për vitin 2020 është 10%. Ky tregues performance është arritur në masën 100%.



Edhe për këtë tregues, vlerat vjetore të këto janë realizuar dhe tejkaluar në tre vitet e matura.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.2.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.2. Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtëme:

$$\frac{\text{Vlera e arritur}}{\text{Vlera e synuar}} = 100\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.2 për këtë periudhë raportimi është mirë (51 në 85 për qind e masave të realizuara).

Përsa i përket treguesve të performancës realizueshmëria sistematike duke tejkaluar konsiderueshëm vlerat e synuara ngre nevojën e rishikimit të relevancës së këtij treguesi.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Agjencisë së Prokurimit Publik (<http://ëëë.app.gov.al/rreth-nesh/analizat-vjetore/>)

Risqet për realizimin e Objektivit A.2

Përkundrejt relevancës relative të treguesve aktualë të performancës, ekziston rrezik i lartë për matjen efektive të realizimit të këtij objektiv.

A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

A.3: Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike

Plani i veprimit për Objektivin A.3 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.3** për vitin 2020 është: **rritja e numrit total të shërbimeve elektronike të disponueshme për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike në 602**. Për vitin 2021 vlera e synuar është 670 shërbime elektronike, për vitin 2022 vlera e synuar është 720 shërbime elektronike, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është 750 shërbime elektronike.

Gjatë vitit 2019, numri total i shërbimeve elektronike arriti në 601 shërbime, nga 582 shërbime elektronike të parashikuara për t'u ndërtuar.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masa (1) si më poshtë.

A.3.1	Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike
A.3.1.1	Nr. shërbimesh elektronike të shtuara; (2020-602 shërbime; 2021-670 shërbime; 2022-720 shërbime e 2023-750 shërbime)
A.3.1.2	Përcaktim i formës së aplikimit për e-shërbimet; kryerje analize e regjistrave elektronike ndërveprues
A.3.1.3	Kryerje e zhvillimeve teknike për ekspozimin e të dhënave nga e-sistemet fundore të institucioneve
A.3.1.4	Kryerje e zhvillimeve teknike për të konsumuar eëbservice-t përkatëse të e-sistemeve

A.3.1.5	Kryerja e vlerësimit për strukturimin e informacionit për publikim në portalin e-Albania.
A.3.1.6	Zhvillimet e nevojshme teknike për implementimin e shërbimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik (që mund të ofrohet).

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që maten duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2020 deri në fund të periudhës që mbulon ky plan veprimi, dhjetor 2023.

Përmes kryerjes së aktiviteteve të parashikuara AKSHI ka realizuar gjatë kësaj periudhe raportimi 1021 shërbime elektronike, nga 602 që ishte vlera e synuar për vitin 2020, duke e realizuar me 419 më shumë.


Më konkretisht përmenden shërbime online të shtuara: ASHK (Rivlerësimi i pasurisë); MD (Aplikim për ekspert gjykatë; Vlerësim i ekspertëve në gjykata; Vërtetim si ekspert gjykatë); MASR (Aplikim për Fondin e Ekselencës (për nëpunësit e administratës shtetërore/për studentët e ciklit të parë dhe të dytë/për studimet e doktoraturës); Aplikim për vërtetim për gradat shkencore dhe titujt akademikë); MTM (Aplikim për vlerësimin e ndikimit në mjedis); AMF (aplikim për licensimin e administratorëve të falimentit; Aplikim për rinovimin e licences së administratorëve të falimentimit); DPB (Vërtetim i gjendjes gjyqësore); DPP (Aplikim për vërtetimin e detyrimeve përbarimore); ISSH (Kërkesë për shpërblim lindje për personat e punësuar; Kërkesë për shpërblim lindje për personat e vetëpunësuar); QKB (Aplikim për regjistrimin fillestar të degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja; Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive aksionare (sh.a); Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar dhe të thjeshta); Biblioteka Kombëtare (Aplikim për anëtarësim në Bibliotekën Kombëtare; Aplikim për huazim për lexim në sallat e Bibliotekës Kombëtare); DPPSh (Leje për dalje).

Për vitin 2020, numri i shërbimeve elektronike të shtuara sipas treguesit është tejkaluar me 69.6%. Përcaktim i formës së aplikimit për e-shërbimet; kryerje analize e regjistrave elektronike ndërveprues është realizuar në nivelin 100%. Kryerje e zhvillimeve teknike për ekspozimin e të dhënave nga e-sistemet fundore të institucioneve është realizuar në nivelin 100%. Kryerje e zhvillimeve teknike për të konsumuar Eëbservice-t përkatëse të e-sistemeve është realizuar në nivelin 100%. Kryerja e vlerësimit për strukturimin e informacionit për publikim në portalin e-Albania është realizuar në nivelin 100%. Zhvillimet e nevojshme teknike për implementimin e shërbimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik (që mund të ofrohet), është realizuar në nivelin 100%.

Për vitin 2020, janë 1.87 milionë përdorues të platformës e-Albania dhe 7.7 milionë aplikime/përdorime të shërbimeve elektronike në përdorim.

Buxheti i shpenzuar në këtë vit zbatimi të planit të veprimit ka qenë në masën 100%.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këtë masë (si më lart), me këtë numër shërbimesh elektronike në funksion të plotë ka ndikuar drejtpërdrejtë në mënyrën e realizimit të treguesit, i arritur në masën 141%.



Siç shihet, për këtë tregues vlerat e synuara janë realizuar në të tre vitet e matura, ndërsa në vitin 2020 vlera e synuar është tejkaluar me 41%.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.3.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.3. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020 është **141%**.

Shkalla e realizimit të objektivit A.3 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86 në 110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (<https://akshi.gov.al/raporte-vjetore/>)

Risqet për realizimin e Objektivit A.3

Nuk paraqitet asnjë risk evident për realizueshmërinë e këtij objektivi.

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit

Për këtë objektivi është përcaktuar 1 tregues performance:

A.4: Numri i hetimeve për korrupsion sipas denoncimeve të qytetarëve

Plani i veprimit për Objektivin A.4 për vitet 2020-2023 parashikon 12 aktivitete dhe 5 masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.4** për vitin 2020 është: **rritja me 5% e numrit të numrit total të hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve**, krahasuar me vitin e mëparshëm. Për vitet 2021, 2022, dhe 2023, vlera e synuar është trendi rritës i numrit të numrit total të hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Për gjenerimin **numrit total të hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve**

Gjatë vitit 2019, Policia e Shtetit duhet që më parë të përmirësojë procesin e brendshëm të menaxhimit të rasteve në mënyrë që të ndajë rastet e hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve nga ato të gjeneruara përmes formave të tjera. Kjo vlerë e synuar ishte parashikuar të realizohej gjatë vitit 2018. Për shkak se kjo nuk është bërë e mundur as gjatë vitit 2019 (përmirësimi i sistemit ishte vlerë e synuar për tu realizuar gjatë vitit 2018), matja e realizimit të treguesit nuk është bërë e mundur në vitin 2019.

Perveç numrit total të hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve, ky tregues përmban dhe një nën-tregues performance që është *raporti i hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve, të cilat janë dërguar nëpërmjet portaleve online, krahasuar me numrin total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve*.

Vlera e synuar për këtë tregues për vitin 2020 është *rritja me 5%*, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Për shkak të mungesës së të dhënave të ndara, matja e realizimit të vlerës së synuar e këtij nën-treguesi nuk është bërë e mundur për vitin 2019.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (12) dhe masat (5) si më poshtë.

A. 4.1	Mekanizma për ngritjen/vënien në funksion të sistemit për ndjekjen/ monitorimin e hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve
A.4.1.1	Ngritja e njësisë qendrore për hetimin e krimit ekonomik financiar, me 20 oficerë të përzgjedhur nga studentët e ekselencës, të cilët do trajnohen në Akademinë e Sigurisë
A.4.1.2	Ngritja e një sektori të posaçëm për gjetjen/ hetimin e aseteve kriminale që rrjedhin nga veprimtaria e korrupsionit, në përshtatje me standartet Europiane të AROS
A.4.1.3	Rishikimi i procedurave standarte të punës bazuar në ristrukturimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit.
A. 4.2	Ndërveprim funksional dhe përmirësim bashkëpunimi të strukturave të Policisë së Shtetit që hetojnë korrupsionin, në portalin ëëë.shqiperiaqeduam.al
A.4.2.1	Marrëveshje bashkëpunimi PSH-ADB
A.4.2.2	Nr. i rasteve të aksesit të PSh në platformë;

A.4.3	Forcim bashkëpunimi PSH- SHÇBA për hetimin e subjekteve të përfshira në korrupsion
A.4.3.1	Ngritja e grupeve të përbashkëta institucionale të punës PSh - SHÇBA; Nr. i rasteve të hetimeve të përbashkëta
A.4.3.2	Nr. i subjekteve të dërguara për procedime penale për veprën penale të korrupsionit nga hetimet përbashkëta.
A.4.4	Kapacitete të ngritura të strukturave të specializuara që merren me hetimin e krimit të korrupsionit në PSH
A.4.4.1	Trajnime të kryera (shefa të sektorëve në DVP dhe specialistëve kundër korrupsionit në DPP)
A.4.4.2	Nr. i personave të trajnuar, 20 persona/vit
A.4.4.3	Trajnime të specialistëve për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policorë Tiranë, me trajnues nga strukturat e Prokurorisë dhe Gjykatës, 126 persona/vit. (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
A.4.5	Monitorim proaktiv dhe i vazhdueshëm i medias së shkruar dhe elektronike, rrjeteve sociale, pritja dhe zgjidhja në kohë ankesave/rasteve/informacioneve të denoncuar publikisht për krimin e korrupsionit
A.4.5.1	Forcimi i kapaciteteve të strukturave teknike të PSH dhe SHÇBA për monitorimin/gjurmimin e rasteve
A.4.5.2	Nr. i personave/staf i përfshirë në këto grupe për monitorimin e rasteve të denoncuar për prirje për korrupsion

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë përgjatë vitit 2020 dhe në vijim dhe fillojnë nga masa A.4.2 e në vijim.

Gjatë vitit 2020, nuk raportohet nga institucionet zbatuese ende lidhja e një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si një formë që do të përmirësonte dhe do të garantonte një bashkëveprim funksional për trajtimin e denoncimeve kundër korrupsionit. Kanë filluar procedurat për dakordësimin e lidhjes së një marrëveshjeje PSH-ADB, pas kërkesës së bërë nga PSH për këtë qëllim. PSH raporton 3 raste aksesi të strukturave policore në platformë. Të dhënat e marra nga PSh për vitin 2020, janë për 1083 ankesa të marra direkt nga platforma por që për asnjë prej tyre nuk është filluar procedim penal për korrupsionin, të cilat janë verifikuar, sqaruar me ankuesit dhe në asnjë rast nuk kanë ekzistuar elementë të veprës penale të korrupsionit; ankuesve u është kthyer përgjigje për ankesën e bërë dhe janë orientuar për institucionet përgjegjëse për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të tyre, brenda afatit. Ndërkohë që pranë PSH për këtë vit janë evidentuar në total 237 vepra penale për krimin e korrupsionit, nga të cilat janë zbuluar 218; 287 autorë të dyshuar; 56 janë arrestuar dhe ndaluar; 224 autorë janë proceduar në gjendje të lirë dhe 7 autorë janë shpallur në kërkim. Krahasueshmërisht me vitin 2019 janë evidentuar 136 vepra penale më pak për korrupsion se në vitin 2019 dhe 245 autorë të dyshuar më pak se në vitin 2019 (viti 2019: 373 vepra penale për krimin e korrupsionit; 337 janë zbuluar; 532 autorë të dyshuar, nga të cilët 86 të arrestuar/ndaluar dhe 437 proceduar në gjendje të lirë e 9 shpallur në kërkim) dhe shkak për këtë ulje janë pandemia

Covid-19 dhe mungesa e veprimtarisë social-ekonomike dhe administrative për disa muaj gjatë vitit 2020.

Për zbatimin e masës A.4.3, Policia e Shtetit dhe SHÇBA kanë ngritur 2 grupe të përbashkëta hetimore dhe janë 6 subjekte të dërguara për procedime penale për veprën penale të shpërdorimit detyrë (neni 248 KP) nga hetimet e përbashkëta. “Dokumenti i Analizës së Rrezikut” ose ndryshe “Plani i Integritetit”, është miratuar dhe do të përdoret nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit, në evidentimin e sektorëve me rrisht më të lartë korrupsionit dhe dhënia e rekomandimeve në strukturat vendimarrëse për marrjen e masave konkrete në minimizimin apo uljen e rreziqeve për korrupsion.

Bashkëpunimi ndërmjet SHÇBA dhe strukturave të Policisë së Shtetit është fokusuar kryesisht në parandalimin, zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme të favorizimit apo implikimit të punonjësve të policisë në kultivimin dhe trafikimin e bimëve narkotike. Veprimtaria korruptive evidentohet në faktin që: *“punonjës policie sigurojnë mosgoditjen e kësaj veprimtarie të kundërligjshme, nëpërmjet njoftimit të kultivuesve/trafikantëve për operacionet policore të kontroll territorit, kundrejt përfitimit të “rryshfetit - mites”.*

Gjatë vitit 2020, janë referuar pranë organit të Prokurorisë 33 referime të materialeve hetimore në ngarkim të 73 punonjës policie dhe 61 shtetas, për veprat penale *“shpërdorimi i detyrës”, “korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “kultivimi i bimëve narkotike”.* Gjithashtu janë ekzekutuar 30 urdhra për masë sigurimi personal shtrëngues dhe ndalues për 30 punonjës policie.

Për zbatimin e masës A.4.4, gjatë vitit 2020, në radhët e PSH janë 6 trajnime me 44 përfitues nga te cilet 14 janë femra për tema/cështje si: “Mashttrimet e prokurimeve publike dhe pastrimin e parave” me 2 përfitues; “Trainimi i avancuar i hetimit financiar” me 4 përfitues; Marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe prokurorisë për përmirësimin e cilësisë së referimeve”, 15 përfitues; “Hetimi financiar kombëtar dhe hetimet ndërkombëtare” me 5 përfitues; “Investigimi hetimi i aseteve kriminale dhe pastrimit parave” me 1 përfitues dhe “Veprat penale e krimet në detyrë” me 17 përfitues, të gjitha në kuadër të bashkëpunimeve dhe të mbuluara financiarisht nga partnerët e huaj.

Gjatë vitit 2020 si rezultat i monitorimit proaktiv dhe të vazhdueshëm të medias së shkruar dhe elektronike, rrjeteve sociale, informacioneve të denoncuara publikisht për krimin e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës PSh, raportojnë të jenë evidentuar ndjekur/referuar dhe regjistruar në prokurori 8 raste (nga programet investigative “STOP” dhe “FIKS FARE”) dhe kapacitete të PSH të përfshira në këto grupe monitorimi janë 27 persona staf.

Gjatë vitit 2020, pranë SHÇBA është duke u implementuar Sistemin e Menaxhimit të Çështjes (Portali/SHÇBA) për monitorimin e rasteve të korrupsionit por edhe të shkeljeve të tjera të denoncuara nga qytetarët, për përdorimin e të cilit janë trajnuar 50 punonjës të SHÇBA.

Të dhëna statistikore për raste të trajtimit të denoncimeve nga SHÇBA: 8113 telefonata (2723 telefonata kanë qenë brenda objektit të punës së SHÇBA-së dhe është ndjekur rasti nga strukturat në nivel qendror dhe vendor) dhe vënia në kontakt e denoncuesit; 1112 telefonata kanë qenë me objekt informacion në lidhje me veprimtarinë e SHÇBA; 4278 telefonata kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së SHÇBA duke bërë adresimin pranë strukturës përkatëse.

Në nivel qendror dhe vendor janë administruar 1202 ankesa nga të cilat 1040 (87 %) kanë ardhur nga qytetarët (543 ankesa nëpërmjet telefonatave në linjën e gjelbër; paraqitjes së qytetarëve pranë Zyrës së Ankesave ose pranë strukturave Rajonale të SHÇBA-së - 367 ankesa nëpërmjet adresës së e-mail-it ankesa@SHÇBA.gov.al - 130 ankesa nëpërmjet postës) dhe 162 (13 %) kanë ardhur nga burime të tjera (131 ankesa nëpërmjet nga institucioneve të ndryshme dhe 31 ankesa janë administruar nëpërmjet publikimeve në media). Nga hetimi administrativ ka rezultuar se në 97 raste janë shkelur procedurat standarde të punës gjatë veprimtarisë së përditshme të strukturave subjekte të Shërbimit si dhe në 10 raste janë konsumuar elementë të veprës penale. Për këto raste është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor për 191 punonjës policie dhe janë referuar materialet procedurale për 14 punonjës policie.

Kostoja e realizimit të këtyre masave është administrative, e mbuluar nga buxheti i shtetit duke mos paraqitur vlerë të shtuar për institucionet me përjashtim të forcimit të kapaciteteve të strukturave policore që janë mbuar nga partnerët e huaj.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këto masë (si më lart), ka një rënie të numrit të veprave për korrupsion nga viti i kaluar, për asnjë prej anketave të marra nga platforma nuk ka nisur hetimi për korrupsion dhe ky tregues performance nuk është arritur. Numri i rasteve të hetuara dhe personave të përfshirë ka qënë më i ulët gjatë vitit 2020, ndoshta edhe për shkak të kufizimeve nga pandemia Covid-19.



Nga këto hetime 75 janë iniciuar si rezultat i denoncimeve nga qytetarët. 8 raste të tjera janë iniciuar si rezultat i emisioneve investigative televizive. Ky tregues është parashikuar të bëhet i matshëm vetëm përmes përmirësimit të sistemit të brendshëm mbajtjes së të dhënave dhe menaxhimit të rasteve hetimore të Policisë së Shtetit me qëllim marrjen e të dhënave të ndara të hetimeve të iniciuara për raste korrupsioni nga hetimet e tjera.

Ky përmirësim i sistemit ishte parashikuar të realizohej në vitin 2018. Për këtë arsye të dhëna janë prodhuar vetëm për vitin 2020.

Gjithashtu nuk janë prodhuar të dhëna për majtjen e treguesit A.4.a.1. Raporti i hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve nëpërmjet portaleve online.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë 2018	-	-
Vlera e synuar 2019 rritje 5%	-	-
Vlera e synuar 2020 rritje 5%	-	-

Portali shqipëriaqëduam.al, i cili në 3 vitet e fundit ka shërbyer si portal kryesor për denoncimin e qytetarëve, nuk ka arritur të ndajë rastet e ankesave për çështje të tjera nga rastet e denoncimit të korrupsionit.

Gjatë viteve 2019 dhe 2020 Policia e Shtetit ka ndarë të dhënat për rastet e hetuara për veprën penale të korrupsionit nga veprat penale në fushën e krimit ekonomik. Numri i rasteve të hetuara dhe personave të përfshirë ka qenë më i ulët gjatë vitit 2020, edhe për shkak të kufizimeve nga pandemia Covid-19.



Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.4.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.4. Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020, ka një rënie të numrit të veprave për korrupsion nga viti i kaluar, për asnjë prej anketave të marra nga platforma nuk ka nisur hetimi për korrupsion dhe ky tregues performance nuk është arritur.

Shkalla e realizimit të objektivit A.4 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm** (31 në 50 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Policisë së Shtetit (<https://mb.gov.al/ep-content/uploads/2020/07/Policia-e-Shtetit->

Risqet për realizimin e Objektivit A.4

Risku për realizueshmërinë e këtij objektivi është i lartë dhe mund të lidhet me proceset dhe sistemin. Për një periudhë 3 vjeçare Policia e Shtetit nuk ka krijuar sistemin e të dhënave të ndara për rastet e hetimit të korrupsionit për të evidentuar veçmas hetimet për korrupsion të iniciuara përmes denoncimeve të qytetarëve.

A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

A.5.a: *Bërja funksionale e sistemit online për deklarimin e pasurive deri në vitin 2020.*¹⁸

A.5.b: *Zbatimi i ligjit për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve*

Plani i veprimit për Objektivin A.5 parashikon 8 Aktivitete dhe 7 Masa.

A.5.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.5.a** për vitin 2020 është: **nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit nga ILDKPKI për zbatimin për deklarimit online të pasurive me 17 institucione: Qendra Kombëtare e Biznesit, (2) Agjencia e Prokurimit Publik, (3) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (4) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, (5) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, (6) Drejtoria e Përgjithshme Detare, (7) Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, (8) Banka e Shqipërisë, (9) Komisioni i pavarur i Kualifikimit, (10) Kolegji i Pavarur i Apelimit, (11) Këshilli i Lartë Gjyqësor, (12) Këshilli i Lartë i Prokurorisë, (13) Prokuroria e Përgjithshme, (14) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, (15) SPAK, (16) Inspektoriat i Lartë i Drejtësisë, (17) Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve.**

Për vitin 2021 vlera e synuar është **deklarimi online i pasurive dhe interesave prej 80% e zyrtarëve që kanë detyrimin për të deklaruar**. Për vitin 2022 vlera e synuar është **forcimi i kapaciteteve të përdoruesve të sistemit të deklarimit elektronik të pasurive dhe interesave privatë përmes trajnimit**. Për vitin 2023 vlera e synuar është **kryerja e analizës së performancës së sistemit elektronik të deklarimit pasurive dhe interesave**.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte **përfundimi i zbatimit, vizualizimit/funksionimit të sistemit, instalimi i bazës së të dhënave dhe ndërtimi i aplikacionit. Zgjidhja e problemeve dhe rikodimi/ritestimi. Testimi i integruar dhe dorëzimi i sistemit. Pajisja me materialet e trajnimit dhe me përdoruesit e trajnimit. Pranimit përfundimtar dhe vendosja në funksionim të plotë e sistemit**. Kjo vlerë e synuar e treguesit u realizua gjatë vitit 2019.

¹⁸ Për shkak se passaporta e treguesve është hartuar dhe miratuar në vitin 2018 ky indikator është i fokusuar tek ngritja e sistemit të deklarimit online. Me zgjatjen e afatit të SNKK deri në vitin 2023, me VKM nr. 516, datë 7.2020, pas vitit 2020 fokusi i indikatorit, ashtu dhe i masave dhe aktiviteteve, përqendrohen tek **përdorimi me efektivitet i sistemit online për deklarimin e pasurive**.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masat (4) si më poshtë.

A. 5.1	Deklarimi i pasurisë nga subjektet e ligjit (deklaruesit dhe personat e lidhur me të) përmes sistemit online
A.5.1.1	80% e subjekteve që mbartin detyrimin për deklaram nëpërmjet sistemit elektronik, e kryejnë atë.
A. 5.2	Mirëmbajtja e sistemit elektronik të deklaramit të pasurive dhe interesave private
A.5.2.1	Sistemi elektronik në gjendje funksionale (mirëmbajtje për çdo vit)
A. 5.3	Forcim i kapaciteve të përdoruesve të sistemit të deklaramit të pasurive nëpërmjet trajnimit
A.5.3.1	Plani dhe materialet e trajnimit të përfunduara.
A.5.3.2	400 përdoruesve të trajnuar në nivel qëndror dhe vendor (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
A. 5.4	Analizimi i funksionimit të sistemit të deklaramit të pasurive dhe interesave private
A.5.4.1	Termet e referencës të hartuara dhe vlerësimi i kryer, i hartuar dhe konsultuar

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që kryesisht fillojnë nga viti 2021, përveç aktivitetit A.5.2.1 i cili fillon tremujorin e parë të vitit 2020.

Për këtë aktivitet, gjatë vitit 2020 është filluar procedura e prokurimit “Tender i Hapur”, me objekt “Shërbimi i Mirëmbajtjes së Sistemit të Deklaramit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit EACIDS”, procedurë e cila ka përfunduar në muajin shtator me shpalljen e fituesit (vonesa të shkaktuara nga pezullimi i procedurave nga Covid-19). ILDKPKI ka vazhduar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në kuadër të ngritjes së sistemit elektronik të deklaramit të interesave private.

Është miratuar akti ligjor i krijimit të bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e deklaramit të pasurisë dhe konfliktit të interesave-EACIDS (vendimi nr.330, datë 22.4.2020), bazë shtetërore nën autoritetin dhe administrimin e ILDKPKI.

ILDKPKI raporton se për vitin 2020 është arritur të nënshkruhet vetëm 1 (një) Memorandum Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme, nga 15 memorandume të parashikuara me institucionet, sipas këtij treguesi, të penguar për shkak të Pandemisë Covid-19 dhe pezullimit apo ushtrimit të aktiviteteve në kushte të kufizuara. Raportohet fillimi i procesit të koordinimit të punës për nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit me SPAK.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, me vetëm një memorandum të nënshkruar ka ndikuar realizimin e treguesit në masën 6%.

Realizueshmëria e këtij treguesi në vite paraqitet si në tabelën më poshtë.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë 2018	<ul style="list-style-type: none"> - Plotësimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës. - Projektimi i sistemit dhe përgatitja e dokumentacionit. - Zhvillimi i sistemit dhe ngritja e infrastrukturës 	Janë realizuar të gjitha procedurave të prjektuara në vlerën e synuar
Vlera e synuar 2019 rritje 5%	<ul style="list-style-type: none"> - Përfundimi i zbatimit, vizualizimit/ funksionimit të sistemit, instalimi i bazës së të dhënave dhe ndërtimi i aplikacionit - Zgjidhja e problemeve dhe rikodimi/ritestimi - Testimi i integruar dhe dorëzimi - Pajisja me materialet e trajnimit dhe me përdoruesit e trajnimit - Pranimi përfundimtar dhe vendosja në funksionim të plotë e sistemit. 	Janë realizuar të gjitha procedurave të prjektuara në vlerën e synuar
Vlera e synuar 2020 rritje 5%	Memorandume Mirëkuptimi të nënshkuara ndërmjet ILDKPKI dhe 17 institucioneve. ¹⁹	Vlera e synuar nuk është arritur. Memorandum i nënshkuar vetëm me 1 institucion nga 17. ²⁰

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.5.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.5.a për vitin 2020 është: realizimi brenda afatit ligjor i hetimeve administrative e 80% të sinjalizimeve të jashtme** (të kryera në ILDKPKI), mbi numrin total të sinjalizimeve të jashtme.

Për vitin 2021 vlera e synuar është *realizimi brenda afatit ligjor i hetimeve administrative e 85% të sinjalizimeve të jashtme* (të kryera në ILDKPKI), mbi numrin total të sinjalizimeve të jashtme. Për vitin 2022 vlera e synuar është *realizimi brenda afatit ligjor i hetimeve administrative e 85% të sinjalizimeve të jashtme, mbi numrin total të sinjalizimeve të jashtme*. Për vitin 2022 vlera e synuar është *vlerësimi gjithëpërfshirës mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*. Për vitin 2023 vlera e synuar është *konklutimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*.

¹⁹ Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme Detare, ATRAKO, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Banka e Shqipërisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, SPAK, Inspektori i Lartë i Drejtësisë

²⁰ Prokuroria e Përgjithshme

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte *realizimi brenda afatit ligjor i hetimeve administrative e 80% të sinjalizimeve të jashtme*. Raporti vjetor i ILDKPKI për vitin 2019 tregon se ka patur 14 sinjalizuesve ndaj ILDKPKI gjatë vitit për të cilat hetimet administrative janë kryer sipas afateve ligjore.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

A. 5.5	Monitorimi i ushtrimit të funksioneve nga njësitë përgjegjëse për zbatimin e ligjit për sinjalizimin
A. 5.5.1	Termet e referencës të hartuara (faza I) Monitorimi i kryer për 166 Njësi Përgjegjëse në sektorin publik (faza II) Raporti vlerësues i hartuar me rekomandimet e dhëna për njësitë përgjegjëse në sektorin publik mbi zbatimin e ligjit të sinjalizimit (faza III)
A. 5.6	Analizim gjithëpërfshirës mbi zbatueshmërinë e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve
A.5.6.1	Termet e referencës të hartuara dhe vlerësimi i kryer, i hartuar dhe shpërndarë, me palët e interesuara
A. 5.7	Organizimi i sesioneve konsultuese dhe hartimi i ndryshimeve të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve
A. 5.7.1	Rekomandime të hartuara bazuar mbi gjetjet e vlerësimit (I) Ndryshime ligjore të hartuara bazuar mbi rekomandimet e hartuara të vlerësimit (II) 3 sesione konsultuese mbi ndryshimet ligjore të hartuara me palët e interesuara (III)

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që kryesisht fillojnë nga tremujori i katërt i vitit 2021.

Por, pamvarësisht këtij fakti, ILDKPKI raporton se gjatë vitit 2020, në ushtrim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, ka regjistruar dhe trajtuar në total 9 raste sinjalizimi dhe 1 rast kërkesë për mbrojtje.

ILDKPKI raporton marrjen e masave për të regjistruar të gjitha rastet e sinjalizuara në Regjistrin e Sinjalizimeve të Jashtme, si dhe ka zhvilluar hetimin administrativ brenda afateve ligjore në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 60/2016 dhe K. Pr. Administrative.

Në përfundim të hetimit administrativ, për zyrtarët e gjetur në shkelje të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, është marrë masa administrative me “gjobë”, si dhe është kërkuar, dhe është zgjidhur konflikti i interesit në përputhje me parashikimet ligjore. Kështu, janë aplikuar 5 (pesë) masa administrative me “gjobë”, si dhe janë zgjidhur rastet me konflikt interesi me dorëheqje nga detyra të zyrtarëve që kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit.

Ndërsa për rastet e tjera të sinjalizuara, ILDKPKI, pas hetimit administrativ, ka vënë në dijeni organin kompetent sipas problematikës së ngritur nga sinjalizuesit, si vijon:

- Njoftim pranë KLSH për auditim të fondeve publike;
- Njoftim për ndjekje penale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Njoftim Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- Njoftim Titullarit të Autoritetit Publik Qendror për marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi rezulton se, ILDKPKI ka përmbushur plotësisht kërkesën për të hetuar, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 60/2016 dhe K.Pr.Administrative, rastet e sinjalizimit, në kufirin prej 100% të vendosur nga treguesi.

Realizueshmëria e këtij treguesi në vite paraqitet si në tabelën më poshtë.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	-	
Vlera e synuar 2018	70% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor	Raportuar 100%. Raportet janë të përfunduara sipas afateve ligjore
Vlera e synuar 2019	80% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor	Raportuar 100%. Raportet janë të përfunduara sipas afateve ligjore
Vlera e synuar 2020	85% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor	Raportuar 100%. 9 raporte të përfunduara sipas afateve ligjore.

Vlerat e synuara të këtij treguesi janë raportuar të realizuar 100%, brenda afatit ligjor, për të gjitha rastet e sinjalizimit të jashtëm, të ardhura pranë ILDKPKI.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.5.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.5. Forcimi i regjimit të deklaramentit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2020 **është 53%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtëme:

$$\frac{86}{110} = 53\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.5 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86 në 110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (<http://ëëë.ildkpkj.al/vendevakante/>). Megjithatë ka pamjaftueshmëri të dhënash në lidhje me vlerësimin adekuat të treguesit “Zbatimi i ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Risqet për realizimin e Objektivit A.5

Përsa i përket forcimit të regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave risku i realizimit të këtij objekti është i ulët. Vonesa prej 1 viti për shkak të mungesës së marrëveshjeve/akteve nënligjore për funksionimin e sistemit mund të vendosë në rrezik të lartë arritjen e vlerës së synuar për vitin 2021, deklarimin online të pasurisë dhe interesave privatë nga 80% e subjekteve deklaruese dhe personat e lidhur me ta. Përsa i përket forcimit të zbatimit të legjislacionit për sinjalizuesit risku është i lartë pasi numri i raportimeve të sinjalizuesve të jashtëm ka qenë i ulët dhe në rënie përgjatë viteve.

A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

A.6.a: Numri i raporteve të publikuara të auditimit nga partitë politike të certifikuara nga auditorët e jashtëm.

A.6.b: Raporti i sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar në kontekstin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor.

A.6.c: Financat e partive politike të audituara në përputhje me rekomandimet e BE/ACFA.²¹

Plani i veprimit për Objektivin A.6 parashikon 11 Aktivitete dhe 5 Masa.

A.6.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.a** për vitin 2020 është: **pranimi** nga KQZ i 80% e raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera.

Për vitin 2021 vlera e synuar është **pranimi** nga KQZ i 80% e raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera. Për vitin 2022 vlera e synuar është **pranimi** nga KQZ i 100% e raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera. Për vitin 2023 vlera e synuar është **pranimi** nga KQZ i 100% e raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera.

²¹ ACFA (Anti Corruption Framework Assessment) është projekti i financuar nga Bashkimi European që u zbatua në periudhën 2014-2015.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte *pranimi nga KQZ i 70% e raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera*. Ky tregues performance u realizua në masën 66.6%.

KQZ caktoi 34 ekspertë të cilët monitoruan dhe audituan fondet dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore 2019 për 36 parti politike dhe 16 kandidatë të mbështetur nga votuesit. 24 raporte auditimi u certifikuan dhe publikuan në faqen e internetit të KQZ-së ose 66.6% (përkundrejt synimit 70%).

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

A. 6.1	Përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i modelit standard për raportimin financiar për vitin kalendarik; Forcim i kapaciteteve për financierët e partive, strukturën e posaçme në KQZ, audituesit ligjorë.
A. 6.1.1	Modeli standard i miratuar/i rishikuar (në përputhje me ndryshimet e reformës legjislative)
A. 6.1.2	Seanca trajnimi të kryera (I) Seanca trajnimi të kryera për modelin e raportimit financiar (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
A.6.3	Përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i formatit standard për raportimin nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë për përdorimin e raporteve të miratuara; Forcim/zhvillim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, për përdorimin e raporteve të miratuara
A. 6.3.1	Modeli standard i miratuar/i rishikuar
A. 6.3.2	Trajnime të kryera për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
A.6.4	Përditësim i vazhdueshëm i udhëzimeve në lidhje me raportimin financiar (në përputhje me ndryshimet mundshme ligjore); Forcim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, për përdorimin e raporteve të miratuara
A. 6.4.1	Udhëzimet e përditësuara të raportimit financiar
A. 6.4.2	Trajnime të kryera për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati.

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit deri në dhjetor 2023.

Reforma Zgjedhore u përfundua me miratimin e ligjit 110/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, hyrë në fuqi më datë 4 gusht 2020, duke sjellë ndryshime të rëndësishme me qëllim rritjen e transparencës së financimit të partive politike për fushatë zgjedhore.

Raportimi financiar i subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore, u shtua me amendament të posaçëm, neni 92/3 i ligjit nr.10019, datë 28.12.2000, “Kodin Zgjedhor i Republikës së

Shqipërisë”, i ndryshuar. Në raportimin financiar subjekti zgjedhor, modeli i të cilit miratohet nga KQZ duhet të përmbajë informacion mbi cdo dhurim, hua, kredi, shpenzim, si dhe bilancin e aseteve dhe detyrimeve, duke përfshirë edhe financimet e shpenzimet e degëve si edhe të kandidatëve të subjekteve zgjedhore.

Raportimi financiar, përfshin fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor në lidhje me mbledhjen e fondeve jopublike, konsistojnë në: uljen e pragut për dhurimet transparente nga 100 mijë leke në 50 mijë lekë. Të gjitha donacionet me vlerë mbi 50 mijë lekë do të mbliidhen nga subjekti zgjedhor, vetëm nëpërmjet një llogarie bankare të posaçme. Llogaria deklarohet në KQZ në momentin e regjistrimit si subjekt zgjedhor. Në formularin e deklarimit përfshihet edhe autorizimi për KQZ-në dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë.

Rishikimi i akteve për raportimin financiar të partive politike; përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i formatit standard për raportimin nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë për përdorimin e raporteve të miratuara; përditësim i vazhdueshëm i udhëzimeve në lidhje me raportimin financiar (në përputhje me ndryshimet mundshme ligjore) rezultojnë të jenë ende në proces hartimi, edhe për shkak sepse do të duhen të rishikohen për përputhje me rregullimin ligjor të ri (Reformën Zgjedhore), duke mos ofruar ende një akt konkret e final të matshëm.


Masat e parashikuara për seanca trajnimi respektive, nuk janë zbatuar sepse janë ndikuar nga mospërfundimi i Reformës Zgjedhore por edhe pandemia Covid-19, përkatësisht aktiviteti A.6.1.2 parashikuar në funksion të masës A.6.1. dhe aktiviteti A.6.4.2 parashikuar në funksion të masës A.6.4.

Realizimi i masave të këtij treguesi për periudhën raportuese është dobët me 50% të aktiviteteve të zbatuara pjesërisht.

Për këtë periudhë raportimi 16 nga 36 raporte të auditimit të financave të partive politike janë certifikuar nga auditorë të jashtëm janë pranuar nga KQZ, për partitë parlamentare. Kjo shifër përbën realizimin me 45% të vlerës së synuar të treguesit.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	61%	
Vlera e synuar 2018, rritje	70%	68.18%
Vlera e synuar 2019, rritje	75%	66.6%
Vlera e synuar 2020, rritje	80%	45%

Grafiku më poshtë tregon vlerat e synuara dhe ato të arritura në 3 vitet.



Siç tregojnë të dhënat e grafikut, realizueshmëria e këtij treguesi në vite ka qënë me e ulët se vlerat e synuara.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.6.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.b** për vitin 2020 është: **rritja në masën 30% e sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar të shkeljeve financiare nga partitë politike.**

Për vitin 2021 vlera e synuar është *rritja në masën 50% e sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar të shkeljeve financiare nga partitë politike.* Për vitin 2022 vlera e synuar është *rritja në masën 70% e sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar të shkeljeve financiare nga partitë politike.* Për vitin 2023 vlera e synuar është *rritja në masën 100% e sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar të shkeljeve financiare nga partitë politike (që do të thote se çdo shkelje financiare e evidentuar do të shoqërohet me sanksion).*

Për vitin 2019 vlera e synuar e treguesit ishte *dhënia në masën 25% e sanksioneve mbi numrin total të shkeljeve financiare nga partitë politike të identifikuar.* Gjatë këtij viti nuk u dha asnjë sanksion për shkelje të rregulave financiare prej partive politike. Ky tregues performance nuk u realizua për atë vit.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

A. 6.2	Ngritja e kapaciteteve profesionale për personat përgjegjës që kontrollojnë financimin e partive politike; Forcimi i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ
A. 6.2.1	Trajnime të kryera (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
A.6.2.2	Tryeza pune/seminare për stafin e KQZ.


Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, deri në dhjetor 2023.

Kjo masë nuk është realizuar sipas parashikimit për këtë periudhë raportuese pasi seminaret/seancat trajnuese të planifikuara nuk u zhvilluan për shkak të pandemisë Covid-19.

Për këtë periudhë raportimi KQZ konstatoi 36 rate të shkeljes së rregullave të financimit dhe 20 partive politike iu vendosën sanksione. Vlera e synuar e këtij treguesi është realizuar me 154% pasi kjo shifër përbën 55% të sanksioneve të dhëna, nga 30% që ishte vlera e synuar.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	38%	
Vlera e synuar 2018, rritje	25%	0%
Vlera e synuar 2019, rritje	25%	0%
Vlera e synuar 2020, rritje	30%	55%

Grafiku më poshtë tregon vlerat e synuara dhe ato të arritura në 3 vitet.



Vlera e synuar e këtij treguesi është realizuar dhe tejkaluar vetëm në vitin 2020.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.6.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.c** për vitin 2020 është: **rritja në 5 e numrit total të raporteve financiare vjetore dhe raporteve financiare të fushatës dhe raportet përfundimtare të auditimit të 5 partive më të mëdha politike, krahasuar me vitin e mëparshëm.**

Vlera e synuar për vitet 2021, 2022 dhe 2023 është mbajtja në 5 e raporteve financiare vjetore të partive politike.

Për vitin 2019 vlera e synuar e treguesit nuk u realizua pasi vetëm financat e 2 partive politike u audituan në përputhje me rekomandimet e projektit ACFA.

Realizimi i vlerave të treguesit është parashikuar që të mundësojë:

- thjeshtësimin e raportimit financiar dhe kërkesave të auditimit, të raportimit dhe publikimit të raportit financiar të KQZ-së.
- ngritjen e një strukture të përshtatshme për kontrollin dhe verifikimin e pavarur të raporteve të auditimit.
- përmirësime të procedurës së brendshme dhe qartësimin e përgjegjësi të stafit të KQZ-së për kontrollin e financimit të partive politike.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

A.6.5	Përditësim i vazhdueshëm i metodologjisë së kontrollit dhe verifikimit të financave të partive politike; Forcimi i kapaciteteve për strukturën e posaçme në KQZ, dhe gjithë palët e interesuara në lidhje me këtë metodologji (seanca trajnimesh të programuara)
A.6.5.1	Metodologji e përmirësuar/ e përditësuar
A.6.5.2	Nr. i personave të trajnuar (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
A.6.5.3	Raportet e kontrollit të financave të partive politike të publikuar/ raporte të KQZ të publikuar.

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që kryesisht fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, deri në dhjetor 2023.

Kjo masë është zbatuar pjesërisht gjatë vitit 2020. Është kryer një analizë gjithëpërfshirëse e sistemit të kryqëzimit të raporteve financiare, të partive politike që përfshin: raportet e ekspertëve monitorues, të audituesve dhe të subjekteve zgjedhore, por që aktet (Metodologjia e kontrollit dhe verifikimit të financave të partive politike) duhen hartuar në përputhje me ndryshimet e reja ligjore. Në bazë të kësaj analize janë nxjerrë edhe nevojat për ndryshime të nevojshme në procedurat e brendshme dhe në sistemin e kryqëzimit dhe verifikimit. Është identifikuar nevoja për përmirësimin dhe hartimin e procedurave që lidhen me:

1. Kontrollin paraprak të raporteve të financave zgjedhore
2. Kontrollin e thelluar të raporteve të financave zgjedhore
3. Procedurën e shqyrtimit administrative
4. Procedurën për vlerësimin e ankesave dhe çështjet e papajtueshmërisë.


Gjithashtu, në faqen zyrtare të KQZ janë publikuar 7 raporte financiare vjetore të partive politike (<http://cec.org.al/raportet-vjetore-financiare-te-partive-politike>)

Realizimi i masave të këtij treguesi për periudhën raportuese është i pjesshëm me 50% të aktiviteteteve të zbatuara pjesërisht.

Për këtë periudhë raportimi KQZ ka kryer 5 auditime në përputhje me rekomandimet e projektit ACFA të BE.²² Vlera e synuar të këtij treguesi është arritur 100%.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	5	
Vlera e synuar 2018, rritje	5	5
Vlera e synuar 2019, rritje	5	2
Vlera e synuar 2020, rritje	5	5

Realizueshmëria e këtij treguesi në 3 vitet e matura paraqitet në grafikun më poshtë.



Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.6.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.6. Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2020 është **99.6%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtëme:

²² Projekti i BE-së ‘Vlerësimi i Kuadrit Antikorrupsion në Shqipëri’ (ACFA), 2014 i cili dha 15 rekomandime përfshirë financimin e partive politike

" & " _____ " = 99.6%

Shkalla e realizimit të objektivit A.6 për këtë periudhë raportimi është **dobët** (0 deri në 30 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (<http://kqz.gov.al/>).

Risqet për realizimin e Objektivit A.6

Risku i realizimit të këtij objektiv është i mesëm për shkak të çështjeve të lidhura me mjedisin e jashtëm siç janë vendime politike apo probleme me kapacitetet audituese të partive politike.

A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

Për këtë objektiv janë përcaktuar 4 tregues performance:

A.7.a: Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuar dhe zbatuara nga subjektet publike.

A.7.b: Numri i rasteve që vijnë nga auditime të brendshme që raportohen për hetim financiar

A.7.c: Numri i referimeve në prokurori si pasojë e inspektimeve financiare

A.7.d: Numri i inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë referuar sinjalizimeve të pranuar

Plani i veprimit për Objektivin A.7 parashikon 12 Aktivitete dhe 4 Masa.

A.7.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.a** për vitin 2020 është trend rritës përkundrejt vlerës bazë të 2015.

Vlera e synuar për vitet 2021, 2022 e 2023 është trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte trend në rritje krahasuar me vitin e mëparshëm – minimumi 3%, i cili në vitin 2018 ishte arritur 57%. $57 + 1.71(3\% \text{ të } 57) = 58.71\%$. Ky tregues performance u realizua në masën 58.71%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masat (1) si më poshtë.

A. 7.1	Rritja e kapaciteteve të auditit të brendshëm përmes zhvillimit të trajnimeve të vijueshme profesionale (TVP) të organizuara çdo vit, ku përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit dhe kryerja e vlerësimeve të jashtme të cilësisë (VJC), të cilat fokusohen tek vlerësimi i performances së veprimtarisë audituese dhe tek rekomandimet e dhëna për përmirësimet e nevojshme në aktivitetin e auditit të brendshëm
A. 7.1.1	Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi dhe miratimi i programit të TVP (II) Përgatitja e materialeve të trajnimit (III) Zbatimi i programit të TVP dhe 100% e auditit të brendshëm të punësuar dhe të certifikuar në sektorin publik (IV) 15 vlerësime të jashtme të cilësisë/vit.
A. 7.1.2	Hartimi i udhëzuesit për audituesit e brendshëm në auditimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.
A.7.1.3	Trajnimi i audituesve të brendshëm mbi prezantimin e udhëzuesit në auditimin e mashtrimit financiar dhe kontrollit. Trajnimi i audituesve të brendshëm mbi etikën dhe integritetin.
A.7.1.4	Kryerja e auditimeve të brendshme pilot dhe vizitë studimore mbi etikën dhe integritetin.

Realizimi i masës së parashikuar do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit deri në dhjetor 2023.

Me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.427, datë 20.12.2019, është miratuar “Programi i Trajnimit të Vijueshëm Profesional të audituesve të brendshëm për vitin 2020”, i parashikuar të zhvillohej gjatë periudhës mars-nëntor 2020, por për shkak të pandemisë Covid-19, ky proces u zhvillua kryesisht në muajt nëntor - dhjetor 2020, në masën 100%.

Bazuar në planin vjetor të vlerësimeve të jashtme të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, janë parashikuar të kryhen 19 vlerësime të jashtme të cilësisë dhe janë realizuar 19 vlerësime të jashtme të cilësisë në: Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Bashkinë Tiranë, Spitalin Rajonal Shkodër dhe Spitalin Rajonal Kukës, UKT, Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjensia e Zhvillimit Bujqësor Rural, Bashkia Durrës, Bashkia Elbasan dhe Spitali i Traumës Tiranë, UK Pogradec sha, UK Korce sha, Bashkia Lushnje, Bashkia Gramsh, Bashkia Ura-Vajgurore, Bashkia Korce dhe Albpetrol sh.a. Gjatë këtyre vlerësimeve janë evidentuar mangësitë dhe janë dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Realizimi i masës të këtij treguesi për periudhën raportuese është i pjesshëm me vetëm 25% të aktiviteteve të zbatuara, (vetëm aktiviteti A7.1.1 si më lart përshkrimi) pasi për tre prej aktiviteve A7.1.2; A7.1.3 e A7.1.4 nuk ka raportim për vitin 2020.

Në muajin Maj 2020, u finalizua nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik “Raporti mbi Funkionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2019”. Në këtë raport është

analizuar niveli i pranimi dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm për vitin 2019. Gjatë vitit 2019, nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm janë dhënë 8314 rekomandime dhe janë pranuar nga subjektet e audituara 8294 rekomandime ose 99,8% e tyre. Gjatë vitit 2019, nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm janë pranuar nga subjektet e audituara 9294 rekomandime dhe janë zbatuar 4941 rekomandime ose 60% e tyre.

Viti	Rekomandime të pranuar	Rekomandime të pranuar dhe zbatuara
2016	7629	5183
2017	8341	4625
2018	7897	4501
2019	8294	4941
2020 ²³		

Nën-treguesi a.1: Rekomandimet e nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të pranuar nga institucionet. Trend rritës Viti 2019 - 99,8% e rekomandimeve të pranuar.


Numri i rekomandimeve të prodhuara nga auditorët e brendshëm dhe të pranuar nga institucionet.

Nën-tregues a.2²⁴: Numri i rekomandimeve të nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të implementuara/zbatuara nga insitucionet. Trend rritës Viti 2019 - 60% e rekomandimeve të zbatuara.

Realizueshmëria e këtij treguesi paraqitet ne grafikon më poshtë.

²³ Këto të dhëna analizohen nga Raportet Vjetore të Auditimit të Brendshëm të cilat sipas përcaktimeve ligjore duhet të konsolidohen në Maj të vitit pasardhës. Pra ky tregues për vitin 2020 do të raportohet në Maj të vitit 2021.

²⁴ Raporti për vitin 2020 përfundon në Maj 2021.



Matja duke iu referuar vlerës së vitit të mëparshëm ka sjellë si pasojë që për shkak të luhatjeve me realizueshmërinë e vlerës së synuar në vite, vlera kumulative e viteve të matura të jetë më e ulët se vlera kumulative e synuar.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.7.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.b** për vitin 2020 është: **rritja në masën 10 %**.

Vlera e synuar për vitet 2021, 2022 e 2023 është **rritja në masën 10%**.

Për vitin 2019 vlera e synuar e treguesit ishte trend në rritje krahasuar me vitin e mëparshëm – minimumi 3% rritje. Ky tregues performance nuk u realizua për atë vit pasi vetëm 5 raste u referuan për inspektim financiar publik nga strukturat e auditimit ndërkohë që në vitin 2018 ishin 11 raste të tilla.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (1) si më poshtë.

A. 7.2	Ndërgjegjësim me qëllim informimin e drejtuesve të njësive të auditit të brendshëm mbi mundësitë e bashkëpunimit me inspektimin financiar publik
A. 7.2.1	Takim me drejtues të DAB të institucioneve, 2 seminare/vit
A.7.2.2	Përfaqësuesit e njësive DAB të institucioneve informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me inspektimin financiar public
A.7.2.3	Takime të kryera

Realizimi i masës së parashikuar do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit deri në dhjetor 2023.

Gjatë vitit 2020, në kuadër të ndërgjegjësimit me qëllim informimin e drejtuesve të njësive të auditit të brendshëm mbi mundësitë e bashkëpunimit me inspektimin financiar publik, janë zhvilluar 2 takime me përfaqësuesit e njësive DAB. Për shkak të pandemisë Covid-19, ky proces u zhvillua duke respektuar masat anti-Covid 2019 (online).


Janë zhvilluar takime me drejtues të disa institucioneve lidhur me çështje konkrete bashkëpunimi, në funksion të veprimtarisë së inspektimit financiar publik dhe rasteve të adresuara nga këto struktura.

Përfaqësuesit e njësive DAB janë informuar mbi mundësitë e bashkëpunimit me inspektimin financiar publik.

Gjatë vitit 2020, pranë strukturës së Drejtorisë së Inspektimit janë adresuar 9 sinjalizime nga strukturat audituese, referuar gjetjeve/parregullsive të konstatuara gjatë misioneve të auditimit, krahasur me 8 sinjalizime gjatë vitit 2019. Aktualisht për vitin 2020 kemi një rritje prej 12.5% të këtij treguesi.

Për këtë periudhë raportimi, janë referuar për inspektim financiar publik nga strukturat e auditimit 9 raste. Kjo shifër përbën trend rritës në krahasim me vitin e mëparshëm kështu që vlera e synuar të këtij treguesi është realizuar në masën 100%.

Grafiku më poshtë tregon tendenca e realizimit në 3 vitet e matura.



Vlera e synuar me trend rritës prej 3% rezulton e papërshtatshme për këtë tregues pasi nisur nga vlera fillestare bazë prej 8 hetimesh financiare të iniciuara, vlera e synuar në vitet vijuese të jetë e pazbatueshme për t'u matur. Sidoqoftë vlera kumulative është realizuar në 3 vite.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.7.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.c** për vitin 2020 është: **3%** nga viti referues (2019). Vlera e synuar për vitet 2021 është 5% nga viti referues (2019), vlera e synuar për vitin 2022 është 10% nga viti referues (2019) dhe vlera e syuar për vitin 2023 është 15% nga viti referues (2019).

Për vitin 2019 vlera e synuar e treguesit nuk u realizua pasi vetëm 2 raste u referuan në Prokurori (nga 7 raste inspektimit dhe 5 inspektime ishin në proces në kohën e raportimit).

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masat (1) si më poshtë.

A.7.3	Rritja e kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit
A.7.3.1	Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi i programit të trajnimit (II) Trajnimi i inspektorëve financiarë publikë, lidhur me trajtimin e parregullsisve financiare, keqmenaxhimit financiar, shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) (III)
A.7.3.2	Trajnime të strukturës së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policor Tiranë, me trajnues nga strukturat e Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, etj. *Trajnimet kryhen për çdo vit të zbatimit të PV
A.7.3.3	Kryerja e vizitave studimore dhe trajnimeve mbi etikën dhe integritetin (aktivitet që fillon në vitin 2021)
A.7.3.4	Përfaqësuesit e strukturës Antikorrupsion të informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me strukturat e tjera ndërinstitucionale, dhe të zhvillojnë seminare të përbashkëta lidhur me detyrat e tyre funksionale (DPD, DPT, PSH, etj.)

Realizimi i masaës së parashikuar do të kryhet përmes aktiviteteve që kryesisht fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, deri në dhjetor 2023, (aktiviteti A7.3.3 është parashikuar të fillojë zbatimin në vitin 2021).

Gjatë vitit 2020, në kuadër të rritjes së kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit u realizua vlerësimi i nevojave për trajnim të inspektorëve financiarë publik staf i DIFP (6 persona) dhe u realizua trajnimi i tyre lidhur me trajtimin e parregullsisve financiare, keqmenaxhimit financiar, shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit. Aktiviteti është realizuar në masën 100%, pasi gjatë këtij viti u bë shfuqizimi i listës së inspektorëve të jashtëm dhe u shpall procesi i përzgjedhjes së inspektorëve të rinj dhe veprimtaria e DIFP është realizuar vetëm nga stafi i brendshëm. Konkretisht, lidhur me inspektorët e jashtëm, u realizua procesi i rishikimit të listës aktuale e cila u shfuqizua dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.184/2 Prot, datë 17.09.2020 “Për shpalljen e procesit të përzgjedhjes së inspektorëve financiar publik, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës


publike, apo jashtë saj”, Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, shpalli procesin e përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publik. Në përfundim të procesit, me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.5, datë 15.01.2021 “Për përzgjedhjen e Inspektorëve financiar publik, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike dhe jashtë saj”, u miratua lista e Inspektoreve financiar publik, ekspertë të jashtëm, të cilët do të trajnohen gjatë vitit 2021.

Aktiviteti është realizuar në masën 100%, në kushtet e përzgjedhjes së inspektorëve të jashtëm financiar publik veprimtaria e DIFP është kryer vetëm nga stafi i brendshëm.

Gjatë vitit 2020 janë shqyrtuar 85% e sinjalizimeve të adresuara pranë strukturës së DIFP.

Për këtë periudhë raportimi, nuk është dhënë informacioni i nevojshëm për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar.

Grafiku më poshtë tregon tendenca e realizimit në 3 vitet e matura.



Edhe për këtë tregues, vlera e synuar me trend rritës prej 3% rezulton e papërshtatshme për të matur në mënyrë adekuate këtë tregues pasi nisur nga vlera fillestare bazë prej 5 referimesh penale, vlera e synuar në vitet vijuese të jetë e pazbatueshme për t’u matur. Sidoqoftë vlera kumulative është realizuar në 3 vite.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.7.d

Vlera e synuar për treguesin e performancës A.7.d për vitin 2020 është: **për 80% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteteret e ligjit), brenda vitit raportues të jenë iniciuar inspektime.** Vlera e synuar për vitet 2021 është për 85% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteteret e ligjit) brenda vitit raportues, të jenë iniciuar inspektime, vlera e synuar për vitin 2022 është për 90% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteteret e ligjit), të jenë iniciuar inspektime dhe vlera e synuar për vitin 2023 është për 95% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteteret e ligjit), të jenë iniciuar inspektime.

Për vitin 2019 janë përfunduar 11 inspektime, nga 30 inspektime të kryer në institucione. Është i njëjti numr dhe një vit më parë (2018).

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masat (2) si më poshtë.

A.7.4	Veprimtari informuese/sensibilizuese, me qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe publikut mbi funksionet e DIFP si dhe rritjen e transparencës mbi misionin e inspektimit
A.7.4.1	Informacion i përditësuar në faqen zyrtare mbi DIFP (I) Deklarata të bëra publike (II) Menu informacioni në ëeb (III)

Realizimi i masës së parashikuara kryhet përmes aktivitetit që fillon prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, deri në dhjetor 2023.


Gjatë vitit 2020, në kuadër të veprimtarive informuese/sensibilizuese, me qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe publikut mbi funksionet e DIFP si dhe rritjen e transparencës mbi misionin e inspektimit, nga ana e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, është pasqyruar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, informacioni mbi inspektimet e kryera, gjetjet kryesore dhe masat e rekomanduara për subjektet e inspektuara, në masën 100%.

Për vitin 2020 për 85% të sinjalizimeve të cilat plotësonin kriteret e parashikuara në ligjin e inspektimit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, janë iniciuar inspektime financiare publike brenda vitit raportues.

Me VKM Nr. 516, datë 1.7.2020, vlera e synuar për vitin 2020 është ndryshuar nga 37 inspektime në vit - parashikuar në pasaportën e treguesve të miratuar me VKM Nr. 241, datë 20.4.2018 - në *“Për 85% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteret e ligjit) brenda vitit raportues, të jenë iniciuar inspektime”*.

Për këtë periudhë raportimi, nuk është dhënë informacioni i nevojshëm për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar.

Pamvarësisht formulës së matjes, në raportimin e kryer nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka raportuar një numër të inspektimeve të kryer për vitin 2020, i cili do të bënte të mundur vlerësimin kumulativ të inspektimeve në 3 vite.



Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.7.

Niveli i realizimit të Objektivit A.7 *Përmiresimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për këtë periudhën janar - dhjetor 2020 **është në pamundësi për tu patur.**

" & " _____

Shkalla e realizimit të objektivit A.7 për këtë periudhë raportimi është **mirë** (31 në 50 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesin e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, (<https://ëëë.financa.gov.al/raportet-vjetore/>) të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik (<https://financa.gov.al/raportime-vjetore-te-veprimtarise-se-inspektimit-financiar-publik/>) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për treguesin A.7.c dhe A.7.d të dhënat për vitin 2019 nuk rakordojnë më të dhënat e raportuara në kuadër të Raportit Vjetor të Monitorimit të SNKK. Për treguesin A.7.c janë kryer 3 referime në prokurori (2 raportuar në Raportin Vjetor të Monitorimit) dhe për treguesin A.7.d janë kryer 12 inspektime (12 raportuar në Raportin Vjetor të Monitorimit).

Risqet për realizimin e Objektivit A.7

Risku i realizimit të këtij objekti është i mesëm për shkak të çështjeve që lidhen me komunikimin dhe informimin si dhe proceset operacionale dhe sistemin e menaxhimit të të dhënave.

A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance: A.8: *Numri i institucioneve publike që kanë kryer analiza vjetore për prirjet për korrupsion.*

Plani i veprimit për Objektivin A.8 parashikon 10 Aktivitete dhe 7 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.8** për vitin 2020 është: *udhëzime të zhvilluara dhe të pranuar për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike (qendrore); Është përgatitur një program trajnimi për zbatimin e manualit; Është vendosur një plan veprimi ndërinstytucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut; Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut kanë filluar të testohen dhe zbatuara në 10 institucione publike (qendrore)/ministri.*

Për vitin 2021 vlera e synuar është *mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet e varësisë së MD.* Për vitin 2022 vlera e synuar është *mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet qendrore (ministritë).* Për vitin 2023 vlera e synuar është *të gjithë ministritë, institucionet e varësisë së tyre kanë zbatuar vlerësim risku.*

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte udhëzimet (manuali) për vlerësimin e vlerësimit të riskut janë zhvilluar. Ky tregues performance nuk u realizua për atë vit.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (10) dhe masat (7) si më poshtë.

A. 8.1	Dokumenta strategjike të hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës (analiza e riskut për prirjet ndaj korrupsionit)
A. 8.1.1	Udhëzues/metodologjia mbi vlerësimin e riskut të integritetit në qeverisjen qendrore, i hartuar dhe i miratuar
A.8.2	Forcim i kapaciteteve të stafit të MD mbi procesin e vlerësimit të riskut të integritetit për këtë institucion
A. 8.2.1	Trajnim i stafit mbi identifikimin e risqeve të integritetit /Takime pune mbi identifikimin e proceseve të punës që janë të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit (faza I) Identifikim i risqeve të integritetit sipas proceseve të punës (faza II) Analizim dhe vlerësim i intensitetit të risqeve të identifikuar (faza III) Trajtimi i risqeve prioritare dhe atyre të moderuara si edhe hartimi i planit të veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në MD (faza IV)
A.8.3	Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet e varësisë së MD sipas modelit të zhvilluar në MD (Udhëzuesit)
A. 8.3.1	Plan pune për informimin dhe prezantimin ndaj institucioneve të varësisë të MD, për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe prezantimi i udhëzuesit

A. 8.3.2	Vlerësimi i riskut në institucionet e varësisë të MD, i hartuar dhe i miratuar
A.8.4	Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet qendrore dhe varësitë e tyre, sipas Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për qeverisjen qendrore (udhëzuesi)
A.8.4.1	Plan pune për informimin dhe prezantimin ndaj ministrive të linjës, për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe prezantimi i Udhëzuesit ministrive;
A.8.4.2	Vlerësimi i riskut në nga ministritë, i hartuar dhe i miratuar
A.8.4.3	Vlerësimi i riskut në nga ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë, i hartuar dhe i miratuar
A.8.5	Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë shtetërore
A.8.5.1	Nr. i raporteve të inspektimeve të grupeve të inspektimit (I) Nr. i masave të marra në përfundim të inspektimeve (II) Nr. i rasteve të referuara në prokurori (III)
A.8.6	Raportimi i rasteve të masave disiplinore, administrative e kallëzimeve penale për rastet e korrupsionit në administratë
A.8.6.1	Nr. i rasteve/zyrtarëve të gjetur në shkelje për praktika korruptive.
A.8.7	Transparencë e rritur e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit për rastet e kontrolleve të bëra nga TFA
A.8.7.1	Nr. i komunikimeve (deklarata, konferenca, njoftime për shtyp) online të KKK për rastet e kontrolleve të TFA

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, deri në dhjetor 2023 (përfundim bëjnë aktiviteti A.8.3.2 dhe të gjitha aktivitetet e masës A.8.4 që fillojnë zbatimin në vitin 2021 e 2022).

Gjatë vitit 2020, është hartuar, miratuar e publikuar Udhëzuesi “Metodologji e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Qeverisjen Qendrore”. Metodologjia është hartuar në bashkëpunim me shoqërinë civile, një proces i hapur hartimi, konsultimi dhe analize dhe dakordësuar me ekspertizën e DBE në fushën antikorrupsion. MVRI është relevante për vlerësimin e riskut të integritetit në të gjithë institucionet e qeverisjes qendrore dhe synon të kontribuojë në forcimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të riskut të integritetit në sektorin publik në Shqipëri. MVRI paraqet një kuadër të përgjithshëm të koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut, i cili përfshin: planifikimin, identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit, si dhe hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të integritetit në një institucion publik.

Ky dokument është miratuar me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë, nr.334 datë 7.10.2020, publikuar në link: <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2020/10/Metodologjia-e-Vleresimit-te-Riskut-te-Integritetit-per-Institucionet-e-Qeverisjes-Qendrore.pdf>.

Të gjitha etapat e parashikuara në përmbushje të masës janë kryer. Janar 2020: Takimet janë zhvilluar pranë MD, nga ekspertë që kanë hartuar edhe manualin MVRI; gjithsej janë kryer 13 takime (15 -23 janar 2020). Qëllimi i këtyre takimeve fokus-grupe, ishte së pari, identifikimi i të gjitha proceseve të punës që ndjek MD dhe që mund të jenë të ekspozuara përballë korrupsionit, shkeljeve të integritetit, sjelljet joetike dhe joprofesionale dhe të tjera parregullsi, si dhe së dyti identifikimi dhe analiza e riskut të integritetit. Takimet evidentuan risqet e integritetit sipas fushave dhe ndikimin e tyre në fushën e përgjegjësisë së MD. Shkurt: Analizim dhe vlerësim i intensitetit të risqeve të identifikuar. Mars: Trajtimi i risqeve prioritare dhe atyre të moderuara si edhe hartimi i planit të veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në MD. Prill – Maj- Qershor: Finalizimi i draft dokumentit.

Në muajin nëntor 2020, është bërë dërgimi zyrtar i MVRI pranë varësive të MD (shkresa nr. 6158/5 datë 9 11 2020) për njohje dhe zbatim, duke u kërkuar dhe përcaktuar si detyrë vijueshmëria prej tyre e zbatimit të Metodologjisë dhe fillimi i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit. Në datë 12.11.2020 u organizua një tryezë lancimi me pjesëmarrje të titullarë/përfaqësues të varësive/pika kontakti antikorrupsion ku u bë edhe prezantimi i MVRI, në formatin hibrid (fizik dhe online). Testimi dhe zbatimi i këtij procesi është në proces dhe vijon në vitet e tjera të PV.

Për vitin 2020, Task Forca Antikorrupsion nuk ka pasur të dhëna. Informacione mbi kontrole dhe inspektime për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë shtetërore dhe varësi të tyre mund të konsultohen në aneksin I të këtij raporti monitorimi.

Masat A.8.1 e A 8.2 janë mbështetur financiarisht nga bashkëpunimi me PNUD. Masat A8.5 e A.8.6 vijnë të jenë mbuluar financiarisht nga buxhetet e institucioneve raportuese.

Tabela më poshtë tregon realizueshmërinë e këtij treguesi në 3 vitet e matura.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	- Mungesa e kuadrit për kryerjen e vlerësimit sistematik të rrezikut të integritetit/korrupsionit	
Vlera e synuar 2018	- Është hartuar dhe miratuar udhëzimi/manuali për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit në institucionet publike si pjesë e planit të integritetit. - Është hartuar një program trajnimi lidhur me zbatimin e manualit. - Po zbatohet një plan veprimi ndër institucional për kryerjen e vlerësimeve të vlerësimit të rrezikut të korrupsionit.	Vlera e synuar nuk është arritur.
Vlera e synuar 2019	- Instrumenti i hartuar për vlerësimin e rrezikut po zbatohet në 10 Ministri.	Vlera e synuar nuk është arritur.
Vlera e synuar 2020	- Udhëzime të zhvilluara dhe të pranuar për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike (qendrore); - Është përgatitur një program trajnimi për zbatimin e manualit;	Është miratuar udhëzimi për kryerjen e vlerësimit të riskut

	<ul style="list-style-type: none"> - Është vendosur një plan veprimi ndërinstytucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut; - Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut kanë filluar të testohen 2020 dhe zbatuara në 10 institucione publike qendrore/ministri 	<p>në institucionet publike. Është hartuar programi i trajnimit për zbatimin e manualit dhe kryerjen e vlerësimit të riskut, për të filluar nga zbatimi në vitin në vijim (2021) Plan veprimi ndërinstytucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut rezulton ende i papërfunduar (në proces). Por nuk realizuar produkti i 4-rt i treguesit.</p>
--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Vlera e parashikuar për vitin 2018 është realizuar pjesërisht në vitin 2020. Nga 4 komponentë të vlerës së synuar janë realizuar plotësisht 2 komponentë, 1 në proces dhe 1 porealizuar.

Për këtë periudhë raportimi, është arritur të mblidhet informacioni dhe të dhënat e nevojshme për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, të realizuar në masën 50 %.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.8

Niveli i realizimit të Objektivit A.8 *Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2020 është **50%**.

Shkalla e realizimit të objektivit A.8 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesin e performancës janë të verifikueshme përmes faqes së internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp->

Risqet për realizimin e Objektivit A.8

Risku i realizimit të këtij objekti është i mesëm për shkak të çështjeve që lidhen me kapacitetet institucionale dhe angazhimin e institucioneve për të vijuar me testimin e metodologjisë dhe kryerjen e vlerësimit të riskut të integritetit pranë ML-ve.

A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publik

Për këtë objektivi është përcaktuar 1 tregues performance:

A.9: Numri i ministrive që kanë zhvilluar dhe publikuar një plan integriteti në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit.

Plani i veprimit për Objektivin A.9 parashikon 5 Aktivitete dhe 5 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.9** për vitin 2020 është: **një model (strukturë) për një plan integriteti në Shqipëri, pranuar dhe publikuar nga MD.**

Për vitin 2021 vlera e synuar është të gjitha varësitë e MD miratuar dhe publikuar një plan integriteti. Për vitin 2022 vlera e synuar të gjitha institucionet qendrore (ministritë) miratuar dhe publikuar një plan integriteti. Për vitin 2023 vlera e synuar të gjitha varësitë e institucioneve qendrore miratuar dhe publikuar një plan integriteti.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte hartimi nga MD i udhëzuesit/strukturës për zhvillimin e Planeve të Integritetit. Ky tregues performance nuk u realizua për atë vit.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masat (5) si më poshtë.

A. 9.1	Dokumente strategjike të hartuara përmes një procesi gjithëpërfshirës (plan integriteti)
A. 9.1.1	Grup pune i ngritur (faza I) Metodologji e zhvilluar (faza II) Nr takimeve të kryera (fokus grupe) për hartimin e draft dokument plan integriteti për Ministrinë e Drejtësisë (faza III) Dokumenti Plan Integriteti i MD i hartuar dhe miratuar (faza IV)
A.9.2	Hartimi/miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet e varësitë e MD
A. 9.2.1	Takime informuese/ndërgjegjësuese për punonjësit e varësive të MD mbi procesin e hartimit/miratimit dhe zbatimit të Planeve të Integritetit; Nr. i Planeve të Integritetit të hartuara dhe të miratuara nga institucionet e varësisë së MD
A.9.3	Hartimi/miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet qendrore (ministritë)

A. 9.4.1	Takime informuese/ndërgjegjësuere për punonjësit e institucioneve të varësive mbi procesin e hartimit/miratimit dhe zbatimit të Planeve të Integritetit; Dokumenti Plan Integriteti i hartuar dhe miratuar
A.9.5	Dokumente strategjike të hartuara përmes një procesi gjithëpërfshirës/metodologjia-udhëzuesi për vlerësimin e zbatimit të masave
A.9.5.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e zbatimit të vlerësimit të PI; ngritja e një strukture të raportit të vlerësimit

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, deri në dhjetor 2023 (masat A.9.3; A.9.4 e A.9.5 dhe aktivitetet e tyre fillojnë zbatimin në vitin 2021, 2022 e 2023).

Gjatë vitit 2020, është përfunduar së hartuari manuali për hartimin e planeve të integritetit. Dokumenti MVRI (i përshkruar në masën (A.8.1) pjesë përbërëse të tij, kreu 5, ka modelin për hartimin e planit të integritetit për institucionet publike, me këtë strukturë: Informacion bazë për institucionin dhe personat përgjegjës mbi përgatitjen dhe zbatimin e Planit të Integritetit; Një model urdhri për zhvillimin e një plani integriteti për Institucionin X; Modeli i njoftimit mbi hartimin e Planit.

Me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë nr.333, datë 7.10.2020, është miratuar Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, dhe është publikuar në link <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2020/10/Plani-i-Integritetit-p%C3%ABr-Ministrin%C3%AB-e-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-2020-2023.pdf>

Është zhvilluar një takim informimi me titullarë/përfaqësues të varësive të MD për njohjen me modelin dhe përmbajtjen e PI të MD e të procesit të kryer në 12 nëntor 2020, në formatin hibrid (fizik dhe online).

Masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2020, janë mbështetur financiarisht nga bashkëpunimi me PNUD.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këtë masë (si më lart), duke hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për Ministrinë e Drejtësisë.

Tabela më poshtë tregon realizueshmërinë e këtij treguesi në 3 vitet e matura.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Mungesa e kuadrit për hartimin e planeve të integritetit.	
Vlera e synuar 2018	Një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë.	Vlera e synuar nuk është arritur.
Vlera e synuar 2019	10 ministri kanë miratuar dhe publikuar planin e integritetit	Vlera e synuar nuk është arritur.

Vlera e synuar 2020	Një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë.	Është miratuar udhëzuesi për hartimin e planit të integritetit.
---------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------

Realizimi i vlerave të synuara të këtij treguesi ka qënë i ngadalshëm dhe vlera e synuar në vitin 2018 u realizua në vitin 2020.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.9

Niveli i realizimit të *Objektivit A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2020 është **100%**, duke hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për Ministrinë e Drejtësisë.

Shkalla e realizimit të objektivit A.9 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesin e performancës janë të verifikueshme përmes faqes së internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2020/10/Plani-i-Integritetit-p%C3%ABr-Ministrinë-e-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-2020-2023.pdf>

Risqet për realizimin e Objektivit A.9

Risku i realizimit të këtij objektiv është i mesëm për shkak të çështjeve që lidhen me kapacitetet institucionale dhe angazhimin e institucioneve të varësive të MD-së për të vijuar me testimin e metodologjisë dhe kryerjen e vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimin e miratimit e planeve të integritetit.

A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

A.10: Statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike (Çdo gjashtë muaj).

Plani i veprimit për Objektivin A.10 parashikon 2 Aktivitete dhe 2 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.10** për vitin 2020 është *statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave mbi korrupsionin duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.*

Vlerat e synuara për vitet 2021, 2022 e 2023 janë *statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.*

- A) Numrin e hetimeve të nisura
- B) Numri i kallëzimeve të kërkuara nga Prokuroria
 - 1) Numrin e kërkesave për sekuestrim
- C) Numri i dënimeve
 - 1) Numri i kërkesave të miratuara për sekuestrim
 - 2) Numri i kërkesave të miratuara për konfiskim
- D) Të dhënat për administrimin e pasurive:
 - 1) Vlera e pasurive të sekuestruara nën administrim
 - 2) Vlera e pasurive të konfiskuara nën administrim
 - 3) Vlera e realizuar nga shitja e pasurive të konfiskuara
 - 4) Numri i pasurive të kthyera pronarit
 - 5) Numri i pasurive të shkatërruara
 - 6) Vlera monetare e transferuar në buxhetin e shtetit pas shitjes

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte statistikat janë raportuar dhe përditësuar. Të dhënat mbi asetet e konfiskuara janë bërë publike e botuar në gjysmën e parë të vitit 2019, përfshirë edhe ato të vitit 2018, që nuk ishin raportuar. Ky tregues performance është i realizuar.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

A. 10.1	Mbledhja, përpunimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore mbi korrupsionin
A. 10.1.1	Informacion statistikor i prodhuar mbi korrupsionin (raport 6- mujor/vjetor) *Raporti vjetor 2023 hartohet dhe përfundon brenda TM I 2024
A.10.2	Mbledhja dhe harmonizimi i të dhënave statistikore për asetet e konfiskuara dhe sekuestruara me vendim gjykatë për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe përcjellja pranë Komisionit Evropian
A. 10.2.1	Informacion statistikor i prodhuar lidhur në veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, sipas parashikimeve në Kodin Penal *Raporti vjetor 2023 hartohet dhe përfundon brenda TM I 2024

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit deri në dhjetor 2023.

Gjatë vitit 2020, janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmuajin e dytë dhe vjetore 2019. Janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për tremujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2020.

Janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmuajin e parë (Janar-Qershor) të vitit 2020.

Gjithashtu, janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin për gjashtëmuajin e dytë dhe vjetore 2019. Këto të dhëna janë botuar dhe publikuar në “Vjetarin Statistikor 2019”, të publikuar në <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2020/07/VJETARI-STATISTIKOR-2019.pdf>.

Janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin për gjashtëmuajin e parë (Janar-Qershor 2020).

Janë dënuar 262 persona nga Gjykatat e Shkallës së Parë (me vendim të formës së prerë) dhe 246 persona nga Gjykatat e Apelit për veprat penale në lidhje me korrupsionin (për vitin 2019). Janë dënuar 119 persona nga Gjykatat e Shkallës së Parë (me vendim të formës së prerë) dhe 40 persona nga Gjykatat e Apelit për veprat penale në lidhje me korrupsionin (për periudhën janar-qershor 2020).

Janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmuajin e parë (Janar-Qershor) të vitit 2020.

Gjithashtu, janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për gjashtëmuajin e dytë dhe vjetore 2019. Këto të dhëna janë botuar dhe publikuar në “Vjetarin Statistikor 2019”.

Janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për gjashtëmuajin e parë (Janar-Qershor 2020).

Janë dënuar 530 persona nga Gjykatat e Shkallës së Parë (me vendim të formës së prerë) dhe 599 persona nga Gjykatat e Apelit për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar (për vitin 2019). Janë dënuar 202 persona nga Gjykatat e Shkallës së Parë (me vendim të formës së prerë) dhe 165 persona nga Gjykatat e Apelit për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar (për periudhën janar-qershor 2020).

Në periudhën janar-qershor 2020, janë mbledhur të dhënat statistikore për asetet e konfiskuara për 6M2 dhe vjetore 2019. Këto të dhëna janë përfshirë dhe publikuar në “Vjetarin Statistikor 2019”, botim i MD. Janë dënuar 262 persona nga Gjykatat e Shkallës së Parë (me vendim të formës së prerë) dhe 246 persona nga Gjykatat e Apelit për veprat penale në lidhje me korrupsionin.

Realizimi i masave të këtij treguesi për vitin 2020, është i plotë, me 4 raporte statistikore (6 mujori II 2019/Vjetore 2019/3 M I 2020/6 M I 2020). Vjetore 2019 publikuar ne Vjetarin Statistikor, <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2020/07/VJETARI-STATISTIKOR-2019.pdf>.

Kostoja e realizimit të kësaj masë është e mbuluar nga buxheti i shtetit.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
--	------------------------------------	-----------------

E dhëna fillestare bazë	Statistikat e prodhuara nuk përmbajnë të dhëna të plota në përputhje me Udhëzimet e Financial Action Task Force (FATF)	
Vlera e synuar 2018	Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit	Vlera e synuar është arritur.
Vlera e synuar 2019	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë në to: A. Numrin e hetimeve të nisura B. Numrin e kallëzimeve/aktakuzave të kërkuara nga Prokuroria 1. Numrin e kërkesave për sekuestrim C. Numri i dënimeve 1. Numri i kërkesave të miratuara për sekuestrim 2. Numri i kërkesave të miratuara për konfiskim D. Të dhënat për administrimin e pasurive: 1. Vlera e pasurive të sekuestruara nën administrim	Vlera e synuar është arritur
Vlera e synuar 2020	Raportimi i statistikave duke përfshirë në to: A. Numrin e hetimeve të nisura B. Numrin e kallëzimeve/aktakuzave të kërkuara nga Prokuroria 1. Numrin e kërkesave për sekuestrim C. Numri i dënimeve 1. Numri i kërkesave të miratuara për sekuestrim 2. Numri i kërkesave të miratuara për konfiskim D. Të dhënat për administrimin e pasurive: 1. Vlera e pasurive të sekuestruara nën administrim 2. Vlera e pasurive të konfiskuara nën administrim 3. Vlera e realizuar nga shitja e pasurive të konfiskuara 4. Numri i pasurive të kthyera pronarit 5. Numri i pasurive të shkatërruara 6. Vlera monetare e transferuar në buxhetin e shtetit pas shitjes	Vlera e synuar është arritur

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.10.

Niveli i realizimit të Objektivit A.10 *Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2020 është 100%.*

Shkalla e realizimit të objektivit A.10 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesin e performancës janë të verifikueshme përmes faqes së internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2020/07/VJETARI-STATISTIKOR-2019.pdf>.

Risqet për realizimin e Objektivit A.10

Nuk paraqitet asnjë risk evident për realizueshmërinë e këtij objekti.

A.11 Adaptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore

Për këtë objektiv jnaë përcaktuar 2 tregues performance:

A.11.a: Raporti i bashkive që kanë hartuar plane vendore antikorrupsion dhe plane integriteti (në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit)

A.11.b: Numri i Bashkive që alokojnë një zë të veçantë të buxhetit për zbatimin e politikës vendore antikorrupsion

Plani i veprimit për Objektivin A.11 parashikon 3 Aktivitete dhe 3 Masa.

A.11.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.11** për vitin 2020 është: **6 bashki** miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut.

Për vitin 2021 vlera e synuar është 10 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut. Për vitin 2022 vlera e synuar është 40 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut. Për vitin 2023 vlera e synuar është 61 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte një metodologji vlerësimi risku dhe një Kod Sjelljeje ëshë përgatitur dhe konsultuar me 4 bashki (Tiranë, Shkodër, Fier, Gjirokastër). 4 bashki kanë miratuar Plane Integriteti (Elbasan, Mat, Mallakastër dhe Patos).

2 bashki kanë draftuar plane integriteti dhe në pritje për tu miratuar nga Këshillat Bashkiakë. Ky tregues performance u realizua vetëm 10% për atë vit.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

A. 11.1	Takime informuese për hartimin e Planeve Vendore të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në të gjitha bashkitë e vendit (në vijim të 6 bashkive pilot)
A. 11.1.1	Takime informuese të realizuara me titullarë të bashkive/me stafet e bashkive dhe finalizim i modelit të dokumentit
A.11.2	Përgatitja e Planeve Vendore të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes dhe dërgimi i tyre për miratim pranë këshillave bashkiake
A. 11.2.1	Takime teknike konsultative të realizuara (faza I) 10 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2020 (faza II) 10 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2021 (faza III) 40 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2022 (faza IV) të gjitha (61) bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2023

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit deri në dhjetor 2023.

Në muajin shkurt 2020, është zhvilluar një takim Informues: Zhvillimi i Planeve të Integritetit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, mbi procesin dhe rezultatet e zhvillimit të Planeve të Integritetit për Njësitë e Qeverisjes Vendore, me pjesëmarrje të kryetarëve dhe përfaqësues të bashkive të vendit (61 bashkitë).

Bashkitë Elbasan, Patos, Durrës, Mallkastër, Mat dhe Gjirokastrë, janë 6 bashkitë pilot që kanë të miratuar PI. Nga procesi i pilotimit të metodologjisë së riskut të integritetit në 6 bashkitë të vendit, Bashkia Gjirokastrë miratoi në muajin Janar 2020, me vendim të Këshillit Bashkiak dokumentin e Planit të Integritetit, si dhe Kodin e Sjelljes për këtë bashki. Bashkitë Elbasan, Mallakastër, Patos dhe Mat kanë publikuar në faqet zyrtare Planin e Integritetit dhe Kodin e Sjelljes. Bashkia Elbasan me urdhër të kryetarit të Bashkisë në muajin shkurt 2020 ka caktuar Koordinatorin e Integritetit për bashkinë, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij plani. Në muajin shkurt 2020, u zhvillua në bashkinë Elbasan, një takim publik informues mbi prezantimin e planit përkatës të integritetit.

Mbështetja financiare e realizimit të këtyre masave është nga partnerë/donatorë të huaj, përkatësisht nga PNUD nëpërmjet projektit STAR.

Realizimi i masave të këtij treguesi për periudhën raportuese është i pjesshëm, përkatësisht një masë e zbatuar plotësisht dhe një pjesërisht.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këto masa (si më lart), me zhvillimin e takimeve me titullarë dhe stafe të bashkive dhe me miratimin e një Plani Integritetit në vetëm një bashki, të Gjirokastrës, ky tregues është arritur në vlerën 16.6%.

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura.

Siç shihet nga tabela realizueshmëria ka qënë e dobët në të tre vitet. Kjo ka ardhur dhe për pasojë të mosrealizimit të treguesit A8 dhe A9 për hartimin e udhëzuesit për kryerjen e vlerësimit të rrezikut dhe hartimit të planeve të integritetit, realizimi i këtij treguesi është vonuar gjithashtu.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Institucionet e qeverisjes vendore nuk kanë kryer vlerësim sistematik të rrezikut të integritetit/korrupsionit dhe nuk kanë plane të integritetit	
Vlera e synuar 2018	Ministria e Brendshme iu përcjell të gjitha Bashkive udhëzuesin për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit dhe hartimit të planeve të integritetit.	Vlera e synuar nuk është arritur.
Vlera e synuar 2019	Ministria e Brendshme kryen veprimtari informuese aktive me të gjitha Bashkitë udhëzuesin për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit dhe hartimin e planeve të integritetit. 5 Bashki hartojnë dhe miratojnë Plane të Integritetit	4 Bashki hartuan dhe miratuan Plane të Integritetit me metodologji alternative.
Vlera e synuar 2020	6 Bashki hartojnë dhe miratojnë Plane të Integritetit.	1 Bashki ka hartuar dhe miratuar Plan të Integritetit.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

A.11.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.11.b** për vitin 2020 është: **6 bashki** alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit.

Për vitin 2021 vlera e synuar është 10 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit. Për vitin 2022 vlera e synuar është 40 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit. Për vitin 2023 vlera e synuar është 61 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit.

Për vitin 2019 nuk kishte një vlerë të synuar për tu arritur.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

A. 11.3	Inkurajimi i bashkive të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e politikave vendore AK, në përputhje me strategjinë antikorrupsion; Inkurajimi i bashkive të tjera për vitet në vijim
A. 11.3.1	Fushata informimi për përcaktimin e një buxheti specifik për implementimin e masave specifike të planeve të integritetit/total 6 bashki për vitin 2020/total 10 bashki për vitin 2021/total 40 bashki për vitin 2022/total 61 bashki për vitin 2023

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që kryesisht fillojnë specifikisht nga tremujori i tretë i vitit 2020 e në vijim.

Në vitin 2020, nuk është kryer dhe inicuar asnjë fushatë informimi për përcaktimin e një buxheti specifik për implementimin e masave specifike të planeve të integritetit, sipas parashikimeve që jep plani i veprimt.

Për këtë periudhë raportimi nuk është arritur vlera e synuar të këtij treguesi me një masë dhe aktivitet të pazbatuar dhe 0% vlerë e synuar e arritur.

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura.

Për shkak se realizimi i këtij treguesi lidhet me hapa të mëparshëm, siç janë së pari hartimi i udhëzuesit për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit dhe hartimin e planeve të integritetit dhe më pas kryerja e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit dhe hartimi i planeve të integritetit, është prashikuar alokimi për herë të parë i fondeve për zbatimin e planit të integritetit vetëm në vitin 2020.

Nuk ka të dhëna nëse këto fonde janë alokuar gjatë vitit 2020.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Institucionet e qeverisjes vendore nuk alokojnë fonde për zbatimin e planit të integritetit	
Vlera e synuar 2018	-	-
Vlera e synuar 2019	-	-
Vlera e synuar 2020	6 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit	Nuk ka të dhëna

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit A.11.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.11. Adaptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020 është **8%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\frac{86-110}{110} = 8\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.11 për këtë periudhë raportimi është **dobët** (86-110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesin e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në Ministrinë e Brendshme. (<https://mb.gov.al/ep-content/uploads/2020/06/RAPORT-VJETOR-2019-AMVV-1.pdf>)

Risqet për realizimin e Objektivit A.11

Risku i realizimit të këtij objektivit është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me komunikimin dhe informimin si dhe me çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit (Qasja A)

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 11 objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit është 74.66%.

Objektivi	Realizueshmëria
A.1. Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	95%
A.2. Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	100%
A.3. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	141%
A.4. Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	0%
A.5. Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	53%
A.6. Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	99.6%

A.7. Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	_25
A.8. Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	50%
A.9. Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	100%
A.10. Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	100%
A.11. Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	8%

Qasja Ndëshkuese - Përmbledhje për arritjet në ndëshkimin e korrupsionit

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) ndëshkuese SNKK** ka për qëllim që institucionet ligjzbatuese dhe veçanërisht ato të pavarura, të cilat kanë një rol thelbësor në këtë proces, duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore.


Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2020	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ²⁶	Masa dhe aktivitete të parealizuara ²⁷
Ndëshkuese	Masa	25	10	6	9
	Aktivitete	37	16	7	14

²⁵ Nuk mund të matet pasi indikatorit A.7. a nuk ka vlera që raportohen për këtë raport monitorimi. Ky tregues për vitin 2020 do të raportohet në maj 2021.

²⁶ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

²⁷ Aktivitet "i përealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind



Rezultoni se nga 25 masa e 37 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për vitin 2020, për Qasjen B (Ndëshkuese), janë zbatuar 10 masa/16 aktivitete prej tyre, 6 masa/7 aktivitete janë ende në proces zbatimi dhe 9 masa/14 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa B.15; B.1.6; B.1.8; B.1.10; B.1.11; B.2.4; B.2.7; B.2.8; B.4.3 dhe aktivitete B.1.5.1; B.1.6.1; B.1.6.2; B.1.8.1; B.1.10.1; B.2.3.3; B.2.3.4; B.2.4.1; B.2.4.2; B.2.7.1; B.2.8.1; B.2.8.2; B.4.1.2.; B.4.3.1)


Nga 9 treguesit e performancës të caktuar për qasjen ndëshkuese, përmes realizimit të masave dhe kryerjes së aktiviteteve respektive është arritur vlera e synuar për 1 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 1 tregues performance si edhe nuk është arritur vlera e synuar për 7 tregues performance.

Qasja Ndëshkuese	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ²⁸	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ²⁹	Vlera e synuar nuk është e realizuar ³⁰
	9	1	1	7

²⁸ Që është realizuar në shkallën 100 për qind

²⁹ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

³⁰ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna



B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit.

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

B.1.a: Numri i kallëzimeve për korrupsion (rastet dhe personat)

B.1.b: Numri i kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit

B.1.c: Vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi të sekuestruara në rastet e korrupsionit

Plani i veprimit për Objektivin B.1 parashikon 20 Aktivitete dhe 13 Masa.

B. 1.1	Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit, këtyre të fundit dhe gjyqësorit
B.1.1.1	Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim (I) Hartimi i programit të trajnimit (II) PP, Prokurori e Posaçme, Komisioni i Policisë Gjyqësore
B.1.1.2	Kryerja e trajnimit/Nr. i personave të trajnuar; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
B. 1.2	Monitorimi dhe raportimi i të dhënave statistikore lidhur me sekuestrimet
B.1.2.1	Formati i raportimit statistikor dhe procesi i mbledhjes së të dhënave i krijuar
B.1.2.2	Raportimi periodik i kryer
B. 1.3	Forcimi i kapaciteteve në logjistikë dhe burime njerëzore i strukturave të hetimit të korrupsionit dhe krimin ekonomik
B.1.3.1	Numri i stafit të rekrutuar, pajisur me mjetet/kushtet e nevojshme të punës dhe trajnuar

B. 1.4	Rritja e përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit në procedimet për vepra penale në fushën e korrupsionit për rezultate më efektive në luftën kundër tij
B.1.4.1	Nr. i rasteve të aplikimit të neneve 221, 294/a, 294/b të K.Pr.P.
B. 1.5	Krijimi i formatit të raportimit statistikor dhe mbledhjes së të dhënave
B.1.5.1	Ngritja e grupit të punës (I) Hartimi i draftit të formatit dhe miratimi i formatit të raportimit statistikor
B. 1.6	Kryerja e trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit
B.1.6.2	Kryerja e trajnimit/grupet e trajnimit (25 persona/grup) - total nr. i personave të trajnuar, 126 persona/vit (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
B. 1.7	Kryerja e trajnimeve për rritjen e nivelit profesional të efektivëve të angazhuar për të dokumentuar veprat penale në fushën kundër korrupsionit dhe krimeve në detyrë (PSH/OPGJ në strukturën kundër korrupsionit)
B.1.7.1	Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim dhe hartimi i programit trajnimit
B.1.7.2	Kryerja e trajnimit; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
B. 1.8	Forcimi i kapaciteteve strukturave të hetimit të korrupsionit dhe krimit ekonomik
B.1.8.1	Investime në mjete pune: pasje vëzhgimi, fotografimi, filmimi, interveprimi ambientale) për ngritjen e Njësisë Qendrore për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Financiare dhe Korrupsionit (20 OPGJ dhe 5 oficer në Sektorin për Hetimin e Aseteve Kriminale).
B. 1.9	Mekanizma specifike për të zhvilluar luftën kundër korrupsionit në kuadër të administrimit dhe menaxhimit e asetëve të sekuestruara dhe konfiskuara që rrjedhin nga korrupsioni
B.1.9.1.	Ngritja e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore
B.1.9.2	Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.34/2019 (janar-dhjetor 2020)
B.1.9.3	Krijimi i regjistrit elektronik, për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara si dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë të kenë akses në të Portali i AAPSK/e-shërbime
B. 1.10	Rritja e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare
B.1.10.1	Module trajnimi të hartuara (I) Seanca trajnimi të kryera (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
B. 1.11	Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të AAPSK në fushën e administrimit të shoqërive të sekuestruara dhe të konfiskuara
B.1.11.1	Trajnime të kryera për stafin (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
B. 1.12	Rritja e kapacitetit hetimor nëpërmjet forcimit të strukturës së hetimit dhe shfrytëzimit të instrumentave ligjorë që shërbëjnë për përmbushjen e veprimtarisë si në aspektin procedural penal dhe të veprimtarisë inteligjente
B.1.12.1	Nr. i rasteve zbuluara të dyshuara për kryerje apo implikim në veprimtari të kundërligjshme të punonjësve të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA (I) Nr. referimesh (II) Nr. punonjësish të proceduar (III) Nr. punonjësish të arrestuar/ndaluar si dhe nr. operacionesh të kryera (IV)
B. 1.13	Rritja e numrit dhe cilësisë së hetimeve proaktive, për punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA

B.1.13.1	Numri i hetimeve proaktive të finalizuara me dokumentimin ligjor dhe goditjen e rasteve të veprimtarisë së kundraligjshme të kryer nga punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA
----------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit, për këtë objektiv nuk janë qartësisht të ndara sipas tre treguesve të objektivit. Për këtë arsye zbatimi i aktiviteteve dhe realizimi masave është analizuar në mënyrë të agreguar për të tre treguesit, ndërsa vlerësimi për secilin tregues është kryer sipas vlerës së synuar për vitin 2020.

B.1.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.a** për vitin 2020 është: **rritja me 5% e numrit total të kallëzimeve për korrupsion krahasuar me vitin paraardhës.**

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po **rritja me 5% e numrit total të kallëzimeve për korrupsion, krahasuar me vitin paraardhës.**

Edhe për vitin 2019 vlera e synuar ishte **rritja me 5% e numrit total të kallëzimeve për korrupsion krahasuar me vitin paraardhës.** E përkthyer në shifra, duke u nisur nga vlera bazë e vitit 2017 (kur ishin dërguara në gjykatë 813 raste dhe akuzuar 974 individë) për vitin 2019 vlera e synuar ishte dërgimi në gjykatë i 813 rasteve dhe ngritja e akuzës për 1126 individë.

Gjatë vitit 2019 u dërguan në gjykata 643 raste për korrupsion dhe u ngrit akuzë për 841 individë. Krahasuar me vitin 2018 kur u dërguan në gjykata 513 raste për korrupsion dhe u ngrit akuzë për 719 persona, rritja me 5% është realizuar dhe tekaluar (rritje 25% për rastet dhe 17% për personat). Megjithatë e matur përkundrejt vlerës kumulative (mbështetur në vlerën bazë të vitit 2017), vlera e synuar e treguesit nuk është arritur.

Ky tregues ka dhe nëntreguesin **rritje e raportit të kallëzimeve për “korrupsion të nivelit të lartë” mbi numrin total të kallëzimeve për korrupsion.** Vlera e synuar për këtë nëntregues për vitin 2020 është 1% e rasteve 2% e të akuzuarve për korrupsion janë raste dhe individë të “nivelit të lartë”. Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është **rritja me 5% krahasuar me vitin paraardhës.**


Për vitin 2019 vlera e synuar ishte 0,8% e rasteve dhe 1,5% e të akuzuarve. Kjo vlerë nuk është arritur për vitin 2019 pasi ka patur vetëm 1 rast për “korrupsion të nivelit të lartë” të dënuar për gjykim.

Kostoja për realizimin e kësaj masë është e mbuluar nga buxheti i shtetit.

Për këtë periudhë raportimi numri i rasteve të kallëzimeve për korrupsion ishte 360 dhe numri i personave të përfshirë në kallëzime 533. Rritja me 5% e numrit të kallëzimeve për korrupsion, krahasuar me vitin paraardhës nuk është arritur, kështu që vlera e treguesit nuk është realizuar.


Për nëntreguesin “**B.1.a.1: Raporti i procedimeve për “korrupsion të nivelit të lartë” mbi numrin total të kallëzimeve për korrupsion**” nuk ka të dhëna për vitin 2020.

Realizueshmëria e këtij treguesi në 3 vitet e matura paraqitet në grafikun më poshtë.




Siç shihet nga grafiku, shkalla e realizueshmërisë së këtij treguesi ka qenë më e ulët se vlerat e parashikuara. Edhe në vitin 2020 gjatë të cilit ka filluar funksionimin SPAK, vlera e synuar rritje me 5%.


Edhe vlera kumulative në 3 vite është 34.9% më e ulët se vlera kumulative e synuar për rastet e dërguara për gjykim dhe 28% më e ulët për individët e akuzuar, siç e tregon grafiku më poshtë.




Akoma më të ulëta janë vlerat e arritura për nën-treguesin B.1.a.1: *Raporti i procedimeve për "korrupsion të nivelit të lartë" mbi numrin total të kallëzimeve për korrupsion*, si për realizueshmërinë e treguesit në vite ashtu edhe për vlerën kumulative, siç tregohet në 2 grafikët më poshtë.



Vlera kumulative në 3 vite është 85.3% më e ulët për rastet e dërguara për gjykim për nivelet e larta të korrupsionit dhe 67.4% më e ulët për individët e akuzuar, siç e tregon grafiku më poshtë.



Në fillim të vitit 2020 filloi veprimtarinë edhe Prokuroria e Posaçme SPAK. Në vitin e parë të aktivitetit të tij, numri i rasteve të procedimeve penale për veprën e korrupsionit është 40.4% e numrit total të rasteve të proceduara dhe 29% të totalit të numrit të personave të hetuar, siç tregon grafiku më poshtë.



Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

B.1.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.b** për vitin 2020 është: **rritja me 5% e numrit të kërkesave për sekuestrim për vepra penale të lidhura me korrupsionin, krahasuar me vitin paraardhës.**

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po rritja me 5% e numrit të kërkesave për sekuestrim për vepra penale të lidhura me korrupsionin, krahasuar me vitin paraardhës.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte publikimi i të dhënave mbi rastet e kërkesave për sekuestrim për vepra penale të lidhura me korrupsionin pas krijimit të mekanizmit për prodhimin në mënyrë të ndarë të këtyre të dhënave. Vlera e synuar e treguesit për vitin 2019 është arritur, dhe të dhënat janë publikuar në raportin vjetor të gjendjes së kriminalitetit për vitin 2019 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ky tregues ka dhe nëntreguesin rritje e raportit të kërkesave për sekuestrim në rastet e "korrupsionit në nivel të lartë" mbi numrin total të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit. Vlera e synuar për këtë nëntregues për vitin 2020 është 5% rritje krahasuar me bazën e vitit 2019. Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është rritja me 5% krahasuar me vitin paraardhës.

Për këtë periudhë raportimi nuk u paraqit asnjë kërkesë për sekuestrim të pasurive në rastet e korrupsionit, kështu që vlera e treguesit nuk është realizuar.

Realizueshmëria e këtij treguesi në 3 vitet e matura paraqitet në tabelën më poshtë.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Mungesë të dhëna për kërkesat për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit	

Vlera e synuar 2018	Ndërtimi i mekanizmit raportues (dhe përditësimi i statistikave të harmonizuara) me qëllim përfshirjen e të dhënave të reja	Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 6/2018 miratoi formatin statistikor për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në lidhje me konfiskimet.
Vlera e synuar 2019	Të dhëna të publikuara në raporte 2 vjeçare	Sistemi i raportimit u bë funksional dhe të dhënat raportuan në statistikat 6 mujore dhe vjetore. Asnjë kërkesë për sekuestrim të pasurive në rastet e korrupsionit nuk u paraqit në vitin 2019
Vlera e synuar 2020	5% rritje krahasuar me bazën e 2019	Asnjë kërkesë për sekuestrim të pasurive në rastet e korrupsionit nuk u paraqit në vitin 2020

Siç tregojnë të dhënat e tabelës më sipër, realizimi i këtij treguesi lidhet me procese dhe rezultate të pritshme në rritje në lidhje me sekuestrim të pasurive për raste të korrupsionit. Ndërsa realizueshmëria për proceset ka qenë e plotë, realizueshëria në lidhje me sekuestrim të pasurive për raste të korrupsionit ka qenë në nivelin zero.

Për pasojë, edhe vlerat e nëntreguesit *B.1.b.1: Raporti i kërkesave për sekuestrim në rastet e "korrupsionit në nivel të lartë" mbi numrin total të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit*, nuk janë arritur.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës*.

B.1.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.b** për vitin 2020 është: **rritja me 5% e vlerës së aseteve të sekuestruara (për të cilat krimi fillestar është korrupsioni), krahasuar me me bazën e vitit 2019.**

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po rritja me 5% e vlerës së aseteve të sekuestruara për rastet e korrupsionit, krahasuar me vitin paraardhës.

Gjithashtu vlera të synuara parashikohen: ngritja e grupit të punës për hartimin e akteve nënëligjore në zbatim të ligjit gjatë vitit 2020; krijimi i rregjistrimit elektronik për mbajtjen dhe raportimin e pasurive të sekuestruara gjatë vitit 2021; menaxhimi i pasurive të sekuestruara përmes sistemit elektronik gjatë vitit 2022; dhe kryerja e vlerësimit të nevojave për përmirësimin e sistemit gjatë vitit 2023.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte publikimi i të dhënave mbi vlerën e aseteve të sekuestruara për rastet e korrupsionit.

Aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit për këta tregues janë planifikuar të fillojnë të zbatohen kryesisht që nga fillimi i vitit 2020 dhe përgjatë vitit gjithashtu, sic përmendim masat B.1.3 dhe B.1.4, përkatësisht në në tremujorin 4 të vitit 2020.

Nga 13 masat e parashikuara në planin e veprimit, janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe 5 masat e tjera janë të pazbatuara ose raportimi për to nuk është kryer nga institucionet përgjegjëse.

Gjatë vitit 2020, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit dhe gjyqësorit, është bërë identifikimi i nevojave për trajnime për prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore (korrik 2020) dhe identifikuan për pjesëmarrje 293 prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë dhe policisë së shtetit dhe përfaqësues nga institucionet ligjzbatuese KLSH, ILDKPKI, DPT, DPD, DPPPP, SHÇBA. Në dhjetor 2020, me asistencë të partnerëve PAMECA, u zhvillua trajnimi online me temë “Pastrimi i parave dhe hetimi pasuror dhe financiar” me pjesëmarrës rreth 69 përfaqësues nga të gjithë institucionet ligjzbatuese dhe në datat 17-18 dhjetor u trajniti me temë “Mbi veprat penale që lidhen me detyrën” me pjesëmarrjen e rreth 76 përfaqësuesve, u trajnuan 145 persona, 38 femra dhe 107 meshkuj.

Në zbatim të masës për monitorimin dhe raportimin e të dhënave statistikore lidhur me sekuestrimet është hartuar dhe miratuar udhëzimi për miratimin e formatit raportimit statistikor (formati statistikor) dhe ka filluar nga zbatimi. Janë krijuar seksionet e posaçme për hetimin e pastrimit të parave dhe krimit ekonomik në 7 prokurori të juridiksionit të përgjithshëm me përbërje drejtues seksioni dhe prokurorë dhe në 15 prokuroritë e tjera u caktua një prokuror për ndjekjen e këtyre çështjeve. Janë gjithsej, 41 prokurorë të ngarkuar me ndjekjen penale të pastrimit të parave dhe krimit ekonomik.

Ndërkohë gjatë vitit 2020, nuk ka ndryshuar formati i raportimit statistikor nga Policia e Shtetit.

Në zbatim të masës kryerja e trajnimeve për rritjen e nivelit profesional të efektivëve të angazhuar për të dokumentuar veprat penale në fushën kundër korrupsionit dhe krimeve në detyrë, janë kryer 6 trajnime me 44 përfitues nga të cilët 14 janë femra.

Ndërkohë që mbeten në statusin pazbatuar masa për forcimin e kapaciteteve të strukturave të hetimit të korrupsionit dhe krimit ekonomik me kryerje të investimeve në mjete pune si: pasje vëzhgimi, fotografimi, filmimi, interveprimi ambientale) për ngritjen e Njësisë Qendrore për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Financiare dhe Korrupsionit.

Në zbatim të masës për krijimin e mekanizmave specifike për të zhvilluar luftën kundër korrupsionit në kuadër të administrimit dhe menaxhimit e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara që rrjedhin nga korrupsioni, është ngritur grupi i punës për hartimin e akteve nënligjore me përfaqësues të AAPSK dhe janë hartuar 8 akte nënligjore në zbatim të ligjit nr. 34/2019 nga të cilët vetëm 6 janë tashmë të miratuar dhe vetëm dy janë ende në statusin draft.

Kështu, janë miratuar:

1. VKM “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.
2. VKM “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.
3. VKM “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara” .
4. Udhëzimi “Për procedurat e mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave, rregullat e për mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të shpenzimeve, limitet e kryerjes së shpenzimeve”.
5. Urdhër “Për kriteret dhe rregullat e hartimit të listës së administratorëve të pasurisë, pranë AAPSK”.

6. Urdhër “Për miratimin e strukturës dhe përbërjes organike të strukturës së agjencisë së pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”.

Janë në proces:

1. Projekt VKM “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”.
2. Projekt VKM “Për kufijtë e pagave apo shpërblimit të personelit të jashtëm të AAPSK”.

Ndërkohë që sistemi/regjistri elektronik, për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara si dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë të kenë akses në të (Portali i AAPSK/e-shërbime) është implementuar dhe në pritje të ndryshimeve për krijimin/dhënien e aksesit të përdorimit të tij nga institucione përdoruese.

Në zbatim të masës për rritjen e kapacitetit hetimor të institucioneve ligjzbatuese, SHÇBA, për vitin 2020 ka dërguar pranë organit të prokurorisë:

- 214 referime penale për 317 persona, nga të cilët: 1 punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues; 98 punonjës policie i nivelit të parë drejtues; 208 punonjës policie të nivelit zbatues; 1 punonjës civil (administrativ); 5 efektive të Gardës; 4 PMNZSH dhe 99 shtetas.

Në zbatim të masës për rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve proaktive, për punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA, gjatë vitit 2020, janë kryer hetime proaktive nga strukturat e hetimit të Shërbimit, nën drejtimin e prokurorit për procedimet penale në ndjekje.

- Si rezultat i veprimtarisë nën këtë masë janë zbatuar vendime të gjykatave janë zbatuar vendime të gjykatave për masat “*Arrest në flagrancë/ndalime/masa të tjera*”, ndaj 74 punonjës dhe 41 shtetas, nga të cilët; Arrestuar/ ndaluar 84 persona, nga të cilët: 1 punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues; 17 punonjës policie të nivelit të parë drejtues; 23 punonjës policie të nivelit zbatues; 1 efektivi i PMNZSH-së; 2 efektive të Gardës dhe 40 shtetas.
- masa të tjera të sigurimit personal, si; “*pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik*” janë 31 persona, nga të cilët: 13 punonjës policie të nivelit të parë drejtues; 16 punonjës policie të nivelit zbatues; 1 punonjës administrative; 1 shtetas masë “*detyrim paraqitje tek OPGJ*”.

Nga strukturat e hetimit të ShÇBA janë kryer rreth 19 operacione për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format dhe fenomenet më shqetësuese, siç janë “*korrupsioni pasiv*”, “*shpërdorimi idetyrës*”, *favorizimi i “kultivimit të bimëve narkotike” e “kontrabandës”, dhe tendencave të tjera.*

Këto operacione janë realizuar në bashkëpunim me SPAK, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë dhe strukturave të Policisë së Shtetit, duke u finalizuar me dokumentimin me prova ligjore të veprimtarisë së kundërligjshme të punonjësve të policisë dhe shtetasve të implikuar, si dhe ekzekutimit të masave të sigurimit personal shtrëngues dhe ndalues të dhëna nga Gjykata e Posacme dhe ato të Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë.

Për realizimin e kësaj mase është shpenzuar në masën 50% buxheti i parashikuar.

Për këtë periudhë raportimi nuk ka patur asete të sekuestruara për krime të lidhura me është korrupsionin. Për pasojë treguesi është realizuar në masën 0%.

Realizueshmëria e këtij treguesi në 3 vitet e matura paraqitet në tabelën më poshtë.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Mungesë të dhëna për vlerën asestevë të sekuestruara në rastet e korrupsionit	
Vlera e synuar 2018	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të AAPSK për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e vlerave të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të brendshëm të AAPSK nuk u realizua.
Vlera e synuar 2019	Të dhëna të publikuara në raporte gjashtë mujore të AAPSK (<i>të dhënat përmbajnë vlera mbi të ardhurave të sekuestruara në rastet e korrupsionit</i>)	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit u realizua. Të dhënat u publikuan në raporte gjashtë mujore të AAPSK. Të dhënat nuk përmbajnë vlera mbi të ardhurave të sekuestruara në rastet e korrupsionit
Vlera e synuar 2020	5% rritje krahasuar me bazën e 2019	Gjatë vitit 2020 nuk ka patur asete të sekuestruara për krime të lidhura me korrupsionin

Siç tregojnë të dhënat e tabelës më sipër, edhe realizimi i këtij treguesi lidhet me procese dhe rezultate të pritshme në rritje në lidhje me sekuestrim të pasurive për raste të korrupsionit. Ndërsa realizueshmëria për proceset ka qënë e plotë, realizueshëria në lidhje më rritjen e vlerës totale të pasurive të sekuestruara në rastet e korrupsionit ka qënë në nivelin zero.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit B.1

Niveli i realizimit të *Objektivit B.1. Përmirësimi i efijencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2020 është **0%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\frac{\text{Vlera e arritur}}{\text{Vlera e synuar}} \times 100 = 0\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit B.1 për këtë periudhë raportimi është **dobët** (0 deri në 30 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesin e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm (http://ëëë.pp.gov.al/ëëb/Raporte_18_1.php).

Të dhënat duhet të jenë të verifikueshme edhe në raportet e Prokuroria e Posaçme (SPAK) (<https://spak.al/>) dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK). Ndërsa SPAK akoma nuk ka prodhuar ndonjë raport vjetor, AAPSK nuk ka aktualisht një faqe zyrtare në internet.

Të dhënat janë të verifikueshme gjithashtu në Vjetarin Statistikor të publikuar nga Ministria e Drejtësisë (<https://ëëë.drejtësia.gov.al/statistika/>)

Risqet për realizimin e Objektivit B.1

Risku i realizimit të këtij objekti është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me komunikimin dhe informimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional në përgjithësi si dhe me çështje të tjera që lidhen me kapacitetet administrative dhe mjedisin rregullativ.

B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit.

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

B.2.a: Raporti i procedurave të regjistruara mbi korrupsionin nga referimet e administruara

B.2.b: Numri i aksesit në bazat e të dhënave shtesë për policinë dhe prokurorinë

Plani i veprimit për Objektivin B.2 parashikon 15 Aktivitete dhe 8 Masa.

B.2.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.2.a** për vitin 2020 është **rritja me 3% e raportit të numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara në krahasuar me vitin paraardhës**. Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po rritja me 3% e raportit të numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara, në krahasuar me vitin paraardhës.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte realizimi në masën 75% e raportit të numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara (ndërsa për vitin 2018 vlera e synuar ishte 70%, e vendosur përkundrejt shifrës 65.67% të vitit 2017 e cila është marrë si vlerë bazë. Në vitin 2019 u administruan 3538 referime, nga të cilat u rregjistruan 2257 procedime, c'ka përbën 63.7% referime të regjistruara nga totali i procedimeve të regjistruara. Ky raport për vitin 2018 ishte 62% (3440 referime të regjistruara dhe 2126 procedime të regjistruara).

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (14) dhe masat (7) si më poshtë.

B. 2.1	Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit/rishikimi i marrëveshjeve ekzistuese ndërmjet institucioneve ligjzbatuese dhe institucioneve të ngarkuara në luftën kundër korrupsionit
B.2.1.1	Numri i marrëveshjeve të nënshkuara/ rishikuara (masë e raportueshme në TM IV të çdo viti)
B. 2.2	Rritja e aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronik shtetëror për kryerjen e hetimeve, nëpërmjet ndërlidhjes së sistemeve
B. 2.2.1	Numri i databazave të aksesuara
B. 2.3	Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional të punës ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese (dogana, tatime, policia ushtarake, etj) me fokus hetimin e korrupsionit
B.2.3.1	Ngritja e grupeve të përbashkëta të punës
B.2.3.2	Hartimi i plani punës/plani veprimi me fokus hetimin e korrupsionit
B.2.3.3	Udhëzime dhe procedura standarde të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese
B.2.3.4	Adresimi i mbivendosjeve dhe / ose boshllëqeve në mandatet institucionale, hetimet e dyfishta ose të njëkohshëm, etj
B. 2.4	Hartimi i procedurave standarde dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet PSH dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK me fokus hetimin e korrupsionit
B.2.4.1	Ngritja e grupit të punës
B.2.4.2	Hartimi i draftit të procedurave të bashkëpunimit dhe miratimi i tyre
B. 2.5	Forcimi bashkëpunimi ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese me fokus hetimin e korrupsionit, nëpërmjet takimeve të punës
B.2.5.1	Hartimi i një kalendari takimesh pune dhe takime të kryera
B. 2.6	Organizimi i seminareve/ëorkshope të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese
B.2.6.1	Analiza shkencore (I) Informacioni dhe përpunimi i të dhënave (II) Tematika specifike të trajtuara (III) Kurrikula/materialet e trajnimit të hartuara
B. 2.7	Kryerja e vlerësimit për të identifikuar faktorët që pengojnë dhe/ose nxisin bashkëpunimin institucional në hetimin e korrupsionit dhe në vlerësimin e burimeve njerëzore e financiare
B.2.7.1	Ngritja e grupit të punës (I) Hartimi i termave të referencës (II) Kryerja e vlerësimit (III) Aktivitetet (konferencë për bërjen të njohur të raportit
B. 2.8	Rishikimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese dhe institucioneve të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit
B.2.8.1	Ngritja e grupit të punës

B.2.8.2	Draftimi i marrëveshjes
B.2.8.3	Miratimi / nënshkrimi i marrëveshjeve

Realizimi i masave është parashikuar të arrihet përmes aktiviteteve që kryhen duke filluar që duke filluar që nga 6 maji 1 si dhe masa që fillojnë zbatimin në 6 majin 2. Masa B.2.1 është parashikuar zbatimi në vitin 2021.


Në lidhje me këtë tregues, për vitin 2020 është raportuar nga institucionet përgjegjëse realizimi i masës forcimi i bashkëpunimi ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese me fokus hetimin e korrupsionit, nëpërmjet takimeve të punës është raportuar zbatimi i saj përmes realizimit të 253 takimeve dhe analizave të përbashkëta me Prokurorinë dhe agjenci të tjera ligjzbatuese. Në korrik 2020, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për rritjen e efikasitetit të luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit ekonomik e financiar, iniciativë e cila do të ndikojë edhe në përmirësimin e mbajtjes së të dhënave të unifikuara në nivel kombëtar për krimin e korrupsionit.

Gjithashtu janë organizuar seminareve/ëorkshope të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese, janë kryer 6 trajnime me 44 përfitues nga të cilët 14 janë femra, ku përmenden çështje trajnimie si mashtrimet në prokurimet publike dhe pastrimin e parave, trainimi i avancuar i hetimit financiar, marrdhëniet ndërmjet policisë dhe prokurorisë për përmirësimin e cilësisë së referimeve, hetimi financiar kombëtar dhe hetimet ndërkombëtare, investigimi hetimi i aseteve kriminale dhe pastrimit parave dhe Veprat penale e krimet në detyrë.

Për realizimin e masave të këtij treguesi nuk janë parashikuar kosto shtesë.

Për këtë periudhë raportimi raporti i numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara është 46%. Krahasuar me vitin parardhës, kur ky raport ishte 63%, kështu që vlera e treguesit e parashikuar të rritej me 3%, treguesi duhet të ishte 77.2%.

Realizueshmëria e këtij treguesi në 3 vitet e matura paraqitet ne grafikun më poshtë.



Në 3 vitet e matura, raporti i procedimeve penale të regjistruara për rastet e korrupsionit mbi referimet e administruara jo vetëm që nuk është ngushtuar por ka ardhur duke u thelluar. Hendeku ndërmjet vlerës së synuar dhe vlerës së arritur për vitin 2020 është 40.5%, dhe 30% më i madh se vlera fillestare bazë ndërsa parashikohej rritje me 5% rritje krahasuar me vitin 2019.

Ky raport mbetet kritik për efektivitetin e hetimeve penale mbi korrupsionin dhe duhen ndërmarrë hapa për ta adresuar.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

B.2.b

Vlera e synuar për treguesin e performancës B.2.b për vitin 2020 është: **realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 16 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 5 baza të dhënash shtesë.**

Për vitin 2021 vlera e synuar është **realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 18 databaza shshesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 7 baza të dhënash shtesë.** Për vitin 2022 vlera e synuar është **realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 20 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 9 baza të dhënash shtesë.** Për vitin 2023 vlera e synuar është **realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 22 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 11 baza të dhënash shtesë.**

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 2 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 3 baza të dhënash shtesë. Vlera e synuar për vitin 2019 u realizua nga Prokuroria e cila vendosi aksesin në 3 baza të dhënash shtesë por nuk u realizua nga Policia e Shtetit e cila realizoi akses vetëm në 1 bazë të dhënash shtesë.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktiviteti (1) dhe masa (1) si më poshtë.

B. 2.2	Rritja e aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronik shtetëror për kryerjen e hetimeve, nëpërmjet ndërlidhjes së sistemeve
B.2.2.1	Numri i databazave të aksesuara

Realizimi i masave është parashikuar të arrihet përmes aktiviteteve që kryhen duke filluar që nga 6 maji i parë i vitit 2020. (B.2.2).


Kjo masë është raportuar e zbatuar pjesërisht/ në proces përmes kryerjes së aktivitetit për nënshkrimin e marrëveshjes në muajin prill nga Prokuroria e Përgjithshme për realizimin e aksesit në bazën e të dhënave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Mbetet në proces negociimi të një marrëveshje për marrjen e aksesit në bazën e të dhënave “Menaxhimi i Informacionit të Sistemit Penitenciar”, të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Prokuroria e Përgjithshme raporton gjithashtu problematika që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe me kuadrin normativ të paqartë/pamjaftueshëm. Aksesit në regjistrin elektronik të recetave të rimbursueshme, Prokuroria dhe MD ka patur korrespondencë të vazhdueshme me FDKSSH dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, duke kërkuar edhe hartimin e një akti nënligjor për krijimin e aksesit prokurorisë në bazën e të dhënave të regjistrit të recetave elektronike. Ministria e Shëndetësisë në referencë të akteve ligjore në fuqi lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe VKM nr.503, datë 24.06.2020, “Për administrimin e informacionit elektronik shëndetësor”, ka ofruar dhënien e informacionit specifik sipas nevojave. Ndërkohë që vijojnë komunikimet me MD për aksesin në Regjistrin Noterial Shqiptar dhe sistemin e Shërbimit të Përmbartimit.

Kostot administrative të parashikuara janë raportuar të shpenzuara në masën 100%.

Për këtë periudhë raportimi Prokuroria ka shtuar aksesin në 1 bazë të dhënash. Treguesi nuk është realizuar.

Grafiku më poshtë tregon realizueshmërinë e këtij treguesi performance duke treguar numrin e bazave të të dhënave tek të cilat Policia e Shtetit dhe Prokuroria ishte parashikuar të arrihej dhe numrin e bazave të të dhënave të aksesuara nga dy institucionet.



Siç tregon grafiku ka një hendek prej 31.25% ndërmjet vlerës kumulative të synuar të numrit të bazave të të dhënave të aksesuara nga Policia e Shtetit dhe 28% është hendeku i numrit të bazave të të dhënave të aksesuara nga Prokuroria.

Kritik mbetet realizimi i aksesit të SPAK në bazat e të dhënave të aksesuara tashmë nga Prokuroria.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës*.

Niveli i realizimit të objektivit B.2

Niveli i realizimit të *Objektivit B.2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2020 **është 50%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\frac{31}{62} \times 100 = 50\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit B.2 për këtë periudhë raportimi **është mirë** (31 deri në 50 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesin e performancës nuk janë të verifikueshme në raporte të institucioneve respektive, por vetëm nga raportimi i bërë për këtë raport monitorimi nga institucionet përgjegjëse.

Risqet për realizimin e Objektivit B2

Risku i realizimit të këtij objekti është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me financimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional në përgjithësi si dhe me kapacitetet administrative dhe mjedisin rregullativ.

B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

B.3.a: Numri i raporteve të rishikimit të hartuara në mënyrë periodike dhe të bëra publike nga Ministria e Drejtësisë mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare

B.3.b: Zbatimi i legjislacionit për ngritjen e një Zyre të Rikuperimit të Aseteve/Pasurive (ZRA)

Plani i veprimit për Objektivin B.3 parashikon 4 Aktivitete dhe 4 Masa.

B.3.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.2.a** për vitin 2020 është: *hartimi, publikimi dhe i vënia në dispozicion për politikëbërësit e një raporti vlerësimi mbi mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare.*

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është *hartimi i një raporti të tillë vjetor për secilin nga vitet.* Ky tregues synon vlerësimin konstant të akteve ligjore e nënligjore në këtë fushë dhe konsolidimin e praktikave dhe kapaciteteve.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte realizimi gjithashtu hartimi, publikimi dhe i vënia në dispozicion për politikëbërësit i një raporti vlerësimi mbi mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Ky tregues nuk është arritur për vitin 2019.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

B. 3.1	Raport mbi vlerësimin e kuadrit ligjor dhe rekomandimet institucionale për ngritjen e ZRA
B.3.1.1	Grup pune për raportin e vlerësimit (faza I) Institucionet (pjesë e grupit të punës) fillojnë procesin e vlerësimit dhe shqyrtimit (faza II) Hartimi i kalendarit të punës (faza III) Draft/dokument vlerësimi dhe rekomandime të dhëna (faza IV) Dokument final mbi rishikimin e kuadrit ligjor të fushës, për ngritjen e ZRA (faza V)

Realizimi i masës së parashikuar do të kryhet përmes aktivitetit që ka filluar zbatimin në TM 4 të vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, sipas parashikimit në PV, është filluar procesi i ngritjes së grupit të punës ndërinsitucional për vlerësimin e situatës. Grupi do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë.

Për këtë periudhë raportimi nuk është prodhuar ndonjë raport vlerësimi mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Treguesi për vitin 2020 nuk është realizuar.

Siç tregon tabela më poshtë, ky tregues nuk është arritur në asnjë nga tre vitet e matura.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	0	
Vlera e synuar 2018	1	0
Vlera e synuar 2019	1	0
Vlera e synuar 2020	1	0

Duhet theksuar se në këto tre vite janë ndryshuar/amenduar vazhdimisht akte të lidhura me këtë objektiv/tregues, por nuk ka patur ndonjë vlerësim të thelluar të mbështetur në të dhëna për të udhëhequr këto ndryshme, siç parashikohet në metodologjinë e këtij treguesi performance.

Metodologjia e treguesit parashikon kërkesat, proceset, kohën dhe termat për realizimin e vlerës vjetore të synuar. Në metodologji parashikohet rishikimi përshtatshmërisë së kuadrit ligjor duke vlerësuar përputhjen me standardet ndërkombëtare, boshllëqet dhe mbivendosjet në legjislacionit ekzistues kombëtar, etj.

Ky tregues synon të përmirësojë hartimin e politikave të bazuara në të dhëna, siç përcaktohet nga Paketa e Instrumenteve numër për Rregullimin më të Mirë të Bashkimit Evropian.³¹

Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës*.

B.3.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.3.b** për vitin 2020 është: *hartimi i bazës ligjore për ZRA dhe identifikimi i institucionit ku do të vendoset*.

Për vitin 2021 vlera e synuar është realizimi i kornizës për funksionimin e ZRA dhe lista e përpiluar e veprave penale për të cilat është i mundur konfiskimi. Për vitin 2022 vlera e synuar është bërja funksionale e ZRA dhe njoftimi i Komisionit të BE për ngritjen e ZRA. Për vitin 2023 vlera e synuar është caktimi i prokurorëve të specializuar të kushtuar vetëm gjurmimit dhe rikuperimit të pasurive.

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte përzgjedhja e institucionit ku do të ngrihet ZRP dhe hartimi i procedurave standarte bazë. Ky tregues nuk është arritur për vitin 2019 dhe është zhvendosur për vitin 2020.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

B. 3.2	Baza ligjore mbi ZRA (institucioni pritës dhe procedurat standarde të veprimit) të hartuara nga institucioni propozues
--------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

³¹ https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/file_import/better-regulation-toolbox-4_en_0.pdf

B.3.2.1	Kuadri ligjor dhe nënligjor i zhvilluar dhe miratuar (I) Vendimmarrja për strukturën e ZRA (ku do të jetë ky institucion i ri/ si do të ngrihet/ varësia funksionale e tij/ përcaktimi i buxhetit) (II)
B.3.3	Miratimi, ngritja dhe vënie në funksion e ZRA
B.3.3.1	ZRA është funksional dhe bërë publik (I) Hartimi dhe miratimi i procedurave të brendshme (rregullore) (II) Burime njerëzore në detyrë (III)
B. 3.4	Aktivitete ndërgjegjësuere në kuadër të ndëshkimit të krimit ekonomik e financiar
B.3.4.1	Kryerja e tryezave të rrumbullakëta për diskutime me ekspertë, praktikantë, OJF, palë të interesuara, 12 tryeza si dhe publikimi i raportit me rekomandimet përkatëse/fletëpalosje.

Masat parashikohen të realizohen përmes aktiviteteve që kryhen prej 6 mujorit të parë të vitit 2021, 6 mujorit të parë të vitit 2022, dhe 6 mujorit të parë të vitit 2023.

Për vitin 2020 nuk është kryer ndonjë aktivitet apo zbatuar ndonjë masë.

Për këtë periudhë raportimi nuk është hartuar baza ligjore për ZRA dhe nuk është identifikuar institucioni ku do të vendoset ZRA. Treguesi i performancës për vitin 2020 nuk është realizuar.

Siç tregon tabela më poshtë, edhe ky tregues nuk është arritur në asnjë nga tre vitet e matura.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Zyra për Rikuperimin e Pasurive në përputhje me Vendimin i Këshillit Evropian 2007/845/JHA mungon	
Vlera e synuar 2018	Vlerësim i kuadrit ligjor dhe identifikimi i strukturës institucionale për ngritjen e ZRP	Vlerësim për ngritjen e ZRP nuk është kryer.
Vlera e synuar 2019	- Përzgjedhja e institucionit ku do të vendoset ZRP - Miratimi i Procedurave Standarte	Përzgjedhja e institucionit ku do të vendoset ZRP nuk është bërë.
Vlera e synuar 2020	- ZRP është funksionale. - Njoftimi i Komisionit të BE për ngritjen e ZRP	ZRP nuk është funksionale

Ky tregues është i lidhur pjesërisht me treguesin B.3.a për sa realizimi i një vlerësimi të kuadrit ligjor dhe identifikimi i strukturës institucionale për ngritjen e ZRP do të kishte çuar në realizimin e vlerës së synuar për të paktën në një nga tre vitet.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit B.3

Niveli i realizimit të *Objektivit B.3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020 është **0%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{" \&" } \frac{\text{...}}{\text{...}} = 0\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit B.3 për këtë periudhë raportimi është **dobët** (nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesin e performancës nuk janë të verifikueshme në raporte të institucioneve respektive.

Risqet për realizimin e Objektivit B.3

Risku i realizimit të këtij objekti është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me kapacitetet administrative dhe mjedisin rregullativ.

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

B.4.a: Numri i informacioneve të Policisë i shkëmbyer me vendet e treta dhe institucionet mbi-kombëtare mbikëqyrëse të zbatimit të ligjit.

B.4.b: Numri i operacioneve të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë aktivisht.

Plani i veprimit për Objektivin B.4 parashikon 5 Aktivitete dhe 4 Masa.

B.4.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.4.a** për vitin 2020 është: **rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione ndërkombëtare, krahasuar me vitin e mëprshëm.**

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është **po rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione ndërkombëtare, krahasuar me vitin e mëprshëm.**

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte gjithashtu **rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione ndërkombëtare, krahasuar me vitin e mëparshëm.** Ky tregues është arritur për vitin 2019.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

B. 4.1	Forcim bashkëpunimi policor kombëtar dhe ndërkombëtar
B.4.1.1	Shkëmbimi i informacionit si edhe hetime të koordinuara e të përbashkëta mes agjencive
B.4.1.2	Konferenca të përbashkëta me agjencitë homologe për shkëmbim eksperience në hetimet e përbashkëta.

Për realizimin e treguesit forcimi i bashkëpunimit policor kombëtar dhe ndërkombëtar, Policia e Shtetit, sipas marrëveshjeve bashkëpunon, me “INTERPOL” me “EUROPOL, CARIN, INTERFORCE, etj.

Për këtë periudhë raportimi Policia e Shtetit ka shkëmbyer informacione si më poshtë:

- 374 praktika të Interpolit nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiare.
- 106 praktika me EUROPOLIN nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiare
- Me rrjetin e zyrave per gjetjen e rikuperimin e aseteve kriminale CARIN janë shkëmbyer 42 praktika.
- Me INTERFORCEN janë shkëmbyer informacion në 7 praktika.


Gjatë vitit 2020 u shkëmbyen:

- 718 praktika me Interpol.
- 471 praktika me Europol
- 32 praktika me rrjeton CARIN
- 11 praktika me Italian Interforzza Police Liaison Office

Në total Policia e Shtetit ka shkëmbyer më pak informacione se sa gjatë vitit 2019 kështu që rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer nuk është realizuar. Vlera e treguesit nuk është realizuar.


Grafiku më poshtë tregon vlerat e synuara në tre vite dhe vlerat e arritura për numrin e informacioneve të shkëmbyera nga Policia e Shtetit me vendet e treta dhe institucionet ndërkombëtare.

Siç tregojnë të dhënat, ky tregues është arritur në vitet 2018 dhe 2019 por jo në vitin 2020. Megjithatë, vlera kumulative e arritur për 3 vitet është më e lartë se vlera e synuar, kryesisht për shkak të numrit të lartë të informacioneve të shkëmbyera në vitin 2019 me Interpol dhe Europol.



Përveç rritjes me 5% çdo vit të numrit të informacioneve të shkëmbyera, vlera e synuar e vitit 2018 ishte edhe përmirësimi i sitemit për të patur të dhëna të ndara mbi institucionet dhe vendet me të cilat shkëmbehet informacion.

Siç e tregon grafiku më poshtë, edhe ky tregues është realizuar me vlera të ndara çdo vit.



Siç shihet nga të dhënat, sasia dominuese e të dhënave të shkëmbyera është me Interpol dhe Europol. Ka një rritje në vite të informacioneve të shkëmbyera me CARIN (Camden Asset Recovery Inter-agency Network - Rrjeti ndër-agjensor i Gjetjes së Aseteve Camden), i cili fokusohet në gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të krijuara përmes krimin ekonomik, përfshirë korrupsionin.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

B.4.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.4.b** për vitin 2020 është: *kryerja e 5 operacioneve të përbashkëta të Policisë, të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik, ku Shqipëria merr pjesë aktivisht.*

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023 vlera e synuar është *trend rritës krahasuar me vitin e mëparshëm.*

Për vitin 2019 vlera e synuar ishte *kryerja e 4 operacioneve të përbashkëta në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik.* Ky tregues nuk është arritur për vitin 2019.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

Plani i veprimit për Objektivin B.4 parashikon 5 Aktivitete dhe 4 Masa.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

B. 4.2	Kryerja e trajnimeve të përbashkëta dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare si EUROPOL, CEPOL, INTERPOL, CARIN, BAMIN, UNDC, OSBE
B.4.2.1	Trajnime të kryera me kolegë të agjencive homologe (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
B. 4.3	Ngritja e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit
B.4.3.1	Nr. i skuadrave të ngritura
B. 4.4	Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare
B.4.4.1	Nr. i aktiviteteve trajnuese dhe nr. i takimeve e kryera dhe nr. i pjesëmarrësve; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)

Masat parashikohen të realizohen përmes aktiviteteve që kryhen gjatë gjithë periudhës së vitit 2020 e deri në fund të vitit 2023.

Për zbatimin e masës kryerja e trajnimeve të përbashkëta dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare si EUROPOL, CEPOL, INTERPOL, CARIN, BAMIN, UNDC, OSBE, janë kryer 2 trajnime të përbashkëta me CEPOL dhe UNODC me 6 persona të trajnuar, nga të cilët dy janë femra:

- 2 persona të trajnuar në Bosnje Hercegovinë: “Mashttrimet e prokurimeve publike dhe pastrimin e parave”
- 4 persona të trajnuar në Maqedoninë e Veriut: “Trainimi i avancuar i hetimit financiar”.

Për zbatimin e masës forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare, janë zhvilluar 2 aktivitete trajnuese, konkretisht:


- 12 Shkurt 2020, në Hagë, Hollandë, u zhvillua Takimi i 41-të i Rrjetit Gjyqësor Evropian (EJN). Në këtë takim u diskutuan nder te tjerat zhvillimet ne te gjitha vendet sa i perket bashkepunimit gjyqesor nderkombetar, programi i aktiviteteve per vitin 2020 dhe ceshtjet ku duhet te fokusohen, marrëdhëniet e ardhshme me EPPO (Zyra e Prokurorit Publik Evropian). Ne vijim per shkak te pandemise u anuluan aktivitetet e parashikuara dhe nuk u organizuan trajnime te ketij lloji.; 1 aktivitet -1 pjesëmarrës-mashkull.
- 22 korrik 2020 u organizua seminari online nga Projekti Euralius V, ne bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë e Posaçme me 6 (gjashtë) ekspert ndërkomtar “Mbi përvojat ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për hetimet proaktive dhe marrëveshjet për pranimin e fajësisë”, me pjesëmarrjen e 12 prokuroreve e drejtuesve te prokurorive te juridiksionit pergjithshem, 15 prokuroreve dhe O.P.GJ. te Prokurorise se Posaçme dhe 10 O.P.GJ. te Policise se Shtetit

Ndërkohë, që gjatë këtij viti nuk janë ngritur skuadra të përbashkëta hetimore.

Në total Policia e Shtetit ka kryer ose/dhe ka marrë pjesë në 3 operacione të përbashkëta me Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik nga 5 që ishte vlera e synuar për vitin 2020. Vlera e treguesit është realizuar në masën 60%.

Grafiku më poshtë tregon vlerat e synuara në tre vite dhe vlerat e arritura për operacioneve të përbashkëta të Policisë së Shtetit të zhvilluara me Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar. Siç tregojnë të dhënat ky tregues nuk është arritur në asnjë nga tre vitet dhe po kështu diferenca ndërmjet vlerës kumulative të synuar dhe vlerës së arritur është e madhe (58%).

Nisur nga numri i lartë i informacioneve të shkëmbyera nga Policia e Shtetit me vendet e treta dhe institucionet ndërkombëtare, do të duhej që ato të kishin çuar në një numër më të lartë të operacioneve të përbashkëta por kjo nuk ka ndodhur.



Realizimi i këtij treguesi lidhet me objektivin e SKZHI: *Qeverisja e mirë, demokracia, dhe shteti i së drejtës.*

Niveli i realizimit të objektivit B.4

Niveli i realizimit të *Objektivit B.4 Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020 është **30%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtëme:

$$\frac{\text{„\&”}}{\text{„\&”}} = 30\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit B.4 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm** (51 në 85 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Policisë së Shtetit (<https://mb.gov.al/ep-content/uploads/2020/07/Policia-e-Shtetit-ANALIZA-VJETORE-2019.pdf>; <http://ëëë.punetebrendshme.gov.al/ep-content/uploads/2019/05/Raporti-Vjetor-per-Arritjen-e-Objektivave-nga-PSH-2018.pdf>)

Risqet për realizimin e Objektivit B.4

Risku i realizimit të këtij objektiv është i mesëm për shkak të rreziqeve të lidhura me partnerët e jashtëm si dhe reziqe që lidhen me planifikimin, proceset, sistemet IT dhe sistemet e tjera mbështetëse.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit (Qasja B)

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 4 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit është 20%.

Objektivi	Realizueshmëria
B.1. Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	0%

B.2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit	50%
B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	0%
B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.	30%

Qasja Ndërgjegjësuere - Përmbledhje për arritjet në ndërgjegjësimin mbi korrupsionin

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) ndërgjegjësuere SNKK** synon të rrisë pjesëmarrjen e publikut në luftën kundër korrupsionit duke e denoncuar atë dhe duke qenë aktiv në iniciativat e parandalimit të korrupsionit, edukimin e publikut dhe ndërmarrjen e aktiviteteve me efekt ndërgjegjësimi.


Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2020	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ³²	Masa dhe aktivitete të parealizuara ³³
Ndërgjegjësuere	Masa	9	6	1	2
	Aktivitete	24	14	1	9

Rezulton se nga 9 masa e 24 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për vitin 2020, për Qasjen C (Ndërgjegjësuere), janë zbatuar 6 masa/14 aktivitete, 1 masë/1 aktivitet është ende në proces zbatimi dhe 2 masa/9 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa C 3.1; C.3.2 dhe aktivitete C.3.1.1; C.3.1.2; C.3.1.3; C.3.1.4; C.3.1.5; C.3.1.6, C.3.2.1; C.3.2.2. e C.3.2.3).

³² Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

³³ Aktivitet "i përpunuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind




Nga 7 treguesit e performancës të caktuar për qasjen ndërgjegjësuere, përmes realizimit të masave dhe kryerjes së aktiviteteve respektive është arritur vlera e synuar për 2 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 1 tregues performance si edhe nuk është arritur vlera e synuar për 4 tregues performance.

Qasja Ndërgjegjësuere	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ³⁴	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ³⁵	Vlera e synuar nuk është e realizuar ³⁶
	7	2	1	4

³⁴ Që është realizuar në shkallën 100 për qind

³⁵ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

³⁶ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna



C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

C.1.a: Krijimi i planeve vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit të Strategjisë Kundër Korrupsionit.

C.1 b: Numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit.

Plani i Veprimit për Objektivin C.1 parashikon 14 aktivitete dhe 4 masa, nga të cilat, për vitin 2020 janë parashikuar 12 aktivitete e 4 masa.

C.1.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.1.a** për vitin 2020 është hartimi dhe finalizimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 dhe zbatimi 50% e aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe komunikimit të parashikuara në Planin e dhe Komunikimit. Për vitin 2021 vlera e synuar është Zbatim i 100% i aktiviteteve të parashikuara në atë plan, për vitin 2022 vlera e synuar është realizimi i rishikimit të Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është miratimi dhe zbatimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit.

Gjatë vitit 2019, MD hartoi dhe publikoi Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit (PK&V) për vitin 2019. Megjithatë, publikimi u bë në 3-mujorin e 3. Nuk është raportuar buxhet specifik për zbatimin e tyre. Arritja e vlerës së synuar është arritur në masën 50% nga MD.

Vlera e synuar për vitin 2020 është finalizimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

C.1.1	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit në zbatim të SNKK/vjetor, i hartuar
C.1.1.1	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 i hartuar nga grupi i punës/miratuara nga MD
C.1.1.2	Plane vjetore Vizibiliteti dhe Komunikimi të rishikuara dhe miratuara (2021/2022/2023)
C.1.4	Transparencë e shtuar në bërjen publike të raporteve të monitorimit të SNKK dhe zbatimit të planit të veprimit AK dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të tij
C.1.4.1	Raporte periodike monitorimi të Planit të Veprimit/të Pasaportës së Treguesve (publikim i tyre) (raporte 3M/6M/vjetore)
C.1.4.2	Publikim/shpërndarje e e-buletine të dokumenteve të AK (raporte; monitorime etj.) në target grupe studentë/OSHC/forume biznesi

Realizimi i masave (2) të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlerë të matshme hartimit dhe publikimit të Planit të Komunikimit & Vizibilitetit dhe me rritjen e transparencës së institucionit përmes hartimit dhe publikimit të raporteve periodike të monitorimit të Planit të Veprimit (raporte 3M/6M/vjetore) dhe shpërndarje të materialeve dhe informacioneve në fushën e politikave antikorrupsion.

Gjatë vitit 2020, Ministria e Drejtësisë në rolin edhe të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka hartuar dhe publikuar Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit (PK&V) për vitin 2020. Ky dokument konsiston në 16 masa/aktivitete konkrete, të realizuara me mbështetje të donatorëve dhe partnerëve të huaj në fushë, por edhe me angazhimin e drejtëpërdrejtë të stafit teknik dhe të kabinetit të Ministrit të Drejtësisë, për target grupe të ndryshme me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të luftës kundër korrupsionit, link: http://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2020/09/CV-Strategy_-FINALE_PER-Publikim@S03.09.2020.pdf;

Janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë raportet e monitorimit, përkatësisht: Raporti Vjetor i Monitorimit të SNKK-së, Janar-Dhjetor 2019 (në gjuhën shqipe dhe angleze) e të Pasaportës së Treguesve; Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Janar-Mars 2020 (në gjuhën shqipe dhe angleze); Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Janar-Qershor 2020 (në gjuhën shqipe dhe angleze); Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Korrik-Shtator 2020 (në gjuhën shqipe dhe angleze). Publikimi i këtyre raporteve është paraprindë edhe nga publikimi për efekt konsultimi me publikun dhe grupet e interesuara edhe të drafteve të tyre, link: <http://ëëë.drejtësia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-kunder-korrupsionit>.

Publikimi i këtyre raporteve është paraprindë edhe nga publikimi për efekt konsultimi me publikun dhe grupet e interesuara edhe të drafteve të tyre gjithashtu.

Gjatë vitit 2020, ka vijuar rregullisht konsultimi i dokumenteve AK (raporte monitorimi dhe drafti i PV PQH (OGP) komponenti antikorrupsion) në rrjetin e organizatave në fushën antikorrupsion.

Netëork/forumi i OSHC për AK i krijuar për këtë qëllim është njoftuar rregullisht mbi akte dhe procese të ndjekura nga MD në kuadër të AK.

Hartimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit në zbatim të SNKK dhe sigurimi i transparencës në bërjen publike të raporteve të monitorimit të SNKK dhe zbatimit të planit të veprimit AK dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të tij janë mundësuar me kosto administrative duke mos kërkuar kosto të shtuar të buxhetit të MD/KKK.

Për këtë periudhë raportimi është hartuar dhe publikuar Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 dhe janë zbatuar plotësisht aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe komunikimit të parashikuara në Planin e dhe Komunikimit. Treguesi për vitin 2020 është realizuar 100%.

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura. Realizueshmëria e këtij treguesi ka qenë e dobët në dy vitet e para, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe ekspertizës së nevojshme për realizimin e aktiviteteve dhe masave respektive.

Ky tregues është realizuar plotësisht vetëm për vitin 2020.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit të SNKK mungon	
Vlera e synuar 2018	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2018 finalizohet në 3 Mujorin 2 të vitit.	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit nuk u realizua për vitin 2018
Vlera e synuar 2019	- Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2019 finalizohet dhe publikohet në 3 Mujorin 1 të vitit. - Buxheti specifik i alokuar për zbatimin e Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2019 u realizua në 3 Mujorin 3 të vitit.
Vlera e synuar 2020	- Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 finalizohet dhe publikohet në 3 Mujorin 1 të vitit. - Janë zbatuar 50% e detyrave të ndërgjegjësimit dhe komunikimit të parashikuara në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit 2019.	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 u realizua në 3 Mujorin 1 të vitit

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë demokracia dhe shteti i së drejtës.*

C.1.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.1.b** për vitin 2020 është: *Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit.* Për vitin 2021 vlera e synuar është: *Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit,* për vitin 2022 vlera e synuar është *Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit,* dhe për vitin 2023 vlera e synuar *Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit.*

Gjatë vitit 2019, raporti i monitorimit përfshin një numër aktivitete të kryera dhe targeti është i realizuar 100%. Vlera e synuar për vitin 2020 është *Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit.*

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (10) dhe masat (2) si më poshtë.

C.1.2	Instrumente ndërgjegjësuere dhe informuese kundër korrupsionit të zbatuara në vend
C.1.2.1	Ideimi, hartimi dhe miratimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere e informuese specifike; (aktivitete me mesazhe të qarta/të përshtatshme për femra dhe meshkuj; numri i aktiviteteve që adresojnë pasojat specifike të korrupsionit) - përgjatë viteve 2020/2021/2022/2023
C.1.2.2	Java e Integritetit 2020 (3- 11 shkurt 2020) - tryeza, forume AK, aktivitete sportive etj.
C.1.2.3	Tryezë për promovimin e planit të integritetit të MD , modeli i dokumentit për institucionet e qeverisjes qendrore në vend
C.1.3	Mekanizma me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe të besimit të publikut në forcimin e luftës kundër korrupsionit
C.1.3.1	Botime të publikuara në kuadër të ndërgjegjësimit qytetar në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri: - Broshurë: SNKK (v.2020) - Broshurë: Hapat për të denoncuar korrupsionin në Shqipëri (v.2020)
C.1.3.2	Takime duke angazhuar të rinjtë (auditoret universitare) dhe komunitetet parauniversitare për njohjen e pasojave që vijnë nga korrupsioni, në fusha si arsim/shëndetësi/tatimedogana/prona/gender, (v.2020/2021/2022/2023)
C.1.3.3	Film Festival Antikorrupsion 2020
C.1.3.4	Organizimi e pjesëmarrja në evente mediatike mbi antikorrupsionin:/takime me gazetarët/konferenca/deklarata/e- KKK/MD TM II 2020 TM IV 2020 kosto administrative 15 buletine/njoftime etj.
C.1.3.5	Seminar/ëorkshop për antikorrupsionin me grupe të interesuara/identifikuara nga SNKK (v.2020/2021/2022/2023)
C.1.3.6	Seminare për forcim kapacitetësh të vlerësimit të riskut të integritetit për stafin drejtorisë AK (kurikula AK)
C.1.3.7	Dita Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit (9 dhjetor) - aktivitet ndërgjegjësues në MD, aktivitet që kryhet për çdo vit të zbatimit të PV

Realizimi i masave (2) të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të aktivitetve dhe eventeve ndërgjegjësuere të kryera çdo 3 mujor.

Gjatë vitit 2020 janë realizuar aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese të cilat i drejtohen grupeve të ndryshme të shoqërisë.

Ministria e Drejtësisë/ KKK ka hartuar, miratuar dhe zbatuar një listë aktiviteteve të karakterit ndërgjegjësues për vitin 2020, përmendim: fushata ndërgjegjësimi, paketa informuese, aktivitete për edukimin kundër korrupsionit, bashkëpunim me OSHC, përfshirje të target grupe të ndryshme

(sport/akademi/art/të rinj), aktivitetet janë zhvilluar në formatin hibrid (me pjesëmarrje fizike dhe online) për shkak të pandemisë Covid-19.

Gjatë Javës së Integritetit, 3-11 shkurt 2020 u organizuan 22 aktivitete nga 28 partnerë. Përmes aktiviteteve të ndryshme me OJF-të, ekspertë të antikorrupsionit, akademikë, studentë dhe biznese, Ministria e Drejtësisë pati mundësinë të shkëmbejë ide, të ndërtojë ura të reja bashkëpunimi, të hapet më shumë për transparencë dhe të eksplorojë mundësitë për koalicione të reja në luftën kundër korrupsionit.

MD/KKK në kuadër të projektit Komunikimi dhe Vizibiliteti: Kontrata e Reformës Sektoriale për Luftën kundër Korrupsionit, mbështetur nga DBE, ka përfunduar së konceptuari botimin për shpërndarje publikut: Fletëudhëzuesit (guidelines) - Si të merrni informacion mbi korrupsionin dhe si të denonconi një rast korrupsioni.

Në datat 1-9 dhjetor 2020, Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, organizoi edicionin e dytë të Festivalit të Filmit Anti-Korrupsion, në kuadër të Javës së Integritetit 2.

Filmat e përfshirë në këtë edicion janë prodhuar nga regjizorë të talentuar e të mirënjohur shqiptarë si dhe regjizorë nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Filmat trajtojnë tipologji të ndryshme të korrupsionit dhe mënyrave se si mund të angazhohemi për të luftuar për një shoqëri që ka integritetin në themelet e saj. Filmat mund të ndiqeshin përmes transmetimit online falas në platformën e kësaj faqeje interneti, si dhe në kanalet RTSH Film dhe RTSH Shqip, në sajë të partneritetit me Radio Televizionin Publik Shqiptar. Të gjithë filmat e huaj ishin të shoqëruar me titra në gjuhën shqipe. Në kuadër të këtij Festivali Filmi, u organizuan 4 panele diskutimi online, në formën e një forumi diskutimi virtual që do të mblodhi së bashku ekspertë në fushën e anti-korrupsionit, sociologjisë, psikologjisë dhe kinematografisë. Të gjithë panelet, 4 në total, ishin të disponueshme online përgjatë gjithë kohëzgjatjes së Festivalit. Partnerët e Festivalit të Filmit Anti-Korrupsion janë Ambasada e Austrisë, Ambasada e Francës, Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, Ambasada e Italisë, Ambasada e Rumanisë, Institutet e Kulturës së Italisë dhe Rumanisë, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Radio Televizioni Publik Shqiptar, si dhe prodhuesit e filmave pjesëmarrës në festival dhe A2CNN si partner mediatik.

Gjatë vitit 2020 MD në cilësinë dhe ushtrimin e funksionit të KKK ka zhvilluar dhe bërë publike deklarata dhe pjesëmarrje përp ublikun/ njoftime/intervista/takime me gazetarë për ecurinë e përpjekjeve në luftën kundër korrupsionit.

Konferenca ndërkombëtare “Qeverisja e mirë dhe lufta kundër korrupsionit në epokën dixhitale”, nën kujdesin e Kryesisë shqiptare të OSBE-së për vitin 2020; Forumi i Nivelit të Lartë të Këshillit të Europës ‘Antikorrupsioni në Kohë Krize’; Konferencë e nivelit të lartë AK (lufta efikase kundër korrupsionit dhe rrënjosja e një kulture të shëndoshë integriteti për të gjithë shoqërinë).

Këto aktivitete janë realizuar me buxhetin e MD (kosto administrative) dhe me mbështetjen e DBE, në kuadër të projektit Komunikimi dhe Vizibiliteti: Kontrata e Reformës Sektoriale për Luftën kundër Korrupsionit.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këto masa (si më lart), me aktivitetet dhe produktet e realizuara ka ndikuar

drejtpërdrejtë në mënyrën e realizimit të treguesit. Treguesi për vitin 2020 është arritur në masën 100%.

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura. Realizueshmëria e këtij treguesi ka qënë e dobët në vitin e parë por është realizuar plotësisht në dy vitet e fundit.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Fushatat e ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit nuk zbatohen në mnyrë të programuar	
Vlera e synuar 2018	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara për luftën kundër korrupsionit	0
Vlera e synuar 2019	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara për luftën kundër korrupsionit	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara
Vlera e synuar 2020	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara për luftën kundër korrupsionit	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë demokracia dhe shteti i së drejtës*.

Niveli i realizimit të Objektivit C.1

Niveli i realizimit të Objektivit C.1 *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\frac{\text{Vlera e arritur}}{\text{Vlera e synuar}} = 100\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit C.1 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve të monitorimit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe në seksionin e dedikuar Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë (<https://ëëë.drejtësia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-kunder-korrupsionit/>). Njoëftime mbi aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit janë gjithashtu të publikuara rregullisht në ëëë.drejtësia.gov.al, në menu *neësroom*.

Risqet për realizimin e Objektivit C.1

Risku i realizimit të këtij objektivi është i mesëm për shkak të rreziqeve të brendshme të lidhura me planifikimin, programimin dhe kapacitetet, burimet financiare dhe ekspertizën.

C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

C.2.a: Numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuar në platformën ëëë.shqipëriaqeduam.al

C.2.b: Numri i rasteve të korrupsionit nga denoncimet e qytetarëve në ëëë.shqipëriaqeduam.al, të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare

Plani i Veprimit për Objektivin C.2 parashikon (4) Aktivitete dhe (3) Produkte/Masa.

C.2.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.2.a** për vitin 2020 është: **rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm**. Për vitin 2021 vlera e synuar është rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm, për vitin 2022 rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm. Gjatë vitit 2019, platforma/portali ëëë.shqipëriaqeduam.al ka marrë 23,605 ankesa, kërkesa dhe tjera forma ankesash për institucione qendrore, ngë të cilat 22,423 janë adresuar (ndryshimi lidhet me ankesat dhe çështjet të cilat ishin në proces përpunimi në kohën e raportimit).

Megjithë përmirësimet e bëra në systemin e portalit për të lejuar gjurmimin dhe etiketimin elektronik të rasteve të dyshuara të korrupsionit, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje që menaxhon portalin nuk ka dhënë në mënyrë të ndarë rastet e korrupsionit nga llojet e ndryshme të ankesave për të cilat qytetarët i adresohen portalit.

Vlera e synuar për vitin 2019 në treguesin e performancës ishte 30% më shumë raste denoncimi të qytetarëve për korrupsion të paraqitura në platformën ëëë.shqipëriaqeduam.al. Nëse llogaritet bazuar në numrin e përgjithshëm të rasteve të regjistruara për vitin 2019, vlera që duhet të arrihej është 35.016 (26.936+ (30%) 8.080).

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

C.2.1	Raportimi periodik i ADB mbi denoncimet e dorëzuara në portal
C.2.1.1	Raporti i prodhuar dhe i publikuar
C. 2.2	Dorëzimi i kërkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portalin të cilat janë raportuar në Policinë e Shtetit/Prokurori

C.2.2.1	Raporti periodik i prodhuar dhe i publikuar
C.2.2.2	Nr. i rasteve të referuara PSH/Prokurori; (rastet e referuara të ndara mbi bazë gjinie)

Realizimi i masës të parashikuar kryhet përmes masave (2) dhe aktiviteteve të parashikuara që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të hartimit dhe publikimit të raportit vjetor në 3 muajin e katërt të vitit (6M 2).


Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje raporton periodikisht mbi denoncimet e qytetarëve dhe bizneseve, rregullisht (çdo javë) nëpërmjet të dhënave të detajuara të paraqitura në raport për çdo ministër dhe zyrën e Kryeministrit.

Gjatë vitit 2020, janë regjistruar 29.817 çështje, kërkesa, ankesa, pranë platformës ëëë.shqipëriaqeduam.com. Çështjet lidhen me nivelin qendror të qeverisjes dhe me nivelin vendor. Në nivelin qendror janë 24.603 çështje dhe 5.214 në nivel vendor.

Sipas vlerës së synuar të treguesit, për vitin 2020 portali www.shqipëriaqeduam.com duhet të kishte marrë 30,332 raportime të qytetarëve [23,605 + 30% (6727)]. Kjo paraqet një rritje prej 23.2% nga 40% që ishte vlera e synuar. Mbi këto të dhëna, treguesi për vitin 2020 është realizuar në masën 58%.

Grafiku më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura. Për shkak se të dhënat e denoncimeve në portalin ëëë.stopkorrupsionit.al në vitin 2017 nuk u nxorrën asnjëherë, realizimi në masën 25% më shumë se viti i mëparshëm ka qenë i pamundur për vitin 2018. Kështu numri i ankesave të qytetarëve në vitin 2018 shërben si vlerë bazë për vitet në vijim.

Siç tregojnë të dhënat vlerat e synuara të treguesit nuk janë arritur në vitet 2019 dhe 2020 (30% rritje dhe 40% rritje respektivisht).



Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë demokracia dhe shteti i së drejtës.*

C.2.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.2.b** për vitin 2020 është: *rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak; për vitin 2021 vlera e synuar është rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm, për vitin 2022 rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm.*

Vlera e synuar për vitin 2020 është rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak.

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

C. 2.2	Dorëzimi i kërkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portalin të cilat janë raportuar në Policinë e Shtetit/Prokurori
C.2.2.1	Raporti periodik i prodhuar dhe i publikuar
C.2.2.2	Nr. i rasteve të referuara PSH/Prokurori; (rastet e referuara të ndara mbi bazë gjinie)
C.2.3	Transparencë e rritur e ADB, specifikuat për rastet e denoncimeve kundër korrupsionit
C.2.3.1	Aktivite informuese mbi mënyrën e funksionit të portalit për publikun (publikime/ëeb/ njoftime)

Realizimi i masave së parashikuara (2) kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të aktiviteteve.

Gjatë vitit 2020, janë përmirësuar proceset në sistemin elektronik të platformës së bashkëqeverisjes duke mundësuar gjurmimin dhe etiketimin elektronik të rasteve të dyshuara si korruptive. Nga ADB është raportuar pranë njësisë antikorrupsion në Kryeministri dhe pranë Task Forcës Antikorrupsion në MD, si dhe në institucionet ku denoncohet rasti, vetëm 1 rast, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërkohë që institucionet nuk kanë raportuar pranë ADB për ndonjë nga ankesat/raportimet për raste korruptive të jenë referuar në Policinë e Shtetit apo në Prokurori.

Gjatë vitit 2020, platforma e bashkëqeverisjes ka pasur një proaktivitet të shtuar me qëllim bashkëqeverisjen me qytetarët dhe bizneset, e cila shërben për të ndërvepruar në kohë reale për çështje të aktualitetit politik e qeverisës. Përmes promovimit të aktiviteteve të saj, platforma ka ftuar qytetarët dhe bizneset t'i drejtohen duke paraqitur problematikën e tyre, me qëllim për ta zgjidhur atë në një kohë të shkurtër përmes një procesi transparent dhe të shpejtë, si edhe duke dhënë kontributin në përmirësimin e cilësisë së shërbimit në administratën shtetërore.

Platforma e Bashkëqeverisjes informon publikun përmes imazheve dhe videove në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente mbi aktivitetin që kryen me qëllim që të kthehet në një urë lidhëse për bashkëqeverisjen, që garanton gjithëpërfshirjen e qytetarëve dhe bizneseve në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Hapësirat ku platforma e bashkëqeverisjes promovon aktivitetin e saj janë:

Website: www.shqiperiaqeduam.al

Facebook: Shqipëria që duam

Instagram: shqiperiaqeduam

Twitter: @ShqiperiaQeDuam

YouTube: Shqiperia qe duam

Këto masa dhe aktivitete janë kryer me kosto administrative.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi (si më lart), me aktivitetin e kryer ka ndikuar drejtpërdrejtë në mënyrën e realizimit të treguesit, i cili nuk është arritur.

Platforma e bashkëqeverisjes akoma nuk ka arritur të ndajë rastet e denoncimit të korrupsionit nga llojet e tjera të raportimeve që merr nga qytetarët. Gjatë vitit 2020 janë dhënë 34 masa ndëshkimore nga hetimet administrative për mosdhënien në kohë të së drejtës qytetarëve.

Por dërgimi për shqyrtim i rasteve në institucionet për të cilat qytetarët raportojnë ka cuar në kryerjen e hetimeve administrative dhe marrjen e masave administrative por nuk ka cuar në fillimin e ndonjë hetimi kriminal nga institucionet e zbatimit të ligjit.

Kështu, vlera e synuar e treguesit mbi numrin total të denoncimeve të qytetarëve për rastet korruptive të denoncuar në platformën ëëë.shqiperiaqeduam.al për vitin 2020 nuk është realizuar.

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura. Siç tregojnë të dhënat vlerat e synuara të treguesit nuk janë arritur në asnjë nga 3 vitet e matura.


	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Numri i rasteve të gjeneruara nga portali www.stopkorrupsionit.al	
Vlera e synuar 2018	25% rritje	0
Vlera e synuar 2019	30% rritje	0
Vlera e synuar 2020	40% rritje	0

Metodologjia e treguesit të performancës parashikon se Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) duhet të ndjekë rastet e korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në ëëë.shqiperiaqeduam.al derisa ato raste të pushohen ose zgjidhen administrativisht nga institucionet e linjës, ose të përcillen në Policinë e Shtetit Shqiptar.

ADB ka ndjekur çështjet me institucionet e linjës por asnjë rast denoncimi në këto tre vite nuk ka përbërë bazë për iniciimin e një hetimeve penale për korrupsion.

Grafiku më poshtë tregon tendencën në numrin e masave ndëshkimore administrative të dhëna si pasojë e denoncimeve të qytetarëve në platformën www.shqiperiaqeduam.al. Siç shihet, edhe për

këtë tregues i cili në mungesë të të dhënave për hetime penale mund të përdorej si *proxy*³⁷, tendenca ka qenë në rënie.



Megjithatë për sa i përket numrit të rasteve të korrupsionit nga denoncimet e qytetarëve në të cilat i raportohen Policisë së Shtetit apo Prokurorisë treguesi nuk është arritur në asnjë nga vitet.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë demokracia dhe shteti i së drejtës*.

Niveli i realizimit të Objektivit C.2

Niveli i realizimit të *Objektivit C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020 është **29%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtëme:

$$\frac{86}{110} = 29\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit C.2 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara).

³⁷ Treguesi proxy, ofrojnë zgjidhjen në rastet kur mungojnë të dhëna mbi një tregues të caktuar. Në disa raste këto të dhëna mund të jenë të përkohshme ndërkohë që ngrihet një sistem të dhënash ose zbatohet një program monitorimi.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (<https://ëëë.shqipëriaqeduam.al/>) dhe raporteve të Policisë së Shtetit (<https://mb.gov.al/ep-content/uploads/2020/07/Policia-e-Shtetit-ANALIZA-VJETORE-2019.pdf>; <http://ëëë.punetebrendshme.gov.al/ep-content/uploads/2019/05/Raporti-Vjetor-per-Arritjen-e-Objektivave-nga-PSH-2018.pdf>).

Risqet për realizimin e Objektivit C.2

Risku i realizimit të këtij objekti është i lartë për shkak të rreziqeve të brendshme të lidhura me proceset dhe sistemin si dhe rreziqe që lidhen me koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

C.3 Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

C.3.a: Hartimi i një Programi Anti-korrupsion nga AMSHC-ja

C.3.b: Raporti i projekteve të anti-korrupsionit të financuar nga AMSHC

C.3.c: Alokimi i buxhetit në mbështetje të projekteve të Anti-korrupsionit nga OSHC-të

Plani i Veprimit për Objektivin C.3 parashikon (9) Aktivitete dhe (2) Produkte/Masa.

C.3.a

Vlera e synuar për treguesin e performancës C.3.a për vitin 2020 është: **përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2019**; për vitin 2021 vlera e synuar është **përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2020**; për vitin 2022 është **përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2021 dhe për vitin 2023 vlera e synuar është përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2022**.

Gjatë vitit 2019, AMSHC e ka realizuar vlerën e synuar të treguesit me krijimin e Programit Antikorrupsion në 2019.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

C.3.1	Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV)
C.3.1 .1	Hartimi i termave të referencës
C.3.1 .2	Pritja e aplikimeve 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit)

C.3.1 .3	Vlerësimi i aplikimeve
C.3.1 .4	Shpallja e fituesve
C.3.1 .5	Raportimet finale të OSHC-ve
C.3.1 .6	Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve

Realizimi i masës të parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme publikimit të thirrjeve të hapura për programin AK.

Për vitin 2020, AMSHC raporton mungesë të zbatimit të aktiviteteve për shkak të situatës së Pandemisë Covid-19, që ndikoi në reduktimin e fondeve në buxhetin e AMSHC. Bordi Mbikqyrës, vendosi që buxheti i mbetur në dispozicion të thirrjes, t'i dedikohet situatës së pandemisë.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar për moskryerje të asnjë aktiviteti dhe produkti të parashikuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, nuk është arritur vlera e synuar.

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura. Siç tregojnë të dhënat, vlerat e synuara të treguesit është arritur vetëm në njërin nga 3 vitet e matura.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	AMSHC nuk ka programi Anti-Korrupsion për të orientuar financimin e projekteve Anti-Korrupsion zbatuara nga organizata të shoqërisë civile	
Vlera e synuar 2018	Hartimi dhe miratimi i programit Anti-Korrupsion (duke përfshirë dhe Planin e Veprimit 2019-2020)	Programi Anti-Korrupsion nuk u miratua në vitin 2018
Vlera e synuar 2019	Hartimi dhe publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të Programit Anti-Korrupsion (si pjesë e veçantë e raportit vjetor të Agjencisë)	Programi Anti-Korrupsion u miratua në vitin 2019
Vlera e synuar 2020	Është kryer vlerësimi i jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit Anti-Korrupsion të vitit 2019	Vlerësimi i jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit Anti-Korrupsion të vitit 2019 nuk është kryer

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë demokracia dhe shteti i së drejtës*.

C.3.b

Vlera e synuar për treguesin e performancës C.3.b për vitin 2020 është: **rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm**; për vitin 2021 vlera e synuar është rritje rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm, për vitin 2022 rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm.

Gjatë vitit 2019, AMSHC nuk e ka realizuar vlerën e synuar të treguesit prej 25% rritje në krahasim me vitin e mëparshëm pasi ka financuar 9 projekte për antikorrupsionin, që përbëjnë 17.3% të totalit të 52 projekteve të financuara në 2019 (numri i përgjithshëm i projekteve është marrë nga Raporti i Monitorimit Financiar të AMSHC 2019).³⁸

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

C.3.1	Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV)
C.3.1 .1	Hartimi i termave të referencës
C.3.1 .2	Pritja e aplikimeve; 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit)
C.3.1 .3	Vlerësimi i aplikimeve
C.3.1 .4	Shpallja e fituesve
C.3.1 .5	Raportimet finale të OSHC-ve
C.3.1 .6	Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve

Realizimi i masës së parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme publikimin e thirrjeve të hapura për programin AK.

Për vitin 2020, AMSHC raporton mungesë të zbatimit të aktiviteteve për shkak të situatës së Pandemisë Covid-19, që ndikoi në reduktimin e fondeve në buxhetin e AMSHC. Bordi Mbikqyrës, vendosi që buxheti i mbetur në dispozicion të thirrjes, t'i dedikohet situatës së pandemisë.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar për moskryerje të asnjë aktiviteti dhe produkti të parashikuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, nuk është arritur vlera e synuar.

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura. Siç tregojnë të dhënat, vetëm për njërin nga 3 vitet e matura janë prodhuar të dhëna për vlerën e synuar e cila është realizuar në masën 69.2%, të vlerës totale të synuar prej 25%.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	14.29%	
Vlera e synuar 2018	20%	0
Vlera e synuar 2019	25%	17.3%
Vlera e synuar 2020	25%	0

³⁸ <http://ëëë.amshc.gov.al/ëeb/raporte/monitorimi/2019/Raport%20Monitorimi%20Financiar%20-%202019.pdf>

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë demokracia dhe shteti i së drejtës.*

C.3.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.3.c** për vitin 2020 është: **rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm**; për vitin 2021 vlera e synuar është rritje rritje 25% në krahasim me vitin e mëparshëm, për vitin 2022 rritje 25% në krahasim me vitin e mëparshëm, dhe për vitin vlera e synuar është 2023 rritje 25% në krahasim me vitin e mëparshëm.

Gjatë vitit 2019, AMSHC nuk e ka realizuar vlerën e synuar të treguesit prej 25% rritje në krahasim me vitin e mëparshëm pasi alokoi vetëm 20,800,000 ALL për 9 projektet për luftën kundër korrupsionit, të cilat përbëjnë 20% të shumës së të gjitha granteve.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

C.3.1	Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV)
C.3.1 .1	Hartimi i termave të referencës
C.3.1 .2	Pritja e aplikimeve 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit)
C.3.1 .3	Vlerësimi i aplikimeve
C.3.1 .4	Shpallja e fituesve
C.3.1 .5	Raportimet finale të OSHC-ve
C.3.1 .6	Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve

Realizimi i masës së parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme realizimin e aktiviteteve si hartimi i termave të referencës, pritja dhe vlerësimi i aplikimeve për t'u kryer gjatë 3MI e në vijim.

Për vitin 2020, AMSHC raporton mungesë të zbatimit të aktiviteteve për shkak të situatës së Pandemisë Covid-19, që ndikoi në reduktimin e fondeve në buxhetin e AMSHC. Bordi Mbikqyrës, vendosi që buxheti i mbetur në dispozicion të thirrjes, t'i dedikohet situatës së pandemisë.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar për moskryerje të asnjë aktiviteti dhe produkti të parashikuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, nuk është arritur vlera e synuar.

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura. Siç tregojnë të dhënat, vetëm për njërin nga 3 vitet e matura janë prodhuar të dhëna për vlerën e synuar, e cila është realizuar në masën 80%, të vlerës totale të synuar prej 25%.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	13.56%	
Vlera e synuar 2018	20%	0
Vlera e synuar 2019	25%	20%
Vlera e synuar 2020	20%	0

Realizimi i këtij treguesi lidhet me shtyllën e SKZHI: *Qeverisja e mirë demokracia dhe shteti i së drejtës*.

Niveli i realizimit të Objektivit C.3

Niveli i realizimit të *Objektivit C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2020 është **0%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtëme:

$$n = \frac{(\$ \text{ i shprehur në } \$) \times (\$ \text{ i shprehur në } \$)}{(\$ \text{ i shprehur në } \$)}$$

Shkalla e realizimit të objektivit C.3 për këtë periudhë raportimi është **dobët** (0-30 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë të verifikueshme përmes raporteve vjetore mbi veprimtarinë AMSHC (<http://ëëë.amshc.gov.al/ëeb/raporte/vjetore/>).

Risqet për realizimin e Objektivit C.3

Risku i realizimit të këtij objektivit është i lartë për shkak të rreziqeve të brendshme të lidhura me proceset financiare dhe shpërndarjen e fondeve.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër korrupsionit (Qasja C)

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 3 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit është 43%.

Objektivi	Realizueshmëria
C.1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	100%
C.2. Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	29%
C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	0%

III. PROGRESI LIDHUR ME OBJEKTIVAT REZULTATET DHE IMPAKTIN

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Mbështetur në informacionin mbi vlerat e synuar të aktiviteteve dhe masave të realizuara, të treguesve të performancës, realizimi i objektivave për *janar - dhjetor 2020* është si më poshtë.

Realizimi sipas aktiviteteve/masave	Realizimi sipas treguesve ³⁹
Dobët - 5 objektiva	Dobët – 5 objektiva
Mjaftueshëm - 4 objektiva	Mjaftueshëm - 4 objektiva
Mirë - 1 objektiva	Mirë - 1 objektive
Shumë mirë - 8	Shumë mirë - 6
Tejkaluar – N/A objektiv	Tejkaluar – 1 objektive

Histori sukcesi (përmes masave prioritare)

Arritjet kryesore më të rëndësishme *për periudhën vjetore janar – dhjetor 2020*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit janë si më poshtë vijon:

1. Për vitin 2020 është tejkaluar instalimi i regjistrimit elektronik nga 21 autoritete publike, me një rritje prej 8 autoritete publike. Për vitin 2020 janë 59 autoritete publike në total, që

³⁹ Objektivi A7, nuk është përfshirë në vlerësim.

përdorin regjistër elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve; të gjitha ministritë kanë miratuar dhe publikuar në faqet e tyre të internetit programet e transparencës; janë kryer monitorime të KDIMDHP ndaj koordinatorëve të AP për regjistrin e kërkesë/ankesave; është hartuar një raport monitorimi të transparencës proaktive përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës së bashku me indeksin e transparencës.

2. Në vitin 2020 ka filluar një proces i ri për shërbimet publike, ai i ofrimit të aplikimeve për shërbime publike për qytetarët dhe bizneset vetëm online. Qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm përmes platformës e-Albania dhe punonjësit e administratës publike mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet shtetërore tani përdoren dhe ripërdoren, duke i çliruar qytetarët nga barra e grumbullimit të tyre fizikisht në letër në sportelet e shtetit. Për vitin 2020, numri i shërbimeve elektronike të shtuara sipas treguesit është tejkaluar me 69.6%; janë 1021 shërbime elektronike në përdorim; janë 1.87 milionë përdorues të platformës e-Albania dhe 7.7 milionë aplikime/përdorime të shërbimeve elektronike në përdorim. Disa prej shërbimeve online të shtuara specifikisht gjatë 2020 janë: ASHK (Rivlerësimi i pasurisë); MD (Aplikim për ekspert gjykatë; Vlerësim i ekspertëve në gjykata; Vërtetim si ekspert gjykatë); MASR (Aplikim për Fondin e Ekselencës (për nëpunësit e administratës shtetërore/për studentët e ciklit të parë dhe të dytë/për studimet e doktoraturës); Aplikim për vërtetim për gradat shkencore dhe titujt akademikë); MTM (Aplikim për vlerësimin e ndikimit në mjedis); AMF (aplikim për licensimin e administratorëve të falimentit; Aplikim për rinovimin e licences së administratorëve të falimentimit); DPB (Vërtetim i gjendjes gjyqësore); DPP (Aplikim për vërtetimin e detyrimeve përmbartimore); ISSH (Kërkesë për shpërblim lindje për personat e punësuar; Kërkesë për shpërblim lindje për personat e vetëpunësuar); QKB (Aplikim për regjistrimin fillestar të degëve ose zyra të përfaqësimit të shoqërive të huaja; Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive aksionare (sh.a); Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar dhe të thjeshta); Biblioteka Kombëtare (Aplikim për anëtarësim në Bibliotekën Kombëtare; Aplikim për huazim për lexim në sallat e Bibliotekës Kombëtare); DPPSh (Leje për dalje). Nëpërmjet shërbimit online nëpunësit publikë shkarkojnë të vulosur elektronikisht nga platforma e-Albania dokumentin ose mund të kërkojnë tek institucioni ofrues i këtyre dokumenteve përmes një sistemi elektronik të dedikuar që AKSHI ka ndërtuar vetëm për këtë qëllim (Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve më Nënshkrim Elektronik).
3. Në vitin 2020 është përfunduar plotësisht procesi i hartimit dhe konsolidimit të dokumentit Udhëzues “Metodologji e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Qeverisjen Qendrore” (MVRI). MVRI është relevante për vlerësimin e riskut të integritetit në të gjithë institucionet e qeverisjes qendrore dhe synon të kontribuojë në forcimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të riskut të integritetit në sektorin publik në Shqipëri. MVRI paraqet një kuadër të përgjithshëm të koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut, i cili përfshin: planifikimin, identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit, si dhe hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të integritetit në një institucion publik. MVRI është miratuar me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 7.11.2020 dhe është publikuar në faqet e internetit të Ministrisë së Drejtësisë.
4. Në vitin 2020, është përfunduar së hartuari manuali për hartimin e planeve të integritetit; Ministria e Drejtësisë ka miratuar Planin e Integritetit, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë

nr.333, datë 7.11.2020, i publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe që vendos bazat e funksionimit të një administratë publike me integritet, llogaridhënie dhe transparencë.

5. Në vitin 2020, janë konsoliduar dhe janë hartuar 4 raporte statistikore (6 mujori II 2019/vjetore 2019/3M I 2020/6M I 2020). Statistikat vjetore 2019 janë pjesë përbërëse e “Vjetarin Statistikor 2019”, i publikuar në www.drejtesia.gov.al. Janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmujorin e dytë dhe vjetore 2019. Janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për Tremujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2020. Janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) të vitit 2020. Gjithashtu, janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin për gjashtëmujorin e dytë dhe vjetore 2019. Janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin për gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor 2020). Janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) të vitit 2020. Janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për gjashtëmujorin e dytë dhe vjetore 2019. Këto të dhëna janë botuar dhe publikuar në “Vjetarin Statistikor 2019”. Janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor 2020).
6. Në fillim të vitit 2020 filloi veprimtarinë Prokuroria e Posaçme SPAK. Në vitin e parë të aktivitetit të tij, numri i rasteve të procedimeve penale për veprën e korrupsionit është 40.4% e numrit total të rasteve të proceduara dhe 29% të totalit të numrit të personave të hetuar.
7. Në vitin 2020, vijon hartimi dhe miratimi i kuadrit rregullator për krijimin e mekanizmave specifike për të zhvilluar luftën kundër korrupsionit në kuadër të administrimit dhe menaxhimit e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara që rrjedhin nga korrupsioni, janë hartuar 6 akte nënligjore në zbatim të ligjit nr. 34/2019, përmenden: VKM “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”; VKM “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”; VKM “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”; Udhëzimi “Për procedurat e mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave, rregullat e për mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të shpenzimeve, limitet e kryerjes së shpenzimeve”; Urdhër “Për kriteret dhe rregullat e hartimit të listës së administratorëve të pasurisë, pranë AAPSK”; Urdhër “Për miratimin e strukturës dhe përbërjes organike të strukturës së agjencisë së pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”.
8. SHÇBA, për vitin 2020 ka dërguar pranë organit të prokurorisë: 214 referime penale për 317 persona, nga të cilët: 1 punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues; 98 punonjës

policie i nivelit të parë drejtues; 208 punonjës policie të nivelit zbatues; 1 punonjës civil (administrativ); 5 efektive të Gardës; 4 PMNZSH dhe 99 shtetas.

Nga strukturat e hetimit të ShÇBA janë kryer rreth 19 operacione për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format dhe fenomenet më shqetësuese, siç janë “*korrupsioni pasiv*”, “*shpërdorimi idetyrës*”, *favorizimi i “kultivimit të bimëve narkotike” e “kontrabandës”, dhe tendencave të tjera.*

Këto operacione janë realizuar në bashkëpunim me SPAK, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë dhe strukturave të Policisë së Shtetit, duke u finalizuar me dokumentimin me prova ligjore të veprimtarisë së kundërligjshme të punonjësve të policisë dhe shtetasve të implikuar, si dhe ekzekutimit të masave të sigurimit personal shtrëngues dhe ndalues të dhëna nga Gjykata e Posacme dhe ato të Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë.

9. Gjatë vitit 2020, Ministria e Drejtësisë në rolin edhe të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka hartuar dhe publikuar Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit (PK&V) për vitin 2020, një dokument me 16 masa/aktivitete konkrete, të realizuara plotësisht me mbështetje të donatorëve dhe partnerëve të huaj në fushë, por edhe me angazhimin e drejtëpërdrejtë të stafit teknik dhe të kabinetit të Ministrit të Drejtësisë, për target grupe të ndryshme me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të luftës kundër korrupsionit.

Janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë akte si: Raporti Vjetor i Monitorimit të SNKK-së, Janar-Dhjetor 2019 (në gjuhën shqipe dhe angleze) e të Pasaportës së Treguesve; Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Janar-Mars 2020 (në gjuhën shqipe dhe angleze); Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Janar-Qershor 2020 (në gjuhën shqipe dhe angleze); Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Korrik-Shtator 2020 (në gjuhën shqipe dhe angleze).

Është krijuar netëork/forumi i OSHC për AK i krijuar për këtë qëllim është njoftuar rregullisht mbi akte dhe procese të ndjekura nga MD në kuadër të AK.

Gjatë vitit 2020, janë zhvilluar 4 fushata ndërgjegjësimi, përkatësisht:

- Java e Integritetit 1 (3-11 shkurt 2020)
 - Java e Integritetit 2 (1-9 dhjetor 2020)
 - Vrap kundër korrupsionit - shkurt 2020
 - Festivali Filmit Antikorrupsion – dhjetor 2020;
- deklarata dhe pjesëmarrje për publikun/ njoftime/intervista/takime me gazetarë për ecurinë e përpjekjeve në luftën kundër korrupsionit.
10. Gjatë vitit 2020, platforma e Bashkëqeverisjes ka pasur një proaktivitet të shtuar me qëllim bashkëqeverisjen me qytetarët dhe bizneset, e cila shërben për të ndërvepruar në kohë reale për çështje të aktualitetit politik e qeverisës. Përmes promovimit të aktiviteteve të saj, platforma ka ftuar qytetarët dhe bizneset t’i drejtohen duke paraqitur problematikën e tyre, me qëllim për ta zgjidhur atë në një kohë të shkurtër përmes një procesi transparent dhe të shpejtë, si edhe duke dhënë kontributin në përmirësimin e cilësisë së shërbimit në administratën shtetërore. Platforma e Bashkëqeverisjes informon publikun përmes imazheve dhe videove në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente mbi aktivitetin që kryen

me qëllim që të kthehet në një urë lidhëse për bashkëqeverisjen, që garanton gjithëpërfshirjen e qytetarëve dhe bizneseve në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Hapësirat ku platforma e bashkëqeverisjes promovon aktivitetin e saj janë:

Website: www.shqiperiaqeduam.al

Facebook: Shqipëria qe duam

Instagram: shqiperiaqeduam

Twitter: @ShqiperiaQeDuam

YouTube: Shqipëria qe duam

3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 31 dhjetor 2020*, rezultojnë se fushat që kanë treguar performancë jo rezultative të shoqëruar nga problematika për këtë periudhë raportimi janë objektive specifike të shpërndarë në të tre qasjet e SNKK, parandalim-ndëshkim-ndërgjegjësim.

Në adresimin e performancës nga institucionet rezultojnë se:

- mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale);
- mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar;
- vonesa në kryerjen e procedurave/fazave të kryerjes së aktiviteteve specifike;
- probleme të kuadrit ligjor e rregullativ;
- të funksionimit të sistemeve e të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit, janë çështje që përbëjnë sfida, mangësi dhe shkaktarë të joefikasitetit gjatë zbatimit të planit të veprimit antikorrupsion, në vitin 2020.

Nga monitorimi i kryer dhe analiza rezultojnë gjithashtu, që rakordimi i të dhënave raportuese ndërmjet institucioneve zbatuese për objektiva të njëjtë dhe mungesa e një bashkëpunimi dhe validimi të dhënash polici-prokurori-agjenci ligjzbatuese të tjera, përbëjnë vështirësi dhe joefikasitet zbatimi të këtij plani veprimi.

Institucionet dhe strukturat përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit duhet të jenë me të përgjegjshme mbi rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV dhe të arritjes së vlerave të synuara/vit.

Mungesa e një bashkëpunimi me sektorët e financës të pikave të kontaktit antikorrupsion ka gjithashtu një ndikim të shtuar në vështirësitë e raportimit të kryer, konkretisht të informacionit që lidhet me ekzekutimin e buxhetit.

Viti 2020 përkoi gjithashtu me një situatë të vështirë shoqërore me efekt global pandemia Covid - 19, e cila pati ndikimet e saj të menjëhershme dhe të pakthyeshme edhe në mbarëvajtjen e aktiviteteve institucionale dhe ndër-institucionale në vend në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit 2020-2023.

3.3 Konkluzione dhe rekomandime

Raporti i monitorimit vjetor, *janar – dhjetor 2020*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023, është dokumenti i parë vjetor monitorues që hartohet në përputhje me këtë plan veprimi dhe në zbatim të një metodologjie të re monitorimi dhe vlerësimi. Ky raport monitorimi është në përputhje me strukturën e dokumenteve

strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS.

Raporti vjetor jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës (Qasjeve të strategjisë), të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura, të zbatueshmërisë së masave (output/produkte) të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave e të aktiviteteve konkrete të parashikuara. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe një identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim.

Raporti i monitorimit *janar – dhjetor 2020*, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara, konsultim me të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektiv të strategjisë.

Nga monitorimi i kryer rezulton se:

Qëllimi i politikës 1 (qasja parandaluese- A) bazuar në treguesit rezulton se një shkallë realizueshmërie 74.66%.

Qëllimi i politikës 2 (qasja ndëshkuese - B) bazuar në treguesit rezulton se një shkallë realizueshmërie 20%.

Qëllimi i politikës 3 (qasja ndërgjegjësuere - C) bazuar në treguesit rezulton se një shkallë realizueshmërie 43%.

Nga monitorimi i kryer rezulton së realizimi i objektivëve specifike rezulton në një shkallë realizueshmërie:

Realizimi sipas aktiviteteve/masave	Realizimi sipas treguesve ⁴⁰
Dobët - 5 objektiva	Dobët – 5 objektiva
Mjaftueshëm - 4 objektiva	Mjaftueshëm - 4 objektiva
Mirë - 1 objektiva	Mirë - 1 objektivë
Shumë mirë - 8	Shumë mirë - 6
Tejkaluar – N/A objektiv	Tejkaluar – 1 objektivë

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet janë:

- të fillojë kryerja e aktiviteteve dhe masave për 5 objektivë të strategjisë, që rezultojnë në nivelin e zbatimit dobët (*nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara*), përkatësisht objektivët A6; A11; B2; B3 e C3.

⁴⁰ Objektiv A7, nuk është përfshirë në vlerësim.

- të vijojë e të përmirësohet performanca e kryerjes së aktiviteteve dhe masave për 4 objektive të strategjisë, që rezultojnë në nivelin e zbatimit mjaftueshëm (*nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara*), përkatësisht për objektivet A4; A7; B1 e B4.
- të përmirësohet arritja e vlerave të synuara në treguesit për objektivet A4; A11, B1, B3 e C3.
- të sigurohet mbështetje financiare për ato institucione që vijnë të jenë në boshllëk financiar;
- të brendësohet metodologjia IPSIS e raportimit të zbatimit të aktiviteteve, masave dhe treguesve në vijim. Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike në përputhshmëri me raportet që prodhojnë institucionet përgjegjëse.

IV. RISQET/RISKU DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit

Në këtë raport monitorimi, *janar – dhjetor 2020*, është kryer edhe një vlerësim i riskut për çdo objektive në përputhje me nivelin e realizueshmërisë së tij.

Ndër risqet që u evidentuan kryesisht, janë të lidhura me kapacitetet institucionale, kapacitetet financiare, mjedisin rregullator, partneriteti dhe bashkëveprimi institucional, komunikimi, proceset e punës por dhe faktorë të tjerë të jashtëm.

Pandemia Covid-19, është një risk i shtuar që ka rritur impaktin e saj negativ mbi objektivet strategjike dhe duke u kthyer në pengesë kryesore për progresin e tyre, fakt i cili mund të ndikojë dhe përbëjë risk edhe për vitin në vijim, 2021.

Objektive me risk të ulët janë: 2 objektive

Objektive me risk të mesëm janë: 7 objektive

Objektive me risk të lartë janë: 9 objektive

4.2 Hapat e radhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën për *vitin 2020*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren këto hapa në vijim:

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit:

Policia e Shtetit duhet të përmirësojë procesin e brendshëm të menaxhimit të rasteve në mënyrë që të ndajë rastet e hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve nga ato të gjeneruara përmes formave të tjera.

Të mundësohet ngritja e regjistri për evidentimin e denoncimeve nga portal shqipëriaqëduam.al, për korrupsion dhe të pajisjes së denoncimeve me numra unike për fillimin e procedimit penal, për

të patur një pasqyre të saktë të angazhimit të qytetarëve në denoncimet direkte ndaj veprimeve korruptive.

Të institucionalizohet bashkëpunimi Polici e Shtetit dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje si një formë që do të përmirësonte dhe do të garantonte një bashkëveprim funksional për trajtimin e denoncimeve kundër korrupsionit, në mënyrë që të rritet edhe ndërgjegjësimi qytetar për të denoncuar krimin e korrupsionit në mënyrë konkrete dhe të drejtpërdrejtë.

A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave:

ILDKPKI duhet të rrisë ndërgjegjësimin e kryerjes së sinjalizimeve të jashtme në raste korrupsioni me qëllim forcimin e zbatimit të ligjit.

A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike:

Të vijohet me plotësimin e kuadrit rregullar në zbatim të ligjit zgjedhor dhe me forcimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale të auditimit dhe kontrollit të partive politike.

A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut:

Të përmirësohet komunikimi dhe informimi për zbatimin e angazhimeve që burojnë nga plani i veprimit. Mungesa e të dhënave të raportimit nuk mund të vijoje të çënojë analizën sasiore dhe cilësore të vlerësimit të zbatimit të këtij kuadri strategjik.

A.11 Adaptimi i politikave antikorruption në nivelin e qeverisjes vendore:

Të rritet ndërgjegjësimi dhe forcohet mjedisi i brendshëm mbi komunikimin dhe informimin për politikën e zhvillimit në pushtetin vendor (bashkitë) në drejtim të instrumenteve/mekanizmave antikorruption.

B1: Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit:

Të forcohen dhe përmirësohen komunikimi, informimi dhe bashkëpunimi ndërinsitucional midis organeve ligjzbatuese, dhe të forcohen kapacitetet administrative respektive.

Të rritet komunikimi dhe vizibiliteti i AAPSK.

B2: Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkrimin penal të korrupsionit:

Të forcohet dhe përmirësohet bashkëpunimi ndërinsitucional, rritja e aksesimit në bazat e të dhënave nga Policia e Shtetit, si në regjistrat e Tatimeve, Doganave, Numërorin Telefonik, regjistrin kombëtar të llogarive bankare, Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar:

Të ketë progres sipas afateve të parashikuara për hartimin e kuadrit rregullativ dhe të vlerësimit për strukturën e rekuperimit të aseteve që vijnë nga krimi ekonomik dhe financiar.

C2: Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit:

Platforma e bashkëqeverisjes të krijojë mundësinë e ndarjes së kërkesë/ankesave për rastet e denoncimit të korrupsionit nga llojet e tjera të raportimeve që merr nga qytetarët dhe dërgimin e tyre pranë Policisë së Shtetit.

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile:

Të sigurohet mbështetja financiare për ecurinë e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit dhe të sigurohet më shumë prezencë e organizatave të shoqërisë civile në hartimin e programeve antikorrupsion.

